



IOM International Organization for Migration
ONM Organizata Ndërkombëtare për Migracionin



Strategjia Kombëtare për Migracionin

*Projekt i Qeverisë Shqiptare i mundësuar në bashkëpunim me Organizatën
Ndërkombetare për Migracionin (I.O.M)*

Financuar nga programi Cards i Bashkimit Evropian

TABELA E PËRMBAJTJES

	Faqe
TABELA E SHKURTIMEVE	3
HYRJE.....	4
PJESA E PARË: MIGRACIONI NË KUSHTET SHQIPTARE.....	7
DUKURIA E EMIGRACIONIT	7
<i>Zhvillimet e lëvizjeve emigratore</i>	<i>7</i>
<i>Emigracioni dhe demografia</i>	<i>9</i>
<i>Ndikimi i emigracionit në ekonominë e vendit.....</i>	<i>9</i>
<i>Ndikimet e emigracionit në tregun e punës.....</i>	<i>9</i>
<i>Ndikimi i emigracionit në politikën e brendshme</i>	<i>10</i>
<i>Emigracioni dhe politika e jashtme</i>	<i>10</i>
QËNDRIMI I QEVERISË SHQIPTARE NDAJ MIGRACIONIT.....	11
<i>Strukturat qeveritare.....</i>	<i>11</i>
<i>Programi i Qeverisë Shqiptare</i>	<i>11</i>
<i>Kuadri ligjor dhe politik për emigracionin.....</i>	<i>12</i>
<i>Kuadri ligjor dhe politik për imigracionin</i>	<i>14</i>
POLITIKAT E BASHKIMIT EVROPIAN PËR SHQIPËRINË	15
<i>Politika globale e BE për Shqipërinë.....</i>	<i>15</i>
<i>Shqipëria objektiv i BE si një vend me përparësi në luftën kundër imigracionit të paligjshëm</i>	<i>16</i>
<i>Nevoja për zhvillimin e politikave të imigracionit drejt një metode më të efektshme.....</i>	<i>18</i>
PJESA E DYTË: UDHËZIMET PËR POLITIKAT.....	21
A. Lufta kundër migracionit të paligjshëm.....	21
A.1 Lufta kundër shkaqeve të emigracionit	21
A.2 Kthimi i Migrantëve.....	24
A.2.1. Kthimi i shtetasve shqiptarë nga shtetet anëtare të BE	24
A.2.2. Kthimi i shtetasve të vendeve të treta në Shqipëri nga shtetet anëtare të BE.	27
A.2.3 Kthimi i shtetasve të vendeve të treta nga Shqipëria për në vendet e tyre	28
B. Emigracioni dhe zhvillimi i Shqipërisë.....	30
B.1. Përfitimet nga Shqiptarët që jetojnë jashtë vendit	30
B.1.1. Mbështetja e emigrantëve shqiptarë.....	30
B.1.1.1. Përmirësimi i imazhit të emigrantëve shqiptarë jashtë vendit	30
B.1.1.2. Përmirësimi i shërbimeve konsullore dhe diplomatike shqiptare për shqiptarët në vendet pritëse.....	33
B.1.1.3. Mbrojtja e të drejtave të emigrantëve shqiptarë.....	35
B.1.2 Mobilizimi i komunitetit shqiptar jashtë vendit.....	41
B.1.3 Orientimi i dërgesave të emigrantëve drejt investimeve në biznes.....	45
B.2. Hartimi i politikave të përshtatshme për emigracionin.....	49

B.2.1.	Menaxhimi i migracionit qarkullues të shqiptarëve	49
B.2.1.1.	Informimi mbi mundësitë e emigracionit	50
B.2.1.2.	Regjistrimi i emigrantëve.....	53
B.2.1.3.	Marrëveshjet dypaleshe të punësimit ndërmjet Shqipërisë dhe shteteve anëtare të BE.	56
B.2.1.4	Studentët shqiptarë në shtetet anëtare të BE-së	60
B.2.1.5	Politika e Vizave	62
B.2.2.	Fenomeni i ikjes së trurit.....	64
C.	Përmirësimi i Kuadrit Ligjor për Migracionin në Shqipëri	67
D.	Organizimi i një strukture të përshtatshme institucionale për të menaxhuar politikat e migracionit, në veçanti për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin.....	72

Tabela e shkurtimeve

IOM-	Organizata Ndërkombëtare për Migracion
MPJ –	Ministria e Punëve të Jashtme
MPCŞ-	Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale
MRP -	Ministria Rendit Publik
BE-	Bashkimi Evropian
INSTAT-	Instituti i Statistikave
ISSH-	Instituti i Sigurimeve Shoqërore
SKLTQNJ-	Strategjia Kombëtare e Luftës kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore
SKMIK -	Strategjia për Kontrollin dhe Menaxhimin e Integruar të Kufirit
SKM-	Strategjia Kombëtare për Migracionin
SKLTF-	Strategjia Kundër Luftës së Trafikimit të Fëmijëve
SHKP-	Shërbimi Kombëtar i Punësimit
SHSSH-	Shërbimi Social Shtetëror
VKM-	Vendimi i Këshillit të Ministrave
MSA-	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
PSA	Procesi i Stabilizim Asociimit
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
IHD	Investimet e Huaja Direkte
NHZH	Ndihma e Huaj për Zhvillim

HYRJE

Qeveria Shqiptare, me mbështetjen e IOM-it, ka parashikuar miratimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin që në vitin 2002. Emigracioni është një shqetësim i madh për Shqipërinë për shkak se rreth 20% e popullsisë është larguar nga vendi gjatë më shumë se një dekade, duke e bërë Shqipërinë një nga vendet me nivelin më të lartë të flukseve të emigracionit në botë. Migracioni gjithashtu përbën një aspekt të rëndësishëm të marrëdhënieve të Shqipërisë me shtetet anëtare të Bashkimit Evropian si vende destinacioni për shumicën e emigrantëve shqiptarë. Shqipëria po konsiderohet në shumë raste nga Bashkimi Evropian si një nga vendet e treta ku i duhet dhënë përparësi luftës kundër migracionit të parregullt. Menaxhimi i flukseve migratore është bërë rrjedhimisht një pjesë përbërëse e Proesit të Stabilizim Asocimit; Marrëveshja e ardhshme e Stabilizim Asocimit që do të nënshkruhet në vitin 2005 do të përfshijë shumë dispozita për migracionin dhe azilin.

Synimi i kësaj strategjie është të sigurojë një politikë më të plotë për migracionin, nga një politikë që kryesisht ka reaguar në luftën ndaj flukseve të parregullta në një politikë më të plotë bazuar në menaxhimin e migracionit, dhe në mënyrë të veçantë të flukseve të emigracionit. Kjo politikë trajton çështjet e mëposhtme: mbrojtjen e të drejtave të emigrantëve shqiptarë jashtë vendit, ngritjen dhe bashkimin e komuniteteve shqiptare jashtë vendit, orientimin e të ardhurave nga emigrantët drejt investimeve të biznesit, organizimin e një politike të përshtatshme për migracionin për punësim, krijimin e lehtësirave të udhëtimit të shtetasve shqiptarë krahasuar me kërkesat për vizë afatshkurtër dhe së fundi, zhvillimin e kuadrit të duhur ligjor dhe institucional. Strategjia përfshin edhe imigracionin, porë kjo në aspektin e kuadrit ligjor dhe institucional, bazuar edhe në raportin e mëparshëm të përgatitur nga IOM në janar 2004.¹

Theksi i kësaj strategjie vendoset në menaxhimin e flukseve të emigracionit si një përparësi e menjëhershme, më shumë sesa në zhvillimin e një politike për imigracionin duke qenë se Shqipëria do të mbetet pa dyshim për njëfarë kohe një vend emigrues. Gjithsesi, në këndvështrim afatgjatë Shqipëria ka gjasa të bëhet një vend imigracioni në të njëjtën mënyrë që janë bërë shtetet jugore anëtare të BE gjatë njëzet vjetëve të fundit. Zhvillimi i një kuadri ligjor për imigracionin si një kërkesë e ardhshme për hyrjen në BE do të kërkojë hyrjen graduale të *acquis* të BE për imigracionin dhe azilin paralelisht me thellimin e Procesit të Stabilizim Asocimit. Megjithatë, për shkak të rëndësisë së kufizuar që kanë aktualisht çështjet e imigracionit këto ndryshime shkojnë përtej shtrirjes dhe përmbajtjes të kësaj strategjie, e cila kufizohet në një periudhë prej pesë vjetësh, nga 2005 deri në 2010. Gjithashtu zhvillimi i Shqipërisë nga një vend emigracioni në një vend imigracioni nuk duhet parë brenda një kuadri të kufizuar ligjor, por brenda kuadrit të ndryshimit të konsiderueshëm të shoqërisë dhe zhvillimit të një mentaliteti të hapur ndaj multikulturalizmit.

Proçesi drejt miratimit të strategjisë kombëtare për migracionin është ndarë në dy faza: së pari, hartimi i këtij dokumenti mbi politikën e cili është miratuar nga Këshilli i Ministrave, më 19 nëntor 2004 dhe hapja e një debati të gjerë mbi migracionin në shoqërinë shqiptare dhe në institucionet shqiptare. Ky debat do të çojë në miratimin zyrtar të planit të veprimit të detajuar për migracionin.

¹ Analiza e legjislacionit dhe praktikave shqiptare për imigracionin krahasuar me standartet e BE-së dhe ato ndërkombëtare.

Prezantimi i këtij dokumenti në një debat më të gjerë duhet të kuptohet si një pikë fillimi. Aktivitetet e propozuara për strategjinë janë të formuluar në kuadratët me ngjyrë gri përgjatë tekstit. Gjatë debatit të parë të gjitha masat e zbatimit të renditura në kuadratët me ngjyrë gri do të diskutohen, do të ndryshohen ose edhe do të hidhen poshtë pas shtimit të elementëve të rinj. Janë bërë të gjitha përpjekjet për t'i bërë propozimet dhe diskutimet rreth tyre sa më konkrete. Plani i veprimit, bazuar te propozimet e renditura në kuadratët ngjyrë gri, do të përcaktojë me hollësi çdo masë për të cilën është rënë dakort dhe të gjithë elementët për zbatimin e saj (struktura përgjegjëse, aktivitetet e nevojshme, burimet e nevojshme njerëzore dhe financiare, afati kohor, lidhjet me masat e tjera dhe standartet e mundshme). Plani i veprimit që do të hartohet do të ketë formën e një matrice ku do të tregohen të gjithë elementët për çdo masë të parashikuar. Projekti që duhet realizuar nga autoritetet Shqiptare i është bashkangjitur dokumentit aktual.

Për ta bërë këtë dokument që të njihet sa më gjerësisht që të jetë e mundur do të organizohet një fushatë sensibilizimi në të gjithë territorin e vendit e madje edhe jashtë tij. Do të ndërmerret gjithashtu edhe ngritja e kapaciteteve për institucionet që do të jenë përgjegjëse për zbatimin e strategjisë, përfshi edhe organizimin e disa tryezave të rrumbullakëta. Objektivi i tryezave të rrumbullakëta do të jetë të mbledhin të gjithë aktorët dhe ministritë shqiptare të ngarkuara me hartimin e Planit Kombëtar të Veprimit, për të pasuruar diskutimin mbi propozimet. Tryezat e rrumbullakëta do të zhvillohen gjatë fushatës së sensibilizimit në nëntor dhe dhjetor, dhe plani i veprimit do të paraqitet për miratimin përfundimtar në Këshillin e Ministrave në Shkurt 2005.

Plani i veprimit si edhe zbatimi i mëtejshëm i strategjisë do të kërkojë krijimin e një strukture që do të ngarkohet me hartimin dhe negociimin e saj. Kjo strukturë do të shërbejë si zonë takimi midis të gjithë strukturave dhe autoriteteve politike të përfshira, në veçanti Këshilli i Ministrave. Ajo gjithashtu do të luajë një rol të rëndësishëm në koordinimin midis tre ministrive kryesore (MPÇS, MRP dhe MPJ). Për këtë arsye ajo duhet të përbëhet nga përfaqësues të Qeverisë Shqiptare të një niveli të lartë për të pranuar, ndryshuar apo hedhur poshtë propozimet mbi politikën që do të paraqiten më vonë për miratim në nivelet përkatëse vendimarrëse, si Këshilli i Ministrave, si edhe për të mbledhur në një kohë shumë të shkurtër informacionin dhe të dhënat e duhura mbi mjetet ekzistuese dhe ato të domosdoshme për zbatimin. Do të përcaktohet gjithashtu edhe një mekanizëm për vlerësimin e zbatimit të strategjisë dhe për rishikimin periodik të saj mbi bazën e ecurisë, pengesave dhe vonesave të mundshme.

Shtrirja e kësaj strategjie është përcaktuar duke marrë parasysh ekzistencën në Shqipëri edhe të strategjive dhe planeve të ndryshme të veprimit që lidhen me të. Strategjia kombëtare për luftën ndaj trafikimit të qenieve njerëzore e miratuar në vitin 2001 dhe strategjia për kontrollin dhe menaxhimin e integruar të kufijve e miratuar në vitin 2003, janë dy dokumente të plota që trajtojnë dy fusha të politikës së migracionit; Strategjia Kombëtare për Migracionin nuk i mbulon këto çështje por i plotëson ato. Strategjia Kombëtare do të plotësojë gjithashtu edhe politika të tjera që lidhen me të, si ato që lidhen me punësimin dhe zhvillimin ekonomik-social, veçanërisht lidhur me dërgesat e emigrantëve dhe me vënien në lëvizje të komuniteteve shqiptare jashtë vendit.

Ky dokument ndahet në dy pjesë; pjesa e parë paraqet kuadrin shqiptar dhe evropian të migracionit ndërsa pjesa e dytë ravijëzon orientimet e politikave për Shqipërinë. Pjesa e dytë e kësaj strategjie është e ndarë në katër kapituj: lufta ndaj emigracionit të parregullt,

lidhja e menaxhimit të emigracionit me zhvillimin në Shqipëri, miratimi i kuadrit të nevojshëm ligjor dhe krijimi i strukturave përkatëse institucionale.

Strategjia Kombëtare për Migracionin është një projekt i financuar nga Komuniteti Evropian brenda programit “Asistenca ndaj Komunitetit për Rindërtim, Zhvillim dhe Stabilizim” (CARDS). Ai është zbatuar me mbështetjen teknike dhe bashkëfinancimin e Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) përmes përfaqësisë së saj në Tiranë. Qeveria Shqiptare dëshiron të falënderojë ngrohtësisht këto dy organizata ndërkombëtare për mbështetjen e tyre bujare gjatë gjithë punës.

PJESA E PARË: MIGRACIONI NË KUSHTET SHQIPTARE

Kjo pjesë fillimisht synon të japë një pamje të gjerë të emigracionit në kontekstin shqiptar duke shpjeguar se si është zhvilluar kjo dukuri në Shqipëri, si edhe ndikimin e saj në vend dhe në shoqërinë shqiptare. Këtu shprehet qëndrimi i qeverisë ndaj kësaj dukurie, si edhe kuadri ligjor e institucional për ta trajtuar atë.

DUKURIA E EMIGRACIONIT

Shtrirja, pasojat dhe marrëdhënia që ka emigracioni me trafikimin e qënieve njerëzore si dhe kompleksiteti i këtij fenomeni, e shndërron emigracionin në një çështje të rëndësishme.

Sipas regjistrimit të popullsisë kryer nga INSTAT, në vitin 2001 popullsia shqiptare është 3.07 milion banorë dhe nëse nuk do të kishte migracion kjo shifër do të ishte 3.78 milion. Diferenca ndërmjet këtyre dy shifrave është numri i përafërt i emigrantëve, pra 710 000² persona nga të cilët 390 000 meshkuj dhe 320 000 femra. Për shkak të karakterit masiv dhe të parregullt të emigracionit shqiptar, nuk ka shifra të sakta zyrtare për shpërndarjen e emigrantëve shqiptarë. Megjithatë, specialistët e kësaj fushe kanë dhënë disa shifra të përafërta për të shpjeguar shpërndarjen e emigrantëve shqiptarë në vendet pritëse. Afërsisht tre të pestat e tyre jetojnë në Greqi, një e pesta në Itali dhe një e pesta në Evropën Perëndimore dhe vende të tjera të botës³. Statistikat tregojnë se rreth gjysma e emigrantëve nuk janë të pajisur me dokumenta të rregullta.

Një studim i fundit i INSTAT rendit sipas rëndësisë arsyet që detyrojnë shtetasit shqiptarë të emigrojnë jashtë vendit si vijon: paga më të larta, mbështetja financiare e familjes, kushte më të mira pune, kushte më të mira jetese, kushte më të mira arsimimi për vete apo për pjestarët e tjerë të familjes, si edhe në periudha të caktuara për shakt të sigurisë dhe rendit në vend. Vendet në të cilat shtetasit shqiptarë parapëlqejnë të emigrojnë ndahen sipas disa faktorëve, si p.sh., lehtësia për të gjetur punë, afërsia gjeografike, lehtësia e hyrjes në vendin pritës, të afërm që jetojnë në vendet ku ata emigrojnë, njohja me mundësitë për arsimim dhe përmirësimi i aftësive profesionale, mundësia për të punuar në profesionin e tyre dhe paga më të mira në krahasim me vende të tjera, përveç Shqipërisë.

Zhvillimet e lëvizjeve emigratore

Gjatë periudhës së komunizmit Shqipëria ka qënë shumë e izoluar dhe dukuria e migracionit pothuajse nuk ka ekzistuar. Emigracioni masiv që karakterizon periudhën post-komuniste filloi në korrik të vitit 1990, kur mbi 5.000 persona hynë në ambasadat e Italisë, Gjermanisë dhe Francës për t'u larguar nga vendi. Në fund të vitit 1990, mbi 20.000 shtetas shqiptarë u larguan nga vendi në rrugë tokësore për në Greqi ku kërkuan azil politik. Në mars të vitit 1991, një numër i madh shtetasish shqiptarë hynë në portin e Durrësit, më i madhi në vend. Pasi morën kontrollin e disa anijeve të flotës detare tregëtare, i drejtuan ato për të zbarkuar në portet e Italisë Jugore. E njëjta situatë u përsërit pak muaj më vonë, në gusht, kur rreth 18.000 vetë, pasi morën nën kontroll disa

² 110.000 banorë i përkasin brezit të dytë të emigrantëve të cilët kanë lindur jashtë vendit

³ Papanagos Harry, Sanfey Peter (2001) "Intention to emigrate in transition countries: "The case of Albania in *Journal of Population Economics*"; Nr. 14; fq.491-504.

anije, zbankuan në brigjet e Italisë. Emigracioni i paligjshëm u rrit ndjeshëm gjatë viteve të mëvonshme⁴.

Emigracioni pësoi një ulje gjatë viteve 1992-1996. Arsyeja ishte atribut i përmirësimit të stabilitetit politik dhe situatës social-ekonomike. Në fund të vitit 1996⁵ numri i shtetasve shqiptarë që jetonin jashtë vendit arriti në 350.000 vetë. Fluksi i emigracionit u bë më masiv në vitin 1997, si pasojë e rënies së skemave piramidale dhe kaosit politik që shoqëroi këtë ngjarje.

Në vitet e fundit ka patur një rënie të vazhdueshme të emigracionit të paligjshëm për shkak të forcimit të kontrollit kufitar, intensifikimit të luftës kundër trafikimit të qënieve njerëzore, përmirësimit të kushteve social-ekonomike në Shqipëri dhe stabilitetit politik dhe rendit.

Emigrantët shqiptarë gjithmonë e më shumë po integrohen në vendet pritëse, me përjashtim të Greqisë, ku ky proces është shumë i ngadaltë. Vërehet një ulje e ndjeshme e emigracionit të paligjshëm, megjithatë kjo është shoqëruar nga rritja e emigracionit të rregullt për në Kanada, SHBA, etj. Si rezultat i integritit të emigrantëve, emigracioni për qëllime punësimi është shoqëruar me bashkim familjar, gjë që nuk mund të ndodhte më parë për shkak se njerëzit emigronin në mënyrë të parregullt. Emigracioni për qëllime punësimi është shoqëruar nga një numër i madh shtetasish që largohen nga vendi për të studiuar jashtë.

Masat e qeverisë për forcimin e kontrollit të kufijve dhe luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore kanë sjellë një ulje të emigracionit të parregullt. Gjithashtu ndryshimi i kushteve sociale, ekonomike dhe politike ka ulur dëshirën për t'u larguar nga vendi në të mirë të rritjes së kërkesave dhe aspiratave të shqiptarëve të cilët përndryshe do të ishin kontigjent emigracioni.

Një tjetër dukuri është ulja e rëndësisë së afërsisë gjeografike. Kjo vihet re në faktin se po shënohet ulje e vazhdueshme e numrit të emigrantëve në vendet fqinje si psh. në Greqi dhe Itali dhe një rritje e konsiderueshme e emigrantëve në shtete më të largëta si në Mbretërinë e Bashkuar, SHBA dhe Kanada. Arsyeja kryesore që ndikon në përzgjedhjen e shtetit për të emigruar është mundësitë ekonomike që ofron shteti në fjalë apo mundësia e pajisjes me dokumenta. Si pasojë, një numër gjithnjë e më i madh i shqiptarëve po emigrojnë drejt vendeve si Mbretëria e Bashkuar si edhe në vende ku mund të emigrojnë ligjërisht, si Kanadaja apo SHBA.

Edhe pse numri i emigrantëve shqiptarë në vendet fqinje vazhdon të mbetet i lartë, ajo që vihet re kohët e fundit është rritja e emigracionit sezonal në vendet fqinje si edhe ndryshimi i raportit midis emigracionit të rregullt dhe të parregullt në favor të emigracionit të rregullt. Së pari, kjo ndodh si pasojë e lehtësimit të marrjes së dokumentave në vendet pritëse. Së dyti, rritja e përshtatjes me kërkesat e tregut të punës në vendet pritëse i jep kësaj prirjeje një ndihmë të madhe. Krijimi i kontakteve si edhe mësimi i gjuhëve të vendeve fqinje ka ndihmuar në mënyrë të konsiderueshme këtë proces. Së treti, zhvillimi i komunikimit me vendet pritëse ka luajtur një rol të rëndësishëm. Kjo është shoqëruar edhe me shtimin e pikave të kalimit kufitar, linjave të trakteve për në Itali, rritjen e numrit të fluturimeve nga dhe për në Shqipëri, si dhe me

⁴ Shiko më sipër.

⁵ Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara

përmirësimin e infrastruktures rrugore. Komunikimi me mediat e huaja është shtuar dhe është i vazhdueshëm në ato vende në të cilët shtetasit kanë qenë emigrantë.

Emigracioni dhe demografia

Pas disa dekadash rritjeje të qëndrueshme, numri i përgjithshëm i popullsisë shqiptare është ulur me 113 mijë banorë në periudhën ndërmjet dy regjistrimeve të fundit në 1989 dhe 2001. Faktori kryesor për këtë rënie ka qenë emigracioni, i cili i ka kaluar të 600.000 vetët pas vitit 1995 dhe ka bërë që për vite me radhë popullsia të ketë pësuar rënie.

Ulja e vazhdueshme e lindshmërisë pas viteve 60 ka qënë faktori i dytë që ka ndikuar në ritmet e ulëta të popullsisë me një shkallë lindjesh prej 2.31 fëmijë për një grua në 2001, tre herë më pak se 40 vjet më parë kur ky nivel ishte 6.85 fëmijë për një grua.

Ndryshimet në përbërjen e grupmoshave së popullsisë në Shqipëri pasqyrojnë ndikimin e emigracionit. Grupmoshat 20-40 vjeç përbëjnë numrin më të madh të emigrantëve, gjë që ka ndikuar si në ndryshimet në strukturën e grupmoshave të popullsisë ashtu edhe në nivelin e lindshmërisë. Si rrjedhojë numri i popullsisë deri në 20 vjeç është zvogëluar për shkak të lindshmërisë së ulët dhe popullsia 40 vjeç e lart është rritur për shkak të emigracionit.

Ndryshimet në shpërndarjet rajonale të dendësisë së popullsisë vijnë si rrjedhojë jo vetëm e lëvizjes së brendshme, por edhe e emigracionit. Dendësia e popullsisë në zonat jugore të Shqipërisë që ndodhen më pranë kufirit me Greqinë është ulur shumë. Në fakt, banorët që shpërngulen nga zonat veriore migrojnë kryesisht brenda vendit, ndërkaq banorët nga zonat jugore synojnë më shumë vendet e huaja.

Ndikimi i emigracionit në ekonominë e vendit

Emigracioni ka një ndikim parësor në ekonominë e vendit si rezultat i dërgesave të emigrantëve. Dërgesat e emigrantëve përbëjnë një nga shtyllat kryesore të ekonomisë shqiptare duke siguruar një hyrje të vazhdueshme të valutave të huaja në vend si edhe duke konsoliduar bazën për kursime dhe investime. Mbështetur në të dhënat zyrtare kontributi i dërgesave të emigrantëve, për një periudhë 10 vjeçare është vlerësuar rreth 15% e Produktit të Brendshëm Bruto. Gjithashtu kontributi i këtyre dërgesave në bilancin tregëtar, për një periudhë 10 vjeçare, vlerësohet të jetë rreth 58.8 %.

Ndikimet e emigracionit në tregun e punës

Emigracioni ka një ndikim të madh në zhvillimin profesional të shtetasve shqiptarë. Nga njëra anë, punësimi i emigrantëve shqiptarë në ekonomitë e zhvilluara të vendeve pritëse i ka pajisur ata me një kulturë të përgjithshme të menaxhimit të punës, të etikës në punë, njohuri për sektorë të rinj të ekonomisë, me njohuri mbi teknikën dhe teknologjinë e fundit. E parë në këtë këndvështrim, kthimi i tyre do të shoqërohej me transferimin e aftësive të sipërpërmendura. Është gjithashtu fakt se shumë emigrantë nuk punojnë në pozicione për të cilat ata kanë studiuar apo janë trainuar dhe kjo është arsyeja që lehtësimi dhe nxitja e njohjes së diplomave dhe kualifikimeve shqiptare jashtë vendit është një problem shqetësues.

Mundësitë për të emigruar ulin nivelin e papunësisë dhe si pasojë zbusin vështirësitë social-ekonomike që do të shfaqeshin nëse nuk do të ekzistonte mundësia për të kërkuar punë jashtë vendit.

Një tjetër çështje që duhet të merret në konsideratë kur përqendrohemi tek burimet njerëzore të shqiptarëve jashtë vendit është specializimi profesional që ata mendojnë të ndjekin. Në Greqi pjesa më e madhe e emigrantëve shqiptarë janë punësuar në industrinë e ndërtimit dhe një pjesë tjetër në bujqësi dhe hoteleri. Po ashtu në Itali emigrantët kryesisht janë të punësuar në ndërtim, turizëm dhe industrinë e lehtë. Specializimi i emigrantëve në fusha të veçanta ka një ndikim të madh në nivelin aktual të dërgesave të emigrantëve dhe efekti i kthimit të tyre në ekonominë kombëtare varet pikërisht nga specializimi i tyre profesional. Kjo në njëfarë mënyre shpjegon investimet masive në sektorin e ndërtimit dhe turizmit.

Një numër jo i vogël emigrantësh janë punësuar në bujqësi, në një kohë që prodhimi bujqësor në vend ka rënë dhe Shqipëria është bërë një importuese e rëndësishme në rajon për produkte bujqësore.

Ndikimi i emigracionit në politikën e brendshme

Dukuria e emigracionit mund të ndikojë në nivelin e pjesëmarrjes së emigrantëve në zhvillimet politike në vend. Ata nuk mund të marrin pjesë në votime edhe pse ata përbëjnë një numër të madh të zgjedhësve pasi nuk mund të votojnë në konsullatat Shqiptare jashtë vendit dhe duhet të udhëtojnë për në Shqipëri posaçërisht për këtë qëllim. Kjo ndikon në rezultatin e zgjedhjeve dhe mosangazhimin e tyre politik në tërësi.

Emigracioni si dukuri ndikon në stabilitetin ekonomik të vendit duke tentuar të mbajë në nivele të ulëta papunësinë në vend dhe të zbusë pakënaqësinë që vjen si rezultat i kushteve të vështira social-ekonomike. Kufizimi i mundësive për të emigruar mund të çojë në rritjen e presionit nga shtetasit të cilët dëshirojnë të emigrojnë.

Emigracioni ka një ndikim të madh edhe në formimin e kulturës politike. Jetesa jashtë vendit ndikon në formimin politik të emigrantëve dhe të afërmeve të tyre në Shqipëri dhe në mendimin e tyre se sa kujdeset qeveria për emigrantët. Pjesa më e madhe e emigrantëve shqiptarë jetojnë dhe punojnë në vende me sisteme të demokracisë liberale duke i dhënë mundësi atyre të familjarizohen dhe të shprehen në atë sistem. Formimi i ndryshëm politik i emigranteve që kthehen në vend do të ndikojë pozitivisht ndaj dukurive të tilla si klientelizmi, interesat vetjake dhe korrupsioni duke përshpejtuar dhe duke siguruar qëndrueshmëri për vazhdimin e procesit të demokratizimit në vend.

Emigracioni ndikon edhe në mundësinë dhe dëshirën e shtetasve shqiptarë për të udhëtuar lirisht jashtë vendit. Vështirësitë aktuale janë trashëgimi e një të kaluarë jo të largët. Izolimi i Shqipërisë në të kaluarën, ka lënë gjurmë në mentalitetin e njerëzve të cilët bëjnë një lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet një qeverisje të mirë dhe liberalizimit të mundësive për të udhëtuar jashtë vendit. Liberalizimi i regjimit të vizave konsiderohet si nivel më i ulët izolimi dhe si shkopë nga e kaluara komuniste duke u parë kështu si detyrë e qeverisë për të lejuar apo lehtësuar mundësitë për të udhëtuar jashtë vendit.

Emigracioni dhe politika e jashtme

Ekziston një lidhje e fortë ndërmjet procesit integruar në Bashkimin Evropian dhe emigracionit shqiptar. Ky proces luan një rol mjaft të rëndësishëm në hartimin e politikave dhe përparësive në fushën e emigracionit.

Për shkak të ndjeshmërisë së opinionit publik ndaj gjendjes së emigrantëve shqiptarë në vendet pritëse, garantimi i të drejtave të shtetasve shqiptarë jashtë vendit shihet si një çështje mjaft e rëndësishme për t'u trajtuar nga shërbimet diplomatike të Ministrisë së Punëve të Jashtme. Për shkak të numrit të konsiderueshëm të shqiptarëve jashtë vendit, respektimi dhe garantimi i të drejtave të tyre përbën një detyrë dhe njëkohësisht një sfidë për qeverinë shqiptare.

Procesi i emigracionit është një proces i natyrshëm për t'u integruar në tregun ndërkombëtar të punës dhe për t'u përfshirë në procesin e globalizimit. Kompleksiteti i problemeve me të cilat ndeshen emigrantët shqiptarë në vendet fqinje ka qenë dhe vazhdon të mbetet një element i rëndësishëm në marrëdhëniet me këto shtete.

QËNDRIMI I QEVERISË SHQIPTARE NDAJ MIGRACIONIT

Strukturat qeveritare

Shumë institucione qeveritare mbulojnë çështje që kanë të bëjnë me migracionin, por ministritë kryesore janë Ministria e Rendit Publik, Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale dhe Ministria e Punëve të Jashtme.

Roli i Ministrisë së Rendit Publik në lidhje me migracionin ushtrohet nga Drejtoria e Policisë Kufitare dhe Migracionit. Kompetencat e MRP në këtë fushë përfshijnë kontrollin kufitar, masat kundër trafiqeve të paligjshme deri në përzgjedhjen dhe regjistrimin e të huajve. Ministria e Rendit Publik ka rol të rëndësishëm në nënshkrimin dhe zbatimin e marrëveshjeve të ripranimit.

MPÇS është përgjegjëse për të gjitha aspektet e migracionit për motive punësimi. Drejtoria e Migracionit merret drejtpërdrejt me migracionin. Institucione të tjera që varen nga MPÇS, objekt i punës së të cilave janë çështjet që lidhen me migracionin, janë Shërbimi Kombëtar i Punësimit, Shërbimi Social Shtetëror dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore. MPÇS është gjithashtu autoriteti kompetent për marrëveshjet e punësimit sezonal me vendet e tjera.

Kompetencat e MPJ në fushën e migracionit lidhen me administrimin e vizave dhe të dokumentave të hyrjes të të huajve dhe shërbimet konsullore të siguruar në vendet pritëse për emigrantët shqiptarë. Akoma më shumë, ajo është një pjesëmarrëse kryesore në procesin e nënshkrimit të marrëveshjeve të ratifikuara nga Shqipëria, si edhe në marrëveshjet e ripranimit.

Instituti i Statistikave (INSTAT) është një institucion tjetër, objekt i punës së të cilit, ndër të tjera është mbledhja dhe shpërndarja e të dhënave dhe studimeve që ndihmojnë në krijimin e një kuadri më të qartë të dukurisë së migracionit.

Programi i Qeverisë Shqiptare

Sipas programit të qeverisë, disa nga prioritetet e qeverisë në fushën e migracionit janë menaxhimi i flukseve migratore, rritja e përkujdesit ndaj emigrantëve dhe familjeve të tyre, si dhe krijimi i lehtësirave për të emigruar në rrugë ligjshme përkrah përpjekjeve për të luftuar emigracionin e paligjshëm. Duke patur parasysh gjendjen ekonomike dhe atë të punësimit në vend, qeveria e konsideron si përparësi kanalizimin e dërgesave të emigrantëve në zhvillimin ekonomik. Qeveria shqiptare është treguar e vëmendshme për

efektet e dërgesave të emigrantëve në tregun e punës. Është kjo arsyeja që ajo është e angazhuar në nxitjen e punësimit sezonal si alternativë e emigracionit të përhershëm për qëllime punësimi dhe në nxitjen e kthimit të emigrantëve të kualifikuar. Duke qënë e interesuar për kushtet e jetesës së shtetasve shqiptarë jashtë vendit, qeveria është e angazhuar për të ndihmuar në integrimin social, kulturor dhe ekonomik të tyre në vendet pritëse duke e gërshetuar këtë me ruajtjen dhe zhvillimin e trashëgimisë kulturore shqiptare.

Kuadri ligjor dhe politik për emigracionin

Numri i madh i emigrantëve shqiptarë ka sjellë reagimin e strukturave përkatëse shtetërore me qëllim minimizimin e kostos së emigracionit dhe maksimizimin e përfitimeve si për emigrantët ashtu dhe për vendin.

Për shkak të nivelit të lartë të emigracionit dhe të ndikimit të madh që ai ka në të gjithë sektorët në vend, si edhe për të pasqyruar përmasat shqetësuese të tij, është miratuar ligji nr.9034, datë 20.03.2003 për “Emigrimin e Shtetasve Shqiptarë për Motive Punësimi” i cili rregullon të drejtën për t’u punësuar apo vetëpunësuar jashtë vendit.

Për të lehtësuar lëvizjen e qytetarëve jashtë vendit, janë bërë përpjekje për të liberalizuar regjimin ekzistues të vizave nëpërmjet lidhjes së disa marrëveshjeve me vendet e treta.

Për të zbutur problemin e papunësisë në vend dhe për të përmbushur nevojat për të emigruar për motive punësimi janë nënshkruar disa marrëveshje punësimi ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve të tjera si Greqia, Gjermania, dhe Italia. Kështu, për inkurajimin dhe hapjen e agjensive private të punësimit, të cilat do të ndihmonin shtetasit shqiptarët të gjenin punë jashtë vendit, Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin nr. 708 të datës 16.10.2003 për “Procedurat e liçensimit dhe funksionimit të Agjensive Private të Punësimit.

Problemi i migracionit është trajtuar gjithashtu nga dy strategjitë e fundit, Strategjia kombëtare e luftës kundër trafikimit të qënieve njerëzore, e miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave në vitin 2001, dhe Strategjia për kontrollin e kufirit dhe menaxhimin e integruar të tij, e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave në vitin 2003. Është miratuar edhe një Plan Veprimi për masat që duhen marrë për përmirësimin e lëvizjes së lirë të njerëzve, miratuar në vitin 2003, i cili parashikon masat që duhen marrë për parandalimin e kalimit të paligjshëm të kufirit dhe luftën ndaj lidhjeve që ekzistojnë ndërmjet migracionit të parregullt dhe krimit në përgjithësi. Edhe pse këto strategji dhe politika kanë një ndikim të drejtpërdrejtë mbi migracionin dhe trafikimin e qënieve njerëzore, për të shmangur përsëritjen, Strategjia Kombëtare për Migracionin nuk trajton çështje që janë trajtuar më parë nga nisma të tilla. Megjithatë, disa përsëritje me planin e veprimit mbi masat për të përmirësuar lëvizjen e lirë të njerëzve nuk mund të shmangen nga vetë problematika e gjerë e kësaj dukurie. Për pasojë do të lindë nevoja për të siguruar një koordinim të mirë ndërmjet këtyre dy instrumentave gjatë zbatimit .

Strategjia Kombëtare e Luftës Kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore ishte hapi i parë i qëndrueshëm i ndërmarrë nga Shqipëria, pas përpjekjeve të saj *ad hoc* për t’i dhënë fund dukurisë së trafikimit të qënieve njerëzore. Strategjia e miratuar në dhjetor të vitit 2001, ndër të tjera kishte si objektiv parandalimin e trafikimit të qënieve njerëzore dhe mbrojtjen dhe dhënien e ndihmës për viktimat e trafikimit me synim riintegrimin e tyre në shoqëri. Kjo strategji është zbatuar gjatë periudhës 2001-2004. Monitorimi i strategjisë

i është ngarkuar Ministrit të Shtetit për Koordinim pranë Kryeministrit i cili duhet të raportojë çdo tre muaj në Komitetin Kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore. Disa nga masat e parashikuara nga kjo strategji janë: identifikimi i arsyeve që bëjnë të mundur trafikimin, ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut në lidhje me trafikimin e qënieve njerëzore dhe përmirësimi i kushteve social-ekonomike, krijimi i shërbimeve për mbrojtjen e viktimave dhe riintegrimin e tyre, trainimi i strukturave të përfshira në luftën kundër trafikimit, krijimi i strukturave të specializuara për të luftuar trafikimin e qënieve njerëzore dhe sigurimi pajisjeve të nevojshme teknike për strukturat/njësitë e përfshira në luftën kundër trafikimit .

Masat e marra në kuadër të kësaj strategjie kanë ulur në mënyrë të ndjeshme numrin e personave të trafikuar gjatë viteve të fundit. Megjithatë, duke marrë parasysh pasojat dhe përmasat e mëdha të kësaj dukurie në shoqërinë shqiptare, qeveria shqiptare ka parashikuar vazhdimësinë e strategjisë kundër trafikimit të qënieve njerëzore me një tjetër plan veprimi për periudhën 2004-2005. Gjithashtu është hartuar një strategji kundër trafikimit të fëmijëve në kuadrin e luftës kundër trafikimit⁶. Kjo strategji parashikon masa/veprime të veçanta që duhen marrë, të cilat do të kenë ndikim të fortë në luftën kundër trafikimit të fëmijëve.

Angazhimi i Qeverisë Shqiptare për t'i dhënë fund krimit ndër-kufitar, migracionit të paligjshëm, kontrabandës, trafikimit në përgjithësi dhe trafikimit të qënieve njerëzore në veçanti, nëpërmjet forcimit të kontrollit kufitar, pasqyrohet për herë të parë në një dokument të konsoliduar në Strategjinë e kontrollit dhe menaxhimit të integruar të kufijve. Qeveria shqiptare e konsideron menaxhimin e kufirit jo vetëm si një detyrim ndaj shtetasve të saj, por gjithashtu si një çështje që ka ndikim të drejtpërdrejtë në marrëdhëniet e Shqipërisë me vendet e tjera. Strategjia e menaxhimit të integruar është parashikuar të zbatohet gjatë periudhës 2003-2006. Në këtë kuadër do të ndërmerret një studim mbi trafiqet që zhvillohen ndërmjet kufijve shtetërorë, mbledhjen e të dhënave mbi trafiqet, përmirësimin e kontrollit kufitar me anë të prezantimit të metodave dhe teknikave të reja për zbulimin e kalimeve të paligjshme të kufirit, masat e efektshme kundër terrorizmit dhe krimit të organizuar, si edhe forcimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve përkatëse në Shqipëri dhe rajon.

Monitorimi i kësaj strategjie i është ngarkuar Zëvendësministrit të Rendit Publik, i cili do t'i raportojë Ministrit të Rendit Publik të paktën një herë në 6 muaj mbi ecurinë e zbatimit të strategjisë.

Plani i masave për përmirësimin e lëvizjes së lirë të njerëzve është një tjetër dokument i qeverisë shqiptare. Plani i masave thekson se përmirësimi i lëvizjes së lirë të njerëzve mund të arrihet vetëm nëse do të parashikohen masa të efektshme që parandalojnë migracionin e paligjshëm të shtetasve shqiptarë jashtë vendit dhe migracionin e paligjshëm të shtetasve të vendeve të tjera që e përdorin Shqipërinë si vend tranzit për në BE. Kuptimi i “lëvizjes së lirë” ka nevojë për t’u shpjeguar: ajo nuk mund të merret në kuptimin që ka në të drejtën Evropiane⁷ pasi një e drejtë e tillë në parim mund t’i garantohet shtetasit të një vendi pas pranimit të tij në BE. Për momentin, as shtetasit e tetë shteteve të reja anëtare nuk e kanë të drejtën e lëvizjes së lirë, por kjo e drejtë do t’u

⁶ Në kohën që Strategjia Kombëtare për Migracionin ishte duke u hartuar , drafti i strategjisë për luftën kundër trafikimit të fëmijëve është dërguar në Këshillin e Ministrave për miratim.

⁷ Nënkupton të drejtën për një shtetas evropian për t’u vendosur në bazë të disa kushteve në një shtet tjetër anëtar të BE

jepet pas shtatë viteve. Në një kuptim më të ngushtë, është shumë e vështirë që shtetasit shqiptarë të përfitojnë nga e drejta për të udhëtuar jashtë vendit pa vizë për një periudhë maksimale prej tre muajsh, për shkak të rrezikut të imigracionit të paligjshëm duke kaluar afatin kohor. Kjo nuk do të thotë që nuk mund të diskutohet për lehtësira në procedurat e vizave me shtetet anëtare të BE për një lëvizje më të lirë të shtetasve shqiptarë. Në kuadrin e masave të parashikuar nga ky dokument mund të përmendim:

- Përmirësimin e legjislacionit mbi menaxhimin e kufirit;
- Forcimin e bashkëpunimit institucional dhe krijimin e një institucioni të përgjithshëm të kufirit;
- Krijimin e një baze të dhënash të efektshme për regjistrimin e të gjithë njerëzve që hyjnë dhe dalin nga Shqipëria dhe detaje të tjera përkatëse që mund të lidhen me baza të dhënash të vendeve të tjera dhe mundësinë e lidhjes së kësaj baze të dhënash me zyrat konsullore;
- Krijimin e një liste të zezë për personat të cilët nuk mund të largohen nga Shqipëria pasi janë nën ndjekje penale;
- Ngritjen e kapaciteteve të policisë dhe forcimin e bashkëpunimit policor ndërkombëtar për të përmirësuar kontrollin kufitar, krimin e organizuar, trafiket e paligjshme etj.

Monitorimi i zbatimit të planit të masave për përmirësimin e lëvizjes së lirë i është ngarkuar Departamentit të Koordinimit që varet nga Ministri i Shtetit.

Në lidhje me lëvizjen e lirë të njerëzve, krijimi i një zone pa kontrole të brendshme ndërmjet disa shteteve të rajonit sipas modelit Shengen ka qenë një objektivi i sugjeruar shpesh nga autoritetet shqiptare dhe mund të jetë një nga temat e debatit që do të zhvillohet pas prezantimit të Strategjisë Kombëtare për Migracionin e cila mund të përfshihet si objektivi afatgjatë në Planin Kombëtar të Veprimit për Migracionin. Realizimi i këtij objektivi do të kërkonte marrëveshje dhe bashkëpunim të ngushtë ndërmjet shteteve fqinjë të Ballkanit.

Kuadri ligjor dhe politik për imigracionin

Imigracioni në Shqipëri është i pakonsiderueshëm nëse do të krahasohej me qindra e mijëra shqiptarë që kanë emigruar në perëndim. Numri i shtetasve të huaj që janë pajisur me leje pune nga shkurti 1996 deri në ditët e sotme rezulton në 5940. Gjatë periudhës janar 2004-qershor 2004 janë pajisur me leje pune 381 shtetas të huaj. Megjithatë, pavarësisht numrit të vogël të emigrantëve në vend, Qeveria ka bërë përpjekje për të hartuar dhe plotësuar një kuadër ligjor dhe administrativ bashkohor në zbatim të detyrimeve që rrjedhin si rezultat i pjesëmarrjes në një sërë organizmash ndërkombëtarë si edhe si rezultat i rënshkrimit të shumë instrumentave ndërkombëtarë në mbrojtje të të drejtave të imigrantëve.

Ligji për të Huajt, miratuar në 27 Maj 1999, përbën aktin ligjor kryesor në fushën e imigracionit në Shqipëri. Politika e qeverisë shqiptare synon përafrimin e procedurave dhe llojeve të vizave, shkallës së sigurisë në përputhje me standartet Shengen dhe përafrimi i regjimit të vizave me *acquis* BE.

Në kuadër të gjitha përpjekjeve për përafrimin me standartet e BE, në janar të vitit 2004 është botuar një raport mbi kuadrin ligjor dhe institucional të Shqipërisë krahasuar me atë të BE dhe me standartet ndërkombëtare. Raporti, i cili është rezultat i një bashkëpunimi të

ngushtë ndërmjet ekspertëve të zyrës së IOM në Tiranë me ekspertë të shumë institucioneve qeveritare, nxjerr në pah mangësitë në legjislacionin shqiptar mbi imigracionin dhe jep rekomandime të qarta mbi masat që duhet të ndërmerren nga Shqipëria si në kuadrin ligjor ashtu edhe në atë institucional për të përmbushur kërkesat e BE dhe instrumentave të tjerë ndërkombëtarë në fushën e migracionit. Rezultatet e këtij raporti janë përfshirë në mënyrë të përmbledhur në këtë strategji në pjesën ku trajtohet imigracioni në Shqipëri.

POLITIKAT E BASHKIMIT EVROPIAN PËR SHQIPËRINË

Politikat e BE për Shqipërinë në fillim të viteve '90 duhen parë nën këndvështrimin e Procesit të Stabilizim Asocimit (PSA) i cili do të çojë në marrëveshjen për integrimin e Shqipërisë si një shtet i ri anëtar (1). Me hyrjen në mijëvjeçarin e ri, çështjet e drejtësisë dhe të rendit morën rëndësi të madhe në fushën e bashkëpunimit ndërmjet BE dhe Shqipërisë ku politikat e migracionit fillimisht u përqëndruan në luftën kundër imigracionit të paligjshëm (2). Sot, në mënyrë progresive, shfaqet një qëndrim i ri, i cili ka si synim zgjerimin e bashkëpunimit në fushën e migracionit. Kjo çështje është veçanërisht e rëndësishme në lidhje me përmbajtjen e Strategjisë Kombëtare për Migracionin në Shqipëri (3).

Politika globale e BE për Shqipërinë

Marrëveshja e parë ndërmjet Shqipërisë dhe BE u nënshkrua në vitin 1992. Ajo ishte një marrëveshje tregtare dhe nuk përmbante ndonjë element lidhur me çështjet e drejtësisë dhe të rendit. Në prill të vitit 1997, Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme të BE miratoi një Metodë Rajonale, duke vendosur kushte politike dhe ekonomike për zhvillimin e marrëdhënieve dypalëshe ndërmjet pesë vendeve të rajonit (Shqipëria, Bosnje-Hercegovina, Kroacia, Republika Federale e Jugosllavisë dhe Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë). Kushtet parashikonin respektimin e parimeve demokratike, të drejtave të njeriut, shtetit të së drejtës, mbrojtjen e minoriteteve, reformat e ekonomisë së tregut dhe bashkëpunimit rajonal. Në maj të vitit 1999, Komisioni Evropian propozoi krijimin e Procesit të Stabilizim Asociimit këto vende. Ky është një kuadër ku instrumenta të ndryshëm synojnë dhënien e ndihmës për këto vende për të kapërcyer tranzicionin politik dhe ekonomik në mënyrë që t'i përgatisin ato ato për një formë të re të marrëdhënieve kontraktuale. Qëllimi i kësaj marrëdhënieje më të afërt është pranimi i Shqipërisë në BE në një periudhë afatgjatë.

Sipas deklaratës së BE të muajit maj të vitit 1999⁸ në lidhje me PSA për vendet e Evropës Juglindore, objektivat kryesore do të jenë:

- Orientimi i rajonit më pranë perspektivave të integritit të plotë në strukturat e BE;
- Mbështetja e konsolidimit të demokracisë, shtetit të së drejtës, zhvillimit ekonomik dhe reformave, strukturave të përshtatshme administrative dhe bashkëpunimit rajonal;
- Krijimi i një kuadri zyrtar për dialogun politik, si në nivelin dypalësh ashtu edhe në atë rajonal;
- Nxitja e marrëdhënieve ekonomike, tregëtare, investimeve, politikave të sipërmarrjes, transportit, zhvillimit dhe bashkëpunimit në fushën e doganave;

⁸ COM (99) 235 më 26 Maj 1999, Fq.6

- Sigurimi i një baze për bashkëpunim në fushën e çështjeve të drejtësisë dhe rendit;
- Sigurimi i një baze për bashkëpunim ekonomik, social, civil, edukativ, shkencor, teknologjik, mjedisor dhe kulturor.

Një program i quajtur CARDS (Ndihmë Komunitetit për Rindërtim, Zhvillim dhe Stabilizim) është krijuar për t'u siguruar ndihmë vendeve që janë në PSA. Ndërkohë që vendet janë të orientuara ndaj këtij procesi, nga komuniteti i BE do të ketë një ndihmë në rritje në mbështetje të reformave dhe krijimit të institucioneve të nevojshme për të përmbushur detyrimet e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (MSA).

Përfundimet e mbledhjes së Selanikut të Këshillit Evropian hartuar në vjeshtën e vitit 2003 identifikuan rrugët e intensifikimit të Procesit të Stabilizim Asocimit nëpërmjet prezantimit të Partneritetit Evropian. Qëllimi i partneritetit ishte identifikimi i përparësive për veprim mbështetur në përpjekjet për t'u afruar me BE. Përparësitë janë përshtatur sipas nevojave specifike të secilit vend. Pritet që vendet të miratojnë një plan ku të përfshihet një program dhe hollësi mbi mënyrën sesi mendojnë ata t'i paraqesin përparësitë. Fusha të tjera, përveç çështjeve të drejtësisë dhe rendit, të përfshira në marrëveshjen e partneritetit janë demokracia dhe shteti i së drejtës, të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve, bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar, ekonomia e tregut të lirë dhe reformat strukturore, administrimi i financave publike, mjedisi dhe telekomunikacioni.

MSA ndërmjet Shqipërisë dhe BE që ka filluar të negociohet do të mbështetet në katër shtylla ku çështjet e drejtësisë dhe rendit do të kenë përparësi .

Duhet theksuar rëndësia e veçantë e përmasave ndërkombëtare të MSA. Politikat nuk janë hartuar dhe të nuk janë të zbatueshme vetëm për Shqipërinë, por janë në nivel rajonal, ku përfshihet Bosnje-Hercegovina, Kroacia, Serbia dhe Mali i zi dhe Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë. Në takimin e Zagrebit që u mbajt në nëntor të vitit 2000 ku u takuan drejtues të BE me kryetarët e shteteve të lartpërmendura, këta të fundit shprehën gatishmërinë e tyre “për të hartuar konventën e bashkëpunimit rajonal ndërmjet vendeve të tyre në funksion të arritjes së dialogut politik, të një zone të tregut të lirë rajonal dhe bashkëpunimit të afërt në fushën e çështjeve të drejtësisë dhe rendit, në veçanti për forcimin e drejtësisë dhe pavarësisë, me qëllim për të luftuar krimin e organizuar, korrupsionin, pastrimin e parave, imigracionin e paligjshëm, trafikimin e qënieve njerëzore dhe të gjitha format e tjera të trafikut”.

Shqipëria objektiv i BE si një vend me përparësi në luftën kundër imigracionit të paligjshëm

Shqipëria është vënë në mënyrë të vazhdueshme në fokusin e BE, i cili ka vënë theksin në luftën kundër imigracionit të paligjshëm si një nga përparësitë kryesore të politikave të përbashkëta për imigracionin dhe azilin, fillesa e të cilit përkon me programin e Amsterdimit dhe takimin e Tampere në vitin 1999.

Kur BE krijoi në vitin 1998 Grupin e Punës të Nivelit të Lartë mbi azilin dhe migracionin me qëllim që të përgatitej plani i veprimit për vlerësimin e situatës në disa shtete të cilët përdoren nga migrantët për të hyrë në vendet e BE, Shqipëria ishte një nga gjashtë vendet kryesore të identifikuar nga Këshilli i Ministrave të BE. Objektivat kryesore të planit të veprimit për Shqipërinë, të miratuar në fund të vitit 1999, ishin:

- Financimi nga BE i nismave në fushën e parandalimit të flukseve të imigracionit;
- Ushtrimi i presionit nga BE dhe vendet anëtare mbi autoritetet shqiptare për të bërë çdo përpjekje për të parandaluar dhe luftuar trafikimin e paligjshëm të emigrantëve nga Shqipëria;
- Financimi i fushatave informuese në Shqipëri për të siguruar informacion të besueshëm mbi emigracionin e rregullt;
- Ushtrimi i presionit të BE ndaj Shqipërisë për të zbatuar marrëveshjet ekzistuese të ripranimit. BE dhe Shqipëria duhet të nënshkruajnë më tej një marrëveshje të përgjithshme ripranimi në kuadrin e një marrëveshjeje të ardhshme të stabilizim asociimit;
- Mbështetja nga BE dhe shtetet anëtare të programeve dhe nismave të cilat nxisin kthimin vullnetar dhe riintegrimin në Shqipëri.

Në nëntor të vitin 2002, këshilli i BE vuri në fokus për herë të dytë Shqipërinë si një vend me përparësi në përfundim të “bashkëpunimit të intensifikuar për menaxhimin e flukseve të migracionit me vendet e treta”. Një listë e përbërë prej nëntë vendesh ku përfshihej Shqipëria së bashku me Kinën, Republikën e Serbisë dhe Malit të Zi, Maroku, Rusia, Tunizia, Ukraina, Libia dhe Turqia, u përpunua për të intensifikuar bashkëpunimin nëpërmjet një dialogu mirëkuptimi si dhe nëpërmjet përfshirjes së një paragrafi mbi menaxhimin e përbashkët të flukseve migratore në çdo marrëveshje të jashtme të nënshkruar nga BE. Në strategjinë e hartuar për Shqipërinë për periudhën 2002-2006, përparësitë e caktuara në fushën e azilit dhe migracionit janë:

- Luftë efikase kundër trafikimit dhe imigracionit të paligjshëm;
- Krijimi i strukturave të përshtatshme për azilin dhe migracionin, duke marrë parasysh se Shqipëria është një vend i rëndësishëm tranziti për refugjatët, azilkërkuesit dhe migrantët që duan të drejtohen për në Evropë.

Programi për vendet e Ballkanit Perëndimor miratuar në mbledhjen BE të mbajtur në Selanik në qershor të vitit 2003 vuri theksin mbi rëndësinë e luftës kundër imigracionit të paligjshëm nëpërmjet bashkëpunimit të autoriteteve kompetente të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe rrjetit të zyrtarëve të BE që merren me çështjet e imigracionit të shteteve anëtare, dhe nëpërmjet marrëveshjeve të ripranimit midis vetë vendeve të PSA dhe vendeve të treta. BE është i ndërgjegjshëm për rëndësinë që i kushtojnë njerëzit dhe qeveritë në vendet e Ballkanit Perëndimor perspektivës së liberalizimit të regjimit të vizave, por çdo progres në këtë drejtim varet nga zbatimi i disa reformave të rëndësishme në fusha të ndryshme, si shteti i së drejtës, lufta kundër krimit të organizuar, forcimi i kapaciteteve administrative në kontrollin kufitar dhe niveli i sigurisë së dokumentave.

Në raportin e Grupit të Punës të Nivelit të Lartë drejtuar Këshillit Evropian në Nisë, në lidhje me vlerësimin e ecurisë deri më 2000, theksohet se “edhe pse ky plan veprimi u pranua i fundit, është bërë shumë progres në zbatimin e tij”. Në raportin e Stabilizim Asociimit të vitit 2004, Komisioni Evropian bëri vlerësimin e situatës si më poshtë:

- Është ecur përpara në fushën e politikës së vizave;
- Nuk ka patur shumë zhvillime në fushën e menaxhimit të kufirit;
- Është hartuar një raport mbi mangesitë e kuadrit ligjor dhe institucional në fushën e emigracionit në Shqipëri;

Një marrëveshje ripranimi është lidhur ndërmjet BE dhe Shqipërisë në dhjetor të vitit 2003 dhe mendohet të hyjë në fuqi në vitin 2005 kur të përfundojë procedura legislative për ratifikimin. Duke marrë parasysh se Shqipëria së bashku me Maastricht, Hong-Kongun, Kinën dhe Sri Lankën është një nga të paktat vende që kanë pranuar të nënshkruajnë një marrëveshje të tillë me BE, kjo tregon një hap pozitiv, pasi përfshin jo vetëm shtetasit shqiptarë, por edhe ata të vendeve të treta të cilët kalojnë tranzit në rrugë të ligjshme apo të paligjshme nëpërmjet territorit shqiptar.

Pyetësori i raportimit për periudhën mars 2003 - shkurt 2004 në lidhje me zbatimin e strategjisë kundër trafikimit, miratuar nga qeveria shqiptare në vitin 2001, tregon se kjo strategji është një sukses i gjithëpranuar, në veçanti në lidhje me imigracionin tranzit, por sidoqoftë mbeten disa dobësi që lidhen me disa mangësi në procesin e arrestimit të trafikantëve.

Së fundi, është me vend të theksohet se dimensionin rajonal është veçanërisht i rëndësishëm në fushën e migracionit. Në mars të vitit 2001, vendet e BE dhe ato të Procesit të Stabilizim Asociimit miratuan një vendim mbi masat konkrete në vijim të deklaratës së miratuar në mbledhjen e Zagrebit për sa i përket azilit dhe migracionit. Nisma rajonale për migracionin, refugjatët dhe azilin (MARRI) synon përafrimin e standarteve evropiane dhe përmirësimin e bashkëpunimit rajonal sipas një metode të koordinuar të çështjeve të migracionit dhe politikave të azilit në rajon. Fushat e identifikuar si të rëndësishme për bashkëpunim janë si vijon: azili, migracioni i ligjshëm, imigracioni i paligjshëm, kontrolli kufitar, politikat e vizave dhe ato të hyrjes. Në maj të vitit 2001 në Sarajevë u mbajt një takim që pati si rezultat konkret krijimin e një grupi pune për bashkëpunimin dhe zhvillimin e menaxhimit kufitar në Evropën Juglindore. Në nëntor të vitit 2002 u zhvillua në Londër konferenca në nivel ministrash rreth luftës ndaj krimit të organizuar në Evropën Juglindore. Imigracioni i paligjshëm dhe trafikimi i qenieve njerëzore ishte një nga angazhimet kryesore të marra nga ministrat pjesëmarrës. Më në fund, gjatë një konference rajonale të mbajtur në Ohër në maj të vitit 2003, vendet e Ballkanit Perëndimor së bashku me katër organizata partnere (NATO, BE, OSBE dhe Pakti i Stabilitetit) ranë dakort për një platformë të përbashkët për sigurinë dhe menaxhimin e kufirit.

Nevoja për zhvillimin e politikave të imigracionit drejt një metode më të efektshme

Politika Evropiane mbi migracionin, e cila fillimisht ishte e përqendruar në luftën kundër imigracionit të paligjshëm, ashtu siç u përmend edhe më lart, tashmë po zhvillon një metodë më efektive e cila merr në konsideratë interesat e vendeve të treta. Në dhjetor të vitit 2002, Komisioni miratoi një deklaratë për integrimin e çështjeve të migracionit në marrëdhëniet e BE me vendet e treta, sipas së cilës Këshilli miratoi përfundimet mbi “migracionin dhe zhvillimin” në Maj 2003. Këto përfundime theksojnë se “objektivat afatgjata të BE duhet të jenë të tilla që të vazhdojnë të identifikojnë shkaqet e migracionit. Kjo duhet bërë në partneritet me vendet e treta duke patur njohje të plotë të programeve të zhvillimit afatgjatë mbi flukset e migracionit, zbutjen e varfërisë, zhvillimin ekonomik, krijimin e vendeve të lira të punës, nxitjen e institucioneve të konsoliduara, respektimin e të drejtave të njeriut, duke njohur politikat e zhvillimit të popullsisë, ngritjes së institucioneve, rritjes së kapaciteteve dhe parandalimit të konflikteve”. Duke nënvizuar nevojën për dialog mbi çështjet e migracionit ndërmjet BE dhe vendeve të treta nga vijnë migrantët, Këshilli i kërkoi Komisionit të bëjë propozime përpara fundit të vitit 2004 mbi çështjet e mëposhtme:

- Përcaktimi i ekuilibrit ndërmjet kërkesës dhe ofertës dhe organizimit të lejeve të punës, psh. nëpërmjet lejeve të përkohshme për qëndrim dhe punë;
- Gjetja e rrugëve për të lehtësuar qarkullimin e individëve me aftësi të veçanta, psh. nëpërmjet mundësimit të kontratave ndërmjet shteteve anëtare të BE dhe vendeve në zhvillim;
- Lehtësimi i komunikimit ndërmjet komuniteteve trans-nacionale dhe vendeve të tyre të origjinës;
- Përcaktimi i rrugëve të transferimit të fondeve nga BE në vendet e origjinës me komisione më të lira dhe në rrugë më të besueshme. Të propozohet, kur është e përshtatshme, hartimi i programeve pilot për të kanalizuar dërgesat e emigrantëve në investime prodhuese në vendet e origjinës dhe të vlerësohet ndikimi i tyre në flukset migruese në periudha afatgjata;
- Integrimi më i mirë i migrantëve të ligjshëm të cilët jetojnë dhe punojnë në vendet e BE;
- Sigurimi i koherencës ndërmjet migracionit dhe politikave të zhvillimit, meqë mund të ketë probleme nga punësimi i punonjësve me kualifikim të lartë nga disa vende në zhvillim;

Ky zhvillim në politikat e BE në fakt është një përshtatje me idetë bazë të përfundimeve të takimit të Tamperes. Megjithë theksin e vënë mbi këto përfundime, ku parimi bazë është ai i partneritetit me vendet e treta, BE ka qënë shumë i fokusuar në përparësitë që lidhen me luftën kundër imigracionit të paligjshëm e cila është kryesisht, pse jo dhe ekskluzivisht, në interes të tij. Përfundimet mbi “një mekanizëm monitorues dhe vlerësues të vendeve të treta në fushën e luftës kundër imigracionit të paligjshëm”, të miratuar nga Këshilli në dhjetor të vitit 2003 tregojnë se ky zhvillim nuk është arritur dhe se ekuilibri ndërmjet interesave të BE dhe të atyre të vendeve të treta si Shqipëria duhet të mbahet vazhdimisht parasysh.

Mekanizmi i lartpërmendur përqendrohet në luftën kundër imigracionit të paligjshëm, pasi ky mekanizëm është hartuar për të zbatuar përfundimet e takimit të Seviljes që kërkon krijimin e mekanizmit monitorues dhe vlerësues për vendet e treta të cilat nuk bashkëpunojnë në luftën kundër imigracionit të paligjshëm, pra është e çuditshme që Shqipëria është vënë në shënjestër në një rast të tillë. Progresi i bërë nga Shqipëria, veçanërisht me nënshkrimin e marrëveshjes së ripranimit me BE është i dukshëm dhe i njohur nga BE, edhe pse nevojiten përpjekje të tjera, veçanërisht për zbatimin e saj. Qëllimi i këtij mekanizmi duhet të qartësohet për të siguruar një zbatim të duhur jo vetëm për luftën kundër imigracionit të paligjshëm, por për të gjitha pjesët e një politike të qartë migracioni, për shembull masat e reja të parashikuara në Strategjinë Kombëtare për Migracionin si nxitja e migracionit qarkullues të shqiptarëve dhe mobilizimi i diasporas shqiptare për zhvillimin e Shqipërisë.

Zhvillimet e reja në një të ardhme jo të largët janë më premtuese.

Sipas vendimit të Këshillit mbi Partneritetin Evropian me Shqipërinë të datës 14 qershor 2004, përparësitë për migracionin janë si më poshtë:

Për periudhën afatshkurtër:

- Miratimi dhe fillimi i zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Migracionin në Shqipëri;

- Marrja e të gjithave masave se procedurat e nevojshme për të nënshkruar dhe ratifikuar marrëveshjen e ripranimit Shqipëri/BE do të përfundojnë brenda vitit 2004.

Për periudhën afatmesme:

- Të vërtetohet nëse Shqipëria është në gjendje të plotësojë kërkesat e MSA në lidhje me qytetarët e BE që punojnë dhe/ose jetojnë në Shqipëri;
- Zbatimi i të gjitha marrëveshjeve të ripranimit që ka nënshkruar Shqipëria;
- Marrja e masave për të lidhur marrëveshjet e ripranimit me të gjitha vendet e rajonit dhe me vendet e origjinës të migrantëve të cilët kalojnë tranzit nëpër Shqipëri.
- Përfundimi, ratifikimi dhe zbatimi i shpejtë i të gjitha konventave kryesore ndërkombëtare në fushën e migracionit.

Sipas MSA ndërmjet BE dhe Shqipërisë, ka shumë të ngjarë që dispozitat e saj për migracionin të jenë shumë të ngjashme, nëse jo të njëjta, me ato të marrëveshjeve ekzistuese me Maqedoninë dhe Kroacinë. Këto marrëveshje parashikojnë “palët do të bashkëpunojnë në fushën e vizave, kontrollit të kufirit, azilit dhe migracionit” dhe do të krijojnë një kuadër për bashkëpunim, duke përfshirë nivelin rajonal në këto fusha. Bashkëpunimi do të përqendrohet në veçanti në dokumentacionin e rregullt të udhëtimit dhe zbulimin e dokumentave të rreme në fushën e migracionit të ligjshëm, mbi ligjet dhe të drejtat e pranimit dhe statusit të personave të pranuar dhe mbi parandalimin dhe kontrollin e imigracionit të paligjshëm si edhe të ripranimit.

Edhe pse këto instrumenta duken shumë të përqendruara në luftën kundër imigracionit të paligjshëm dhe në veçanti të ripranimit, ato kanë hapësira të cilat do të përfshihen në Strategjinë Kombëtare për Migracionin në Shqipëri.

PJESA E DYTË: UDHËZIMET PËR POLITIKAT

A. Lufta kundër migracionit të paligjshëm

A.1 Lufta kundër shkaqeve të emigracionit

I. Analiza e situatës aktuale

Dihet se njerëzit emigrojnë kur në vendin e tyre mungojnë burimet dhe mundësitë për të përmbushur nevojat dhe aspiratat e tyre. Kjo është gjendja e emigrantëve shqiptarë të cilët janë larguar për një jetë më të mirë për veten dhe familjet e tyre pas një periudhe të gjatë komuniste dhe tranzicioni e cila rezultoi në varfëri dhe në nivele të larta papunësie. Termi “nje jetë më e mire” përfshin një gamë të gjerë faktorësh që i detyrojnë shqiptarët të largohen dhe është e reflektuar në mungesën e njëtrajtshmërisë ndërmjet emigrantëve shqiptarë. Faktorët kryesore janë si më poshtë:

1. **Faktori ekonomik**: Shqiptarët largohen kryesisht për arsye ekonomike siç janë mungesa e mundësive të punësimit, kushtet e vështira të jetesës, veçanërisht në disa zona ku mungojnë kushtet elementare si energjia elektrike, uji dhe strehimi. Nivelet e larta të papunësisë, veçanërisht si pasojë e reformave në ekonominë shqiptare menjëherë pas rënies së komunizmit, kanë qenë faktori kryesor për flukset masive të emigracionit pas viteve ‘90 e këtej.

Mungesa e mundësive të punësimit në Shqipëri, e gërshetuar me kërkesat e tregut të punës në vendet pritëse për krah të lirë pune në fusha si ndërtimi, bujqësia, turizmi, etj., është një faktor i madh nxitës për emigracionin e personave të pakualifikuar. Nga ana tjetër, shumë shqiptarë të kualifikuar me diplomë universitare kanë emigruar si rezultat i mungesës së mundësive të përshtatshme të punësimit në Shqipëri dhe janë punësuar jashtë vendit në pozicione larg kualifikimit të tyre.

2. **Siguria publike**: Shqipëria është përballur me flukse masive emigratore si pasojë e nivelit të ulët të sigurisë publike apo trazirave në vend. Një numër i madh i personave të kualifikuar me kushte të mira ekonomike janë larguar nga vendi për një të ardhme më të sigurt për veten dhe familjen e tyre. Kjo dukuri ka ndodhur veçanërisht pas trazirave të vitit 1997 që u shoqëruan me një valë tjetër të eksodit masiv.

3. **Institucionet e dobëta** çojnë në mungesën e besimit të qytetarët për përmirësimin e situatës në vend ku korrupsioni dhe krimi i organizuar paralizojnë funksionimin normal të institucioneve shtetërore. Institucionet e dobëta dhe vështirësitë në zbatimin e ligjit gjithashtu ndikojnë në përpjekjet dhe perspektivat e emigrantëve për t’u kthyer dhe vendosur në vend, veçanërisht kur ata hasin vështirësi në ndërtimin e aktiviteteve private apo në marrëdhënie me administratën publike.

II. Prezantimi i politikave aktuale

Siç e përmendëm shkurtimisht më lart, faktorët që shkaktojnë emigracionin janë pjesë e një problematike më të gjerë që ka prekur shoqërinë shqiptare në përgjithësi. Qeveria ka miratuar disa strategji për trajtimin e disa nga faktorët bazë të përmendur më lart.

Strategjia Kombëtare për Zhvillimin Social-Ekonomik që është miratuar në vitin 2001, e parashikuar për t’u zbatuar gjatë viteve 2002-2004, është hapi i parë i ndërmarrë për

zhvillimin e vendit nëpërmjet një rritjeje ekonomike të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse. Disa nga qëllimet e strategjisë janë: ulja e numrit të shtetasve që jetojnë në varfëri, përmirësimi i infrastrukturës dhe shërbimeve përkatëse, përmirësimi i gjendjes shëndetësore dhe arsimore, etj. Në mars të vitit 2002 u miratua Strategjia për Zhvillimin Rural e cila prezanton një qëndrim të përqendruar në nxitjen e rritjes ekonomike dhe uljes së varfërisë në zonat rurale. Ky dokument vë në dukje rolin që luan emigracioni në humbjen e forcës më aktive të punës në vend, sidomos në zonat rurale, dhe thekson nevojën për luftimin e shkaqeve të migracionit dhe jo thjesht kufizimin e flukseve të migracionit.

Strategjia për Punësimin dhe Formimin Profesional e miratuar në janar të vitit 2003 është një tjetër iniciativë që parashikohet se do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në krijimin e mundësive për punësim. Strategjia parashikon krijimin e vendeve të punës në vend nëpërmjet përmirësimit të tregut të punës, kualifikimin e personelit nëpërmjet trainimit të vazhdueshëm dhe zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Strategjia vlerëson konsolidimin, përmirësimin dhe zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme si instrumente të rëndësishëm për hapjen e vendeve të reja të punës. Edhe pse kjo Strategji nuk e trajton në mënyrë të veçantë menaxhimin e emigracionit, sukcesi i saj do të ketë një ndikim të konsiderueshëm në këtë drejtim, pasi faktori kryesor i emigracionit është papunësia.

Në lidhje me përmirësimin e funksionimit të strukturave shtetërore, Shqipëria është angazhuar në shumë raste për të marrë masa efektive për të luftuar korrupsionin dhe për të forcuar shtetin e së drejtës. Autoritetet shqiptare kanë treguar shqetësimin e tyre në luftën kundër korrupsionit në shumë Dokumenta Politike siç është Strategjia Kundër Korrupsionit e vitit 1998, e cila është shoqëruar me Planin e Veprimit 2002-2003 dhe atë të 2003-2004, i cili aktualisht është në fazë zbatimi.

III. Vlerësimi dhe perspektiva e politikave aktuale

Emigracioni në Shqipëri është trajtuar kryesisht në kuadrin e masave kundër trafikimit dhe menaxhimit të kufijve. Megjithatë, nga vetë natyra e tij, emigracioni nuk mund të luftohet vetëm me masa represive, por gjithashtu kërkohen masa parandaluese. Ky fenomen mund të trajtohet siç duhet me metoda afatgjata të përqendruara në shkaqet e migracionit në një këndvështrim afatgjatë. Ky qëndrim është në përputhje me Politikën e Përbashkëta Evropiane për Imigracionin. Në pikën 11 të përfundimeve të Takimit të Tampere të mbajtur në tetor të vitit 1999, i cili u kushtojë tërësisht çështjeve të imigracionit, kryetarët e shteteve dhe qeverive theksuan se “BE duhet të zhvillojë një metodë gjithëpërfshirëse e cila të trajtojë migracionin në aspektin e çështjeve politike, të drejtave të njeriut dhe ato të zhvillimit në vendet dhe rajonet e origjinës dhe tranzitit. Për këtë duhen marrë masa kundër uljes së varfërisë, përmirësimit të kushteve të jetesës dhe mundësive të punësimit, parandalimit të konflikteve dhe konsolidimit të shteteve demokratike dhe respektimit të të drejtave të njeriut.”

Siç u theksua më lart, Shqipëria ka hartuar strategji të ndryshme të cilat po shkojnë në rrugë të mbarë. Megjithatë, ato janë miratuar vetëm kohët e fundit dhe procesi i zbatimit është ende në hapat e para. Një politikë bashkëkohore mbi emigracionin kërkon zbatimin e të gjitha masave të parashikuara në Planin e Veprimit apo Strategjitë ekzistuese. Dukuria e emigracionit duhet parë si një element i veçantë në kuadrin e të gjitha strategjive të tjera përkatëse. Për të qënë të suksesshme këto strategji duhen trajtuar të ndërlidhura pavarësisht nga konfliktet e interesave apo mbivendosjet ndërmjet politikave

të emigracionit dhe politikave të tjera. Kjo për faktin se efektet e tyre do të ndjehen për një periudhë afatgjatë. Autoritetet përgjegjëse për çdo strategji, duhet të bashkëpunojnë me organet e ngarkuara për politikën e emigracionit, me qëllim që të parashikojnë masat e veçanta që duhen marrë në lidhje me emigracionin.

Ky shqetësim është marrë parasysh në Strategjinë për Zhvillimin Rural dhe të paktën pjesërisht në Strategjinë për Punësimin dhe Formimin Profesional por jo në nivelin e duhur në Strategjinë për Zhvillimin Social-ekonomik.

Strategjia për Zhvillimin Rural merr parasysh lidhjet ndërmjet emigracionit dhe bujqësisë. Të ardhurat relativisht të larta të siguruara nga emigracioni kanë ulur veprimtarinë bujqësore në vend. Kjo është një nga arsyt kryesore pse Shqipëria detyrohet të importojë pothuaj të gjitha produktet bujqësore. Nëse puna do të vlerësohej siç duhet, emigrantët shqiptarë që punojnë në sektorin e bujqësisë në vendet fqinje si Greqia dhe Italia do të preferonin të bënin të njëjtën punë në vendin e tyre. Duhet të merren masa të menjëhershme për zbatimin e kësaj strategjie, e cila synon gjallërimin e sektorit bujqësor në Shqipëri.

Strategjia për Punësimin dhe Formimin Profesional prek çështjen e formimit profesional për emigrantët e kthyer të cilët gjenden në kushte të vështira ekonomike. Kjo është një iniciativë e mire nese do të zbatohet në mënyrë të drejtë me qëllim që të plotësojë nevojat e emigrantëve të kthyer në mënyrë që ata të mos largohen sërish nga vendi. Megjithatë, fokusi i strategjise duhet të zgjerohet me qëllim që të parashikojë masa për punësim të qëndrueshëm. Për më tepër, kjo strategji nuk i konsideron emigrantët e mundshëm si grup i veçantë të cilët duhet të trajtohen me masa të veçanta për të shmangur largimin e tyre nga Shqipëria duke hyrë në rrugë të paligjshme në vendet e huaja. Programi për regjistrimin e shtetasve që duan të emigrojnë për motive punësimi jashtë vendit, që do të zbatohet nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale në zbatim të ligjit “Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi”⁹ dhe udhëzimit të Ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale për “Funksionimin e regjistrimit për emigrantët”¹⁰, do të krijojë mundësinë e identifikimit të shtetasve që duan të emigrojnë për qëllime punësimi për të analizuar situatën e tyre social-ekonomike dhe për t’u ofruar atyre mundësi punësimi.

Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale duhet të bëjë një studim për të identifikuar zonat më të prekura nga emigracioni dhe të krijojë një mekanizëm të përthyer për të ndjekur zhvillimin e gjendjes. Për shembull, kjo mund të bëhet duke përcaktuar vendin e origjinës të shtetasve të kthyer. Mbi bazën e të dhënave të siguruara në këtë mënyrë, të cilat mund të ndërthuren me të dhënat e papunësisë, do të bëhej e mundur nxitja e krijimit të mundësive të punësimit duke joshur dhe favorizuar investimet në ato zona.

Strategjia për Zhvillimin Social-Ekonomik nuk e trajton në mënyrë të veçantë emigracionin. Për këtë arsye, një vëmendje e veçantë duhet t’u kushtohet zonave pothuajse të braktisura nga emigrantët për shkak të mungesës së kushteve jetike bazë siç janë furnizimi me ujë, energji elektrike dhe infrastruktura dhe të planifikohen mënyrat për t’i rigjallëruar ato zona.

⁹ Shih Ligjin Nr. 9034 datë 20.03.2003

¹⁰ Shih Ligjin Nr. 1297 datë 16.07.2004

IV. Propozime për zbatim:

1. Institucionet përkatëse shqiptare që merren me politikat migratore duhet të japin kontributin e tyre dhe të rishikojnë strategjitë sektoriale që zbatohen nga ministrinë e ndryshme të linjës, në mënyrë që ky shqetësim i rëndësishëm të zërë vend në politikat e tyre. Propozimet për strategjitë e ardhshme duhen paraqitur përpara miratimit përfundimtar të tyre dhe duhen marrë masa në lidhje me zbatimin e tyre; për strategjitë që janë në fazën e zbatimit këto sugjerime duhet të shtohen përmbajtjes ose ta modifikojnë atë (kjo fillimisht duhet bërë në lidhje me zbatimin e Strategjisë për Zhvillimin Social-Ekonomik). Përputhja e strategjive në fjalë me Strategjinë Kombëtare për Migracionin duhet të jetë objekt i një raportimi të veçantë.
2. Strategjia për Zhvillimin Rural duhet të vlerësohet në bazë të fluksit të punëtorëve emigrantë në sektorin e bujqësisë për të zhvilluar mundësi punësimi më tërheqëse në këtë sektor brenda Shqipërisë.
3. Strategjia për Punësimin dhe Formimin Profesional duhet së pari, të bëjë vlerësimin në se emigrantëve të kthyer u janë ofruar kurse profesionale dhe së dyti duhet të përfshijë edhe ndihmën që ju ofrohet emigrantëve të kthyer për të gjetur punësim të qëndrueshëm ose për të krijuar SME në mënyrë që të përhapin potencialin e tyre migrator.
4. Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale në bashkëpunim me INSTAT-in, do të kryejnë një studim për të identifikuar zonat e prekura në mënyrë të veçantë nga nivele të larta të emigrimit legal, mundësisht edhe atij ilegal, për të vlerësuar flukset aktuale të migrimit si edhe për të monitoruar zhvillimet e tyre në të ardhmen.
5. Në bazë të përfundimeve të studimit të mësipërm, qeveria do të mbështesë zonat e identifikuar për të nxitur investimet nëpërmjet krijimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (SME) dhe nëse është e mundur, për të përmirësuar kushtet në shëndetësi, arsim dhe infrastrukturë.

A.2 Kthimi i Migrantëve

A.2.1. Kthimi i shtetasve shqiptarë nga shtetet anëtare të BE

I. Analiza e situatës aktuale

Është e vështirë të matet fluksi i emigrantëve të kthyer në Shqipëri pasi në regjistrimin e popullsisë të vitit 2001 nuk u mor parasysh numri i tyre. Procesi i kthimit të emigrantëve shqiptarë ka qenë nga vullnetar deri dhe në kthim të detyruar dhe është realizuar nëpërmjet një sërë rrugësh. Disa kthime kanë qenë individuale edhe pse shifra nga institucionet lokale theksojnë se kjo dukuri është e kufizuar. Mbi 300 individë janë kthyer në Shqipëri ndërmjet viteve 2000 - 2004 nëpërmjet programeve të kthimit vullnetar të IOM, kryesisht nga shtetet evropiane perëndimore. Sipas programeve të kthimit, të kthyerve u është dhënë ndihmë financiare dhe materiale.

Mbi 30.000 individë janë ripranuar apo janë dëbuar për në Shqipëri gjatë vitit 2003. Një numër i madh i tyre janë dëbuar si pasojë e hyrjes/qëndrimit të parregullt në shtetet evropiane, ku shpesh individët janë ndaluar për këtë qëllim. Pjesa më e madhe e tyre janë nga Italia dhe Greqia ku një numër i madh emigrantësh qëndrojnë pa leje, si edhe nga vende si Mbretëria e Bashkuar ku emigrantët shqiptarë nuk kanë patur sukses në kërkesën e tyre për azil. Numri i shtetasve të ripranuar është rritur gjatë viteve të fundit si pasojë e

thjeshtimit të procedurave. Sipas marrëveshjeve ekzistuese të ripranimit, nuk është parashikuar ndonjë ndihmë për të kthyerit pas kthimit të tyre. Në rastet e dëbimit nga disa shtete të BE të kthyerit nuk kthehen në Shqipëri, por në Kosovë, pasi kanë përdorur të tillë identitetet. Kjo formë e kthimit e ka vështirësuar punën e autoriteteve për të verifikuar identitetin dhe për të regjistruar incidentet e ndodhura gjatë apo pas rikthimit.

Kthimi i emigrantëve shqiptarë në Shqipëri shpeshherë kryhet në rrugë ajrore, megjithatë rastet e kthimeve nga Greqia dhe Italia bëhen nëpërmjet rrugëve tokësore si dhe nga portet e Durrësit dhe Vlorës. Pas kthimit, autoritetet përkatëse përzgjedhin të gjithë individët të cilët janë dëbuar; po krijohen mënyra për të siguruar që grupet e pambrojtura, siç janë viktimat e trafikimit dhe të miturit, të marrin ndihmë.

Nuk janë bërë shumë kërkime në lidhje me ndikimin e emigrantëve të kthyer në Shqipëri. Megjithatë ka një interes në rritje për këtë dukuri, veçanërisht pas numrit në rritje të marrëveshjeve të ripranimit. Mënyra e kthimit (vullnetar apo i detyruar) ka një ndikim të qartë në qëndrueshmërinë e kthimit dhe në aftësinë dhe dëshirën e migrantëve të kthyer për riintegrim. Disa burime sugjerojnë se migrantët e kthyer janë në veçanti të rinj dhe të pamartuar.

II. Prezantimi i politikave aktuale

Të gjitha marrëveshjet e ripranimit kanë si objekt shtetasit e vendeve të treta dhe shtetasit shqiptarë. Këto marrëveshje rregullojnë çështje administrative dhe procedurale në lidhje me kthimin, që janë kompetencë e Ministrisë së Rendit Publik.

Strategjia kombëtare e luftës kundër trafikimit nuk e përmend kthimin si dukuri më vete, por e përdor atë në kuadrin e riintegrimit. Varianti jopërfundimtar i strategjisë kombëtare për luftën kundër trafikimit të fëmijëve është më e plotë se strategjia e lartpërmendur pasi ajo përqendrohet në tre përmasa të procesit të kthimit: mbrojtja dhe riintegrimi i fëmijëve viktimat të trafikimit; kthimi vullnetar i asistuar; bashkërendimi i pjesëmarrësve të angazhuar në luftën kundër trafikimit të fëmijëve. Plani i veprimit i lëvizjes së lirë ka parashikuar dispozita në lidhje me kthimin, e cila lidhet kryesisht me zbatimin e ripranimit. Ky veprim thekson nevojën për trainimin e policisë mbi çështjet e ripranimit ndërkohë që përqendrohet te të drejtat e njeriut sipas një afati të caktuar dhe aktorëve përgjegjës.

Baza ligjore e angazhimit për ofrimin e ndihmës për të kthyerit është në ligjin për “Emigrimi i Shtetasve Shqiptarë për Motive Punësimi”. Sipas nenit 13 “Shteti nxit kthimin vullnetar të emigrantëve në atdhe dhe riintegrimin e tyre në jetën ekonomike dhe sociale të vendit, nëpërmjet krijimit të lehtësive ligjore, financiare dhe fiskale dhe të zbatimit të programeve të zhvillimit të biznesit, punësimit dhe të formimit profesional”. Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale është institucioni përgjegjës për kujdesin dhe mbrojtjen sociale të të kthyerve. Ligji mbi funksionet konsullore (neni 4, paragrafi 3) gjithashtu siguron asistencë financiare për qytetarët shqiptarë për t’u kthyer në Shqipëri në raste të veçanta pas aprovimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme. Strategjia kombëtare për zhvillimin social-Ekonomik (2001) nuk përmban ndonjë referencë për emigrantët e kthyer dhe pak i referohet ligjit për funksionet konsullore, ndërkohë që në kuadrin e strategjisë kombëtare mbi punësimin dhe formimin profesional (2003) del nevoja për t’u dhënë mundësi për trainim profesional emigrantëve të kthyer për të përballuar problemet ekonomike dhe sociale. Masa të tilla janë thelbësore lidhur me njohjen e nevojave për të trajtuar shkaqet bazë të migracionit.

III. Vlerësimi dhe perspektiva e politikave aktuale

Politika aktuale ka treguar një angazhim të qartë për të kthyerit si një element i politikës së migracionit, veçanërisht me përfundimet e marrëveshjes së ripranimit ndërmjet Shqipërisë dhe BE. Kjo marrëveshje ka të ngjarë të hyjë në fuqi për shtetasit shqiptarë në vitin 2005. Zbatimi i saj ka shumë përparësi.

Strategjia Kombëtare e Luftës Kundër Trafikimit të Fëmijve nuk ka hyrë ende në fuqi¹¹, Strategjia Kombëtare kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore nuk ka dispozita për kthimin ndërsa Plani i Masave për Lëvizjen e Lirë të Njerëzve nuk është zbatuar akoma në lidhje me kthimin. Si rrjedhojë, masat lidhur me kthimin duhen rishqyrtuar. Strategjia draft e lartpërmendur parashikon të ofrojë ndihmë për të miturit e pashoqëruar të cilët janë shfrytëzuar, por mund të interpretohet me përjashtimin e rasteve të të miturve të pashoqëruar të cilët nuk janë shfrytëzuar.

Moszbatimi i bazave ligjore në lidhje me ligjin për emigracionin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi ka bërë që masat e propozuara për dhënien e ndihmës ndaj emigrantëve që janë kthyer vullnetarisht të mos jenë krejtësisht të efektshme. Këshilli i Ministrave nëpërmjet një vendimi duhet të specifikojë se cilat kategori të të kthyerve vullnetarisht do të përfitojnë asistencë për riintegrim dhe çfarë ndihme do t'u ofrohet. Kjo bëhet duke patur parasysh faktin se një sërë personash të kthyer nuk janë domosdoshmërisht të kthyer vullnetarisht, për këtë arsye nevojitet të përshtaten dispozita të cilat përfshijnë kategori të tjera të të kthyerve.

Për më tepër, në Strategjinë Kombëtare për Punësimin dhe Formimin Profesional në lidhje me kthimin e migrantëve duhen parashikuar masa konkrete në lidhje me politikat e kthimit dhe zhvillimit. Studime në fushën e “migracionit të kthyer” sugjerojnë parashikimin e mundësive për krijimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme si edhe punësimin e qëndrueshëm, në vend të disa trainimeve profesionale të parashikuara në atë strategji. Të gjitha këto masa mund të vlerësohen si kryesore në trajtimin e shkaqeve të migracionit dhe për të siguruar kthim të qëndrueshëm.

Në të njëjtën kohë, problemet e politikave duhet të zbatohen në mënyrën e duhur. Në këtë kuadër, është e nevojshme të qartësohen dhe forcohen institucionet përgjegjëse për përzgjedhjen dhe trajtimin e migrantëve të kthyer, në veçanti në lidhje me ripranimin. Mbledhja, regjistrimi dhe analiza e të gjithë të dhënave në lidhje me migrantët e kthyer duhet të përmirësohet. Në këtë kuadër kërkohet një bashkëpunim ndërministror ndërmjet Ministrisë së Rendit Publik, e cila merret me procesin e kthimit, dhe Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, e cila merret me procesin e riintegrimit. Në këtë kuadër nevojitet informacion më i plotë në lidhje me vendin e kthimit.

IV. Propozime për zbatim:

6. Marrja e të gjitha masave për zbatimin e duhur të marrëveshjeve të ripranimit;
7. Përgatitja dhe shpërndarja e broshurave që ju drejtohet emigrantëve mbi kthimin vullnetar, ku të jepet informacion në lidhje me statusin dhe te drejtat e tyre si edhe me shërbimet që ju ofrohen nga përfaqësitë diplomatike dhe konsullore si

¹¹ Në periudhën në të cilën kjo strategji u miratua, Strategjia kundër Trafikimit të Fëmijve nuk kishte hyrë në fuqi.

edhe nga shoqatat e emigrantëve me mbështetjen e organizatave kombëtare ose ndërkombëtare.

8. Miratimi i masave për t'u siguruar të kthyerve të mitur ndihmën dhe mbrojtjen e nevojshme edhe pse ata nuk janë trafikuar dhe si të tillë nuk janë objekt i strategjisë kombëtare të luftës kundër trafikut të fëmijëve.
9. Miratimi i akteve nënligjore për zbatimin e nenit 13 të ligjit për emigracionin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi lidhur me ndihmën ndaj të kthyerve vullnetarisht.
10. Vlerësimi i zbatimit të Strategjisë për Punësim dhe Formim Profesional për mundësitë për formim profesional për emigrantët e kthyer. Mbështetja e të kthyerve për një punësim të qëndrueshëm dhe krijimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në mënyrë që të shmang emigracionin e mundshëm.
11. Shërbimit Kombëtar të Punësimin dhe zyrate të saj lokale dhe rajonale ti shtohet përgjegjësia për të siguruar ndihmën për të kthyerit.

A.2.2. Kthimi i shtetasve të vendeve të treta në Shqipëri nga shtetet anëtare të BE.

I. Analiza e situatës aktuale

Në vitin 2000 emigrantët nga rajoni i Evropës Juglindore përbënin pothuajse gjysmën e numrit të përgjithshëm të emigrantëve tranzit në Evropë. Këtu përfshihen shtetas nga vendet e rajonit, si edhe nga vendet e treta. Deri më sot nuk ka patur raste të regjistruara të kthimit të qytetarëve të vendeve të treta në bazë të marrëveshjeve ekzistuese të ripranimit me shtetet anëtare të BE. Megjithatë, sipas Ministrisë së Rendit Publik, kthimi i personave nga vendet e treta (ku përfshihen emigrantët nga Kosova) është bërë nga Italia dhe shtete të tjera. Ekziston një marrëveshje verbale se shtetasit nga vendet e treta të cilët kanë kaluar tranzit nga Shqipëria nuk do të rikthehen më aty. Marrëveshja e ripranimit Shqipëri/BE në një nen të saj parashikon për shtetasit e vendeve të treta, shtyrjen e zbatimit të saj për dy vjet. Pra, kjo marrëveshje nuk do të zbatohet deri në vitin 2007.

II. Prezantimi i politikave aktuale

Një politikë angazhimi në lidhje me kthimin e shtetasve të vendeve të treta që kanë kaluar tranzit Shqipërinë mund të gjendet në planin e masave për lëvizjen e lirë. Shqipëria aktualisht ka nënshkruar 11 marrëveshje ripranimi dypalëshe dhe shumëpalëshe, por jo të gjitha këto kanë hyrë në fuqi. Pjesa më e madhe e këtyre marrëveshjeve janë me BE dhe shtete të tjera. Zbatimi i marrëveshjeve të ripranimit me BE është përparësi në Procesin e Stabilizim Asocimit.

III. Vlerësimi dhe perspektiva e politikave aktuale

Shqipëria ka treguar gatishmërinë e saj duke lidhur marrëveshjen e ripranimit me BE, ku përfshihen shtetasit e vendeve të treta. Pritja dhe kthimi nga këto vende i shtetasve që kanë kaluar tranzit në Shqipëri është një përparësi afatmesme në bazë të nenit ku parashikohet shtyrja e zbatimit të marrëveshjes për dy vjet. Megjithatë, ekziston nevoja e trajtimit të problemit për sa i përket planifikimit. Shqipëria është vendi i vetëm në Evropën Juglindore që ka nënshkruar marrëveshje ripranimi me BE. Për këtë arsye duhet shmangur "kurthi i ripranimit" të shtetasve nga vende të treta që të mos ngelen në Shqipëri.

IV. Propozime për zbatim:

- | | |
|-----|---|
| 12. | Planifikimi i të gjitha masave që duhen marrë për zbatimin e marrëveshjes së ripranimit Shqipëri/ BE në lidhje me shtetasit e vendeve të treta, dhe në veçanti krijimi i një sistemi që do të mundësonte përcaktimin e fluksit të shtetasve të vendeve të treta që rikthehen në Shqipëri; |
| 13. | Planifikimi i miratimit të akteve të nevojshme ligjore mbi procedurën e dëbimit, ku përfshihet edhe ndalimi i të kthyerve; |
| 14. | Planifikimi i ndërtimit të ambjenteve për mbajtjen e shtetasve të vendeve të treta në pritje të shpërnguljes. |

A.2.3 Kthimi i shtetasve të vendeve të treta nga Shqipëria për në vendet e tyre.

I. Analiza e situatës aktuale

Kthimi i shtetasve të vendeve të treta lidhet ngushtë me identifikimin e migrantëve të paligjshëm nëpërmjet sistemit të përzgjedhjes për identifikimin e personave që kanë hyrë dhe qëndrojnë në mënyrë të paligjshme në territorin e shtetit shqiptar. Numri i përgjithshëm i shtetasve të vendeve të treta që janë kthyer në vendin e tyre të origjinës gjatë viteve të fundit përkon me uljen e numrit të imigrantëve të parregullt në territorin e Shqipërisë. Kjo është një dukuri e re. Aktualisht, nuk rezulton që shtetasit e vendeve të treta të jenë kthyer në vendin e tyre të origjinës apo në vende të tjera sipas marrëveshjeve ekzistuese të ripranimit apo mekanizmave të dëbimit. Kjo është realizuar nëpërmjet programeve të kthimit vullnetar ose nga ambasadat e vendeve që kanë interes të drejtpërdrejtë. Në kuadrin e programeve të IOM për kthimin vullnetar, që nga viti 2001, janë kthyer 194 persona që më pas janë ndihmuar të kthehen në vendet e tyre të origjinës. Nuk ka informacion në lidhje me numrin e individëve të cilët janë kthyer jashtë këtij programi.

Kthimi vullnetar i asistuar është bërë sipas memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Rendit Publik dhe IOM. Në programin e ndihmës për kthimin bëjnë pjesë migrantët e parregullt të ndaluar nga autoritetet shqiptare, migrantët e parregullt që janë në Shqipëri dhe kërkojnë të kthehen vullnetarisht në vendin e origjinës dhe azilkërkuesit, aplikimet e të cilëve për statusin e refugjatit janë refuzuar nga autoritetet shqiptare dhe nuk janë në gjendje të kthehen në mundësitë e tyre. Kthimi është çështje e dëshirës së vetë migrantit. Një paketë standarte u ofrohet të kthyerve ku përfshihet informacioni, ndihma psikosociale, pritja përpara kthimit dhe transporti.

Qendrat paraprake të pritjes dhe qendrat kombëtare të pritjes

Migrantët e parregullt (ku përfshihen viktimat e trafikimit dhe personat që nuk janë azilkërkues) fillimisht priten në “ambientet ku bëhet përzgjedhja” në të gjithë vendin. Këto ambiente përdoren për përzgjedhjen e parë të migrantëve të parregullt nga policia përpara dorëzimit të tyre tek autoritetet përkatëse. Aktualisht ekzistojnë nëntë ambiente

ku bëhet përzgjedhja fillestare¹², dhe është parashikuar të ndërtohen ambiente të tjera. Qendra Kombëtare e Pritjes së viktimave të trafikimit pret viktima të trafikimit shqiptarë dhe të huaj. Migrantët e paligjshëm të cilët nuk kanë kërkuar për azil dhe dëshirojnë të kthehen në vendin e tyre të origjinës janë strehuar gjithashtu në këtë qendër. Refugjatët dhe azilkërkuesit (përfshi këtu edhe individët të cilëve u është refuzuar kërkesa) priten në ambiente të veçanta të cilat janë nën administrimin e Ministrisë së Rendit Publik.

II. Prezantimi i politikave aktuale

Kthimi i shtetasve të vendeve të treta lidhet me luftën kundër migracionit të paligjshëm në kuadrin e procedurave të përzgjedhjes. Procedura e përzgjedhjes e cila funksionon që nga viti 2001, përmban udhëzime për institucionet përkatëse në Ministrinë e Rendit Publik për shtetasit e parregullt të vendeve të treta ku përfshihen azilkërkuesit, migrantët ekonomikë të paligjshëm dhe viktimat e trafikimit. Janë bërë plane për të patur punonjës ndërmjetës midis punonjësve të pikave kufitare dhe atyre që merren me përzgjedhjen e migrantëve. Ligji për të Huajt parashikon me hollësi procedurat për shpërnguljen dhe dëbimin nga territori i Shqipërisë. Ministria e Rendit Publik është institucioni përgjegjës për lëshimin dhe zbatimin e urdhrave të dëbimit.

Objektivat e Planit të Veprimit për Lëvizjen e Lirë janë forcimi i shërbimeve që merren me nënshkrimin dhe zbatimin e marrëveshjes së ripranimit; trainimi i organeve të policisë mbi ripranimin dhe të drejtat e njeriut; planifikimi i një programi investimi për ndërtimin e qendrave të pritjes në vendet tranzit për trajtimin e rasteve të ripranimit dhe dëbimit. Strategjia e kontrollit kufitar dhe menaxhimit të integruar të kufirit përmban referenca për migracionin, përveç krijimit të qendrave të ndara për azilkërkuesit dhe migrantët ilegalë, edhe nënshkrimin dhe ratifikimin e marrëveshjeve të ripranimit me vendet e origjinës dhe të tranzitit prej nga vijnë migrantët e paligjshëm.

Ligji “ Për Ruajtjen dhe Kontrollin e Kufirit Shtetëror të Republikës së Shqipërisë¹³ përbën bazën ligjore për pritjen dhe ndalimin e migrantëve të parregullt. Ndërkohë që baza ligjore për krijimin e qendrave të pritjes është Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.46 datë 07.02.2002, që miraton rregulloren për funksionimin e qendrave të pritjes dhe trajtimin e përkohshëm për të huajt që nuk kanë kërkuar azil. Drejtoria e Policisë Kufitare dhe Migracionit është përgjegjëse për drejtimin e këtyre qendrave.

III. Vlerësimi dhe perspektiva e politikave aktuale

Procesi i përzgjedhjes ndërmarrë nga Ministria e Rendit Publik në bashkëpunim me institucionet ndërkombëtare ka akoma punë për t’ju kaluar autoriteteve përkatëse. Megjithëse në MRP ekzistojnë një struktura të posacme për trajtimin e viktimave të trafikimit dhe azil kerkuesit, respektivisht Sektori Kundër Trafikimit dhe Drejtoria për Refugjatët, nuk është krijuar akoma një njësi e posacme në MRP për të mbuluar të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me trajtimin e migrantëve të parregullt. Aktualisht, çështjet që kanë të bëjnë me migrantët mbulohen nga disa struktura të vecanta në MRP.

¹² Këto ambiente ndodhen në Rinas, Tiranë, Gjirokastër, Vlorë, Peshkopi, Shkodër, Elbasan, Kukës dhe Korçë.

¹³ Neni 5, Ligji 8772. Ky nen thekson se të huajt të cilët hyjnë në mënyrë të parregullt në territorin e Shqipërisë dhe kapen nga policia në zonën kufitare apo brenda territorit të vendit do të dërgohen në qendrat e përkohshme të pritjes për të huajt. Vendndodhja e qendrave dhe funksionimi i tyre do të vendoset nga Këshilli i Ministrave.

Kthimi i asistuar vullnetar është për momentin e vetmja mënyrë ekzistuese për të garantuar funksionimin efikas të sistemit të azilit. Në mënyrë që programet e kthimit vullnetar të funksionojnë siç duhet, është e nevojshme të kryhen kthime të detyruara. Mekanizmat e dëbimit do të kenë nevojë të shoqërohen me asistencën e lartëpërmendur ndaj të kthyerve në bazë të standarteve ndërkombëtare.

IV. Propozime për zbatim:

15. Emigrantët e parregullt të informohen në lidhje me mundësitë e kthimit vullnetar në atdhe.
16. Të sigurohet informacion përpara kthimit, ndihmë mjekësore dhe këshillim për të gjitha kategoritë e të kthyerve;
17. Rritja e bashkëpunimit me ambasadat e vendeve të origjinës për të lehtësuar dokumentacionin e nevojshëm për t'u kthyer;
18. Ndërmarrja e bisedimeve me vendet e treta për të përfunduar marrëveshjet e ripranimit; të kërkojë ndihmë e BE-së për këtë;
19. Rishikimi i asistencës aktuale të siguruar nga MPCŞ për strehimin e të kthyerve vullnetarë në Qendrën Kombëtare të Pritjes për viktimat e trafikimit dhe parashikimi i ambjenteve alternative.

B. Emigracioni dhe zhvillimi i Shqipërisë

B.1. Përfitimet nga Shqiptarët që jetojnë jashtë vendit

B.1.1. Mbështetja e emigrantëve shqiptarë

B.1.1.1. Përmirësimi i imazhit të emigrantëve shqiptarë jashtë vendit

I. Analiza e situatës aktuale

Imazhi i Shqipërisë dhe i popullit shqiptar jashtë vendit shpesh mbart efekte negative të cilat nuk ndihmojnë në pasqyrimin e ndryshimeve të mëdha që po ndodhin në vend, që në pjesën më të madhe janë pozitive dhe po çojnë drejt përmirësimit të cilësisë së jetës në një vend që ka dalë nga një periudhë izolimi 50 vjeçar. Emigrantët shqiptarë, veçanërisht ata që gjenden në Greqi dhe Itali, ku është përqëndruar edhe pjesa më e madhe e tyre, kanë qenë në qendër të një klime jofavorizuese, e cila në shumë raste është shfaqur në formën e diskriminimit dhe ksenofobisë. Një propagandë antishqiptare është ndërmarrë dhe vazhdon të ndërmerret nga media në vendet pritëse të emigrantëve shqiptarë.

Për të mbetur në një vlerësim objektiv dhe të ekuilibruar, është e rëndësishme të përcaktohen arsyet që kanë kontribuar në krijimin e këtij imazhi. Një nga arsyet është përbërja shoqërore e një kategorie emigrantësh e cila karakterizohet nga individë me nivel të ulët kulturor dhe arsimor. Kjo gjë ka ndikuar negativisht në integrimin ekonomik dhe kulturor dhe në nivelin e lartë të kriminalitetit brenda emigracionit shqiptar. Një tjetër faktor është shprehja e ksenofobisë në debatet politike dhe elektorale mbi migracionin në vendet pritëse, e cila ka një ndikim të madh në opinionin publik. Duke gjykuar nga të dhënat e shtypit, mund të theksohet se emigracioni shqiptar paraqitet si një element shqetësues për shoqërinë e vendit pritës. Kjo gjë ndikon në perceptimin e gabuar se i

gjithë komuniteti i emigrantëve shqiptarë është i përfshirë në aktivitete kriminale, kur në fakt kjo është e vërtetë vetëm për një pjesë të vogël të këtij komuniteti.

Gjatë viteve të fundit imazhi i emigrantëve shqiptarë ka filluar të përmirësohet disi si rezultat i kontributeve pozitive të disa emigrantëve të suksesshëm, si nxënës apo studente të cilët kanë rezultate shumë të mira në shkollat ku studiojnë.

II. Prezantimi i politikave aktuale

Megjithë angazhimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme për të bërë disa përpjekje për të përmirësuar imazhin e Shqipërisë jashtë vendit, janë ndërmarrë vetëm disa nisma private për ta realizuar këtë.

Kështu, në Maj të vitit 2003, me mbështetjen e Presidentit të Republikës së Shqipërisë dhe të Ambasadorit të Shqipërisë në Austri është hapur në Vjenë Instituti Shqiptar për Kulturën, me kontributet financiare të emigrantëve shqiptarë në Austri.

Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara po zbaton një projekt të quajtur “Imazhi i Shqipërisë” në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Ministrinë e Integritimit Evropian. Qëllimi i këtij projekti është përmirësimi i cilësisë dhe sasisë së informacionit që është i disponueshëm për Shqipërinë dhe bashkëpunimi me partnerë qeveritarë, median dhe qeverisjen vendore për të rritur aftësitë në krijimin e një imazhi më pozitiv të vendit dhe të popullit. Ky program synon krijimin e kapaciteteve në Ministrinë e Punëve të Jashtme për të prodhuar të dhëna në kohë dhe të sakta mbi Shqipërinë dhe përdorimin e tyre nga një publik i gjerë.

III. Vlerësimi dhe perspektiva e politikave aktuale

Momentalisht nuk ka ndonjë politikë të veçantë për përmirësimin e imazhit të emigrantëve shqiptarë në vendet pritëse. Për të mundur këtë gjë shteti duhet të mbështetet në përvojën e përmendur më lart. Si pasojë e mjeteve të kufizuara financiare në dispozicion për këtë qëllim, kjo pjesë e strategjisë duhet të përqendrohet kryesisht tek Greqia dhe Italia, ku jetojnë pjesa më e madhe e emigrantëve. Këtyre komuniteteve mund t’u bëhet thirrje për të kontribuar financiarisht dhe në rrugë të tjera.

Edhe pse instituti i parë i kulturës shqiptare u hap në Vjenë, ku numri i emigrantëve shqiptarë është shumë i vogël, ky komunitet tregoi vitalitetin dhe gatishmërinë për të bashkëpunuar në projekte të tilla. Ka ardhur koha të bëhet realitet ideja e Presidentit të Republikës e shprehur në fjalimin e tij përpara trupit diplomatik në 27 gusht 2003, gjatë të cilit ai tha se “edhe në këtë drejtim qeveria duhet të mendojë e të punojë më shumë për gjetjen e fondeve të nevojshme dhe për hapjen e institucioneve të tilla, fillimisht në ato vende ku ka komunitet të madh shqiptar”. Sipas rendit të përparësive Greqia dhe Italia janë dy vendet kryesore të cilëve duhet t’u kushtohet vëmendje. Vetë numri shumë i madh i emigrantëve shqiptarë në këto dy vende mund të bëjë të mundur sigurimin e fondeve të nevojshme nga vetë emigrantët.

Marrëveshje kulturore dypalëshe apo duhet të lidhen të paktën me Greqinë dhe Italinë dhe duhet të merren masa për zbatimin e atyre ekzistuese me qëllim rritjen e shkëmbimeve kulturore duke nxjerrë në pah aspekte të përbashkëta të trashëgimisë së vendeve pritëse dhe vendeve të origjinës të emigrantëve.

Një mënyrë tjetër për përmirësimin e imazhit të shqiptarëve jashtë vendit është edhe vënia në dukje e rasteve të suksesshme, në qendër të të cilëve janë emigrantët shqiptarë si arritja e rezultateve të larta në shkollë e nxënësve dhe studentëve shqiptarë (bëhet e ditur se shpesh studentët shqiptarë kanë rezultate të larta); sipërmarrës të cilët drejtojnë kompani, sportistë, studiues shkencorë apo artistë. Për t'i identifikuar ata së pari duhet të nisë një fushatë njohjeje për dhënien e titullit “Ambasadori i Shqipërisë”, i cili ekziston dhe i është dhënë disa personaliteteve nga Presidenti i Republikës. Së dyti, është e nevojshme gjetja e burimeve financiare për fushatën mediatike për promovimin e emigrantëve të suksesshëm brenda dhe jashtë kufijve.

Dukuria e emigracionit shqiptar gjatë viteve nëntëdhjetë përgjithësisht njihet, por fatkeqësisht shpesh është prezantuar keq nga mediat në opinionin publik duke pasqyruar vetëm efektet negative, siç është kriminaliteti. Në përgjithësi theksi është vënë tek pasojat negative për vendet pritëse dhe përfitimet nuk përmenden e madje injorohen. Aktualisht, kontributi i emigrantëve në vendet pritëse dhe në veçanti në ekonominë e tyre është mjaft i madh. Nuk mund të lëmë pa përmendur faktin se disa prej tyre po shfrytëzohen nga njerëzit e atij vendi. Qeveria duhet t'i vërë detyrë Televizionit Shqiptar të përgatisë një dokumentar mbi emigracionin shqiptar për të nënvizuar kompleksitetin e asaj dukurie dhe të gjitha pasojat e saj pozitive dhe negative për Shqipërinë si edhe për vendet pritëse, në veçanti për Greqinë dhe Italinë. Duhet të kërkohet bashkëpunimi i televizioneve greke dhe italiane për të lehtësuar mbledhjen e informacionit në vendet pritëse dhe mundësisht për të financuar projektin. Ndërkohë që ky dokumentar duhet të bazohet në informacionin përkatës, një komitet kërkuesish i përbërë nga specialistë të migracionit dhe përfaqësues të shoqatave të emigrantëve shqiptarë duhet të krijohet për të mbështetur gazetarët të cilët janë të ngarkuar me përgatitjen e tij. Për të patur një numër sa më të madh shikuesish, ky dokumentar do të përkthehet në greqisht, italisht dhe anglisht.

Së fundi, duhen përmendur përpjekjet që janë bërë deri tani për trajtimin e migracionit dhe në veçanti për të luftuar krimin e organizuar që lidhet me të nëpërmjet trafikimit dhe kontrabandës me të dhëna konkrete dhe të kuptueshme që duhet të qarkullohen jashtë vendit. Miratimi i Strategjisë Kombëtare për Migracionin gjithashtu do të sigurojë një mundësi të mirë për të shpjeguar bashkëpunimin gjatë viteve të fundit me Greqinë dhe Italinë në këtë kuadër dhe progresin e bërë nga Shqipëria në Procesin e Stabilizim Asocimit drejt integritit të saj në Evropë.

IV. Propozime për zbatim:

20. Krijimi i qendrave kulturore shqiptare në vendet pritëse ku gjendet një komunitet i madh shqiptar si në Greqi dhe Itali, për të promovuar imazhin e Shqipërisë dhe emigrantëve shqiptarë si edhe për të ofruar disa shërbime për komunitetin e emigrantëve shqiptarë.
21. Të parashikohet futja e elementit migrator në programet e bashkëpunimit kulturor që rrjedhin nga marrëveshjet kulturore me Greqinë dhe Italinë.
22. Promovimi i rasteve të emigrantëve të suksesshëm në vendet e tyre pritëse, siç janë nxënësit apo studentët më të mirë, sipërmarrësit, sportistët, shkenctarët dhe artistët. Nxitja e personave për t'u vlerësuar nga autoritetet shqiptare me titullin “Ambasadori i Shqipërisë”.
23. Të bëhet një dokumentar nga Televizioni Shtetëror Shqiptar mbi emigracionin shqiptar duke filluar që nga vitet nëntëdhjetë ku të theksohen të mirat dhe të këqijat e kësaj dukurie për Shqipërinë dhe për vendet pritëse, në veçanti për Greqinë dhe Italinë, dhe të sigurohet përkthimi në greqisht, italisht dhe anglisht.

24. Organizimi të paktën në Greqi dhe Itali i një fushate mediatike për të informuar rreth përpjekjeve të bëra në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar nga autoritetet shqiptare, në fushën e çështjeve të drejtësisë dhe rendit në veçanti, në lidhje me luftën kundër krimit të organizuar, kontrabandës dhe trafikimit të qënieve njerëzore.

B.1.1.2. Përmirësimi i shërbimeve konsullore dhe diplomatike shqiptare për shqiptarët në vendet pritëse.

I. Analiza e situatës aktuale

Aktualisht ekzistojnë 43 ambasada dhe konsullata shqiptare në të gjithë botën. Ato janë në të gjitha vendet ku janë vendosur komunitete të mëdha shqiptare. Në Greqi dhe Itali, të cilat janë dy vendet më të mëdha pritëse të emigrantëve shqiptarë, ka përkatësisht nga dy konsullata përveç ambasadave (në Greqi ato ndodhen në Selanik dhe Janinë, ndërsa në Itali ato ndodhen në Milano dhe në Bari). Në Turqi, ka gjithashtu një konsullatë në Stamboll përveç ambasadës në Ankara. Duket se për momentin ambasada e vetme e Shqipërisë që ka krijuar faqen e saj në internet është ajo në Paris, Francë.

II. Prezantimi i politikave aktuale

Sipas nenit 10, paragrafi 1, të ligjit për Emigrimin e Shtetasve Shqiptarë për Motive Punësimi” datë 20.03.2003 “Shteti shqiptar, nëpërmjet shërbimit konsullor në shtetet pritëse, ndihmon dhe lehtëson zgjidhjen e problemeve të shtetasve shqiptarë emigrantë”. E njëjta dispozitë e ligjit shton në paragrafin e 4 se “Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme hartojnë dhe zbatojnë programe për kualifikimin e personelit të shërbimit konsullor në fushën e emigracionit”. Hollësi në lidhje me llojin e ndihmës dhe lehtësirave janë dhënë në ligjin për “Ushtrimin e funksioneve konsullore nga përfaqësuesit diplomatikë dhe konsullorë” të datës 9 korrik 1998. Nëpunësit e ambasadave duhet të ndihmojnë shtetasit shqiptarë jashtë vendit të cilët kanë nevojë për ndihmë. Kjo ka të bëjë në veçanti me këshillimin ligjor, ndihmën e shtetasve shqiptarë të burgosur, transportimin e trupave të shtetasve shqiptare të cilët vdesin jashtë vendit.

Në lidhje me gjendjen civile, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile në Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit bashkëpunon me Ministrinë e Punëve të Jashtme, ambasadat dhe shërbimin konsullor. Një problem i veçantë i hasur nga konsullatat shqiptare që merren me legalizimin e dokumentave është se certifikatat e lindjes të shqiptarëve plotësohen me shkrim dore dhe kështu shpeshherë janë të palexueshme. Kjo nuk do të jetë problem në të ardhmen me futjen në përdorim të certifikatave të reja që do të kenë elemente sigurie. Fakti që ato janë hartuar në gjashtë gjuhë të huaja do të rrisë cilësinë e shërbimit të siguar për emigrantët.

Duke marrë parasysh nevojën e regjistrimit për shtetasit shqiptarë, vendimi nr. 828, datë 11.12. 2003 i Këshillit të Ministrave “Mbi modelin, elementët përbërës dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentave nga zyrat e gjendjes civile”, paraqet një pjesë të re në modelin e regjistrimit kryesor të gjendjes civile, ku do të regjistrohen adresat e emigrantëve. Kjo do të thotë se shtetasit që dëshirojnë të emigrojnë duhet të regjistrohen në zyrat e shërbimit civil.

Personeli i shërbimeve konsullore dhe diplomatike është trainuar shumë pak në fushën e emigracionit. Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale ka shpërndarë broshura në lidhje me sigurimet shoqërore të migrantëve shqiptarë jashtë vendit, në bashkëpunim me IOM ka përgatitur dhe shpërndarë një libër "Informimi për Migracionin" në ambasadat e Republikës së Shqipërisë në Greqi dhe Itali, për të kuptuar ligjet dhe praktikat e emigracionit. "Informimi për Migracionin" është rezultat i një projekti të IOM të quajtur "Module trainimi për personelin e ambasadave dhe personelin që merret me migracionin". Ky libër shpjegon procedurat e migracionit, rendit zyrtar që merren me administrimin e tij dhe jep me hollësi dokumentacionin e kërkuar për aplikime në Greqi, Itali, Maltë, Portugali dhe Spanjë. Për të nxitur sigurimet vullnetare shteti ka prodhuar broshura me informacion mbi skemën e sigurimeve shoqërore për t'ua shpërndarë emigrantëve në ambasadat e Republikës së Shqipërisë në Greqi dhe Itali.

III. Vlerësimi dhe perspektiva e politikave aktuale

Një vëmendje e veçantë i është dhënë shteteve pritëse ku janë vendosur komunitetet më të mëdha të emigrantëve shqiptarë, Greqisë dhe Italisë, duke hapur edhe konsullatat. Megjithatë duhen vlerësuar mjetet e nevojshme financiare dhe në veçanti burimet njerëzore që këto shërbime kanë në dispozicion.

Për shkak të mungesës së informacionit ambasadave shqiptare në vende ku komuniteti shqiptar është i konsiderueshëm do t'u kërkohej të përgatisin raporte të hollësishme jo vetëm për ndihmën e ofruar shtetasve shqiptarë (numri i personave të interesuar dhe lloji i ndihmës së ofruar), por edhe mbi gjendjen e komunitetit shqiptar. Ky raport do të përqëndrohet në situatën aktuale të emigrantëve dhe në vështirësitë që ata hasin, në vend të një përshkrimi të përgjithshëm apo historik. Çdo tre muaj ambasadat do të përgatisin një raport publik në lidhje me gjendjen aktuale të emigrantëve shqiptarë në shtetet pritëse me anë të shtypit, duke përdorur informacionin të cilin ata janë të detyruar ligjërisht ta mbledhin, në veçanti nëpërmjet faqes së tyre të internetit dhe kontakteve me shoqëritë që përfaqësojnë emigrantët shqiptarë në vend apo institucionet shtetërore ose shoqatat që mbrojnë të drejtat e imigrantëve në atë vend. Këto raporte të hartuara një herë në vit, do të dërgohen në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe në të gjitha ministrinë dhe institucionet e përfshira në menaxhimin e emigracionit.

Të gjithë diplomatët shqiptarë duhet të kenë njohjet e nevojshme në fushën e të drejtave të njeriut dhe në politikën e migracionit, në veçanti në lidhje me konventat ndërkombëtare dhe ato dypalëshe për migracionin dhe të drejtat e migrantëve. Për të mbrojtur siç duhet të drejtat e qytetarëve shqiptarë ambasadat dhe konsullatat shqiptare duhet të kenë në dispozicion të tyre ekspertë ligjorë të specializuar në politikën e të drejtave të njeriut dhe migracionit, në veçanti të kenë njohje të plotë të rregullave dhe praktikave të imigracionit të atij vendi. Shtetasve shqiptarë të cilët janë në ndjekje penale apo kanë qenë të dënuar penalisht duhet t'u ofrohet asistencë ligjore falas nëse është e nevojshme në rastet kur nuk ofrohet nga vendi pritës, në veçanti duhet siguruar që me shtetasin të komunikohet në një gjuhë që ai kupton ose me anë të përkthyesit nëse është e nevojshme.

Përmbajtja e trainimeve të ofruara për diplomatët shqiptarë duhet të vlerësohet dhe kontrollohet nëse përfshin një pjesë mbi politikën e të drejtave të njeriut dhe migracionit ashtu siç është përshkruar më lart, duke përfshirë menaxhimin e diasporës shqiptare. Duhet të përgatitet lista e plotë e numrit të avokatëve të specializuar për të drejtën dhe çështjet e migracionit dhe kjo listë të jetë e disponueshme nëpër ambasadat dhe konsullatat si edhe në shërbimet qendrore të MPJ. Në lidhje me njohjen e praktikave dhe rregullave

të brendshme të vendeve pritëse, zgjidhja më e përshtatshme do të ishte ose trainimi i punonjësve të shërbimit konsullor shqiptar në bashkëpunim me shërbimet kompetente në fushën e migracionit të vendit pritës, ose rekrutimi apo bashkëpunimi me avokatët e specializuar të vendeve pritëse. Ky problem duhet të zgjidhet nga çdo ambasadë apo konsullatë në varësi të kushteve dhe rrethanave lokale në atë vend.

Universitetet shqiptare duhet të inkurajohen dhe mbështetur për të hartuar programe të avancuara dhe lëndë mbi të drejtën e migracionit.

Informacioni bazë duhet të bëhet i disponueshëm nëpërmjet faqes së internetit për çdo ambasadë dhe shërbim konsullor. Ai duhet të përmbajë mënyrën e kontaktimit nëpër ambasada apo konsullata dhe llojet e shërbimeve që ato ofrojnë për shtetasit shqiptarë.

Për shkak të mjeteve financiare të kufizuara dhe numrit të madh të emigrantëve shqiptarë në Greqi dhe Itali, duhet filluar pikërisht me ambasadat dhe konsullatat e këtyre dy vendeve. Përvoja e fituar në këto dy vende kryesore më vonë mund të përdoret në ambasadat dhe konsullatat e tjera shqiptare nëpër botë sipas një rendi përparësish bazuar në rëndësinë e komunitetit shqiptar në vendet e interesuara.

IV. Propozime për zbatim:

25. Dhënia e përparësisë ndaj Greqisë dhe Italisë në lidhje me zbatimin e propozimeve të mëposhtme dhe renditja e vendeve të tjera sipas madhësisë së komunitetit shqiptar.
26. Vlerësimi i burimeve njerëzore, në dispozicion të MPJ-së në qendër dhe periferi, të specializuara në fushën e emigracionit që ofrojnë keshillim ligjor për dhe përpunimi i një plani për t'i pajisur ato me burimet e nevojshme;
27. Përfshirja, nëse mungon, në trainimet e diplomatëve shqiptarë, e një pjese mbi politikën e të drejtave të njeriut dhe migrimit;
28. Publikimi nga ana e MPJ-së, mbi bazën e një varianti të përpunuar nga ambasadat, i një raporti të hollësishëm mbi asistencën e dhënë ndaj qytetarëve shqiptarë dhe mbi gjendjen konkrete të komunitetit shqiptar në vendet e interesuara (ambasadat do të raportojnë çdo 3 muaj, ndërsa raporti përfundimtar do të hartohet një herë në vit nga MPJ).
29. Të verifikohet nëse emigrantët shqiptarë të ndaluar apo nën ndjekje penale kanë, nëse është e nevojshme, mundësinë për ndihmë ligjore dhe përkthim në gjuhën shqipe;
30. Vënia në dispozicion nëpërmjet internetit, për çdo ambasadë dhe konsullatë shqiptare, e informacionit bazë në lidhje me mundësinë e shërbimeve të siguruara për qytetarët shqiptarë;
31. Të ndërmjetësohet me Fakultetin e Shkencave Politike, Sociale dhe atë të Drejtësisë për të krijuar një program të veçantë mësimor në lidhje me emigrimin për në lidhje me ligjin e migrimit nparashikuar një .

B.1.1.3. Mbrojtja e të drejtave të emigrantëve shqiptarë

I. Analiza e situatës aktuale

Abuzimi përpara nisjes

Personat që dëshirojnë të migrojnë shpesh janë të pambrojtur ndaj abuzimeve. Shembuj të kontrabandistëve që bëjnë pretime “të mëdha” në këmbim të një shpërblimi të majmë për “shërbimet” e tyre janë të dukshme dhe të shpeshta. Inspektorati Shtetëror i Punës merr gjithashtu edhe ankesa për agjensitë private të punësimit, që u kërkojnë punëkërkuarëve të paguajnë shuma të mëdha për ndërmjetësimin për punë. Kjo përbën shkelje të nenit 4 të vendimit për mënyrën e liçensimit dhe funksionimit të agjensive private të punësimit¹⁴, që përcakton se kostoja e ndërmjetësimit duhet të mbulohet nga punëdhënësi dhe duhet të jetë falas për punëkërkuarësin.

Gjendja e emigrantëve jashtë vendit

Duke qenë se vendet kryesore pritëse për shqiptarët janë Greqia dhe pastaj Italia, Analiza e situatës aktuale do të përqendrohet në këto dy vende.

Gjendja e emigrantëve shqiptarë në Greqi

Që në fillim të vitit 1990 emigracioni shqiptar drejt Greqisë u shndërrua në një dukuri me rëndësi rajonale. Shqiptarët në Greqi janë në një numër të konsiderueshëm, më shumë se gjysmë milioni. Ata përbëjnë 65% të numrit të përgjithshëm të emigrantëve. Një numër i konsiderueshëm i tyre vazhdojnë të jenë pa dokumenta të rregullta.

Siç ndodh shpesh në një kontekst të tillë, emigracioni ka krijuar në njëfarë mënyre një treg pune të dyfishtë, me një hendek ndërmjet ekonomisë së ligjshme dhe sektorit të paligjshëm të punës, që vihet në pah nga punët me rroga të ulëta, që zakonisht bëhen nga emigrantët, ku pjesën më të madhe, për shkak të numrit mbizotërues, e zënë shqiptarët. Gjendja e strehimit mbetet shumë e mjeruar. Pikat kryesore me rëndësi kritike janë kujdesi shëndetësor (imigrantët e parregullt shqiptarë nuk përfitojnë shërbim spitalor as në rastet urgjente) dhe trajtimi i keq nga segmente të strukturave të policisë¹⁵. Diskriminimi është një dukuri e përhapur gjerësisht.¹⁶ Incidentet e dhunshme në kufirin mes Greqisë dhe Shqipërisë mbeten çështje shqetësuese.¹⁷

Qarqe të caktuara greke e ndonjëherë edhe organe të caktuara të shtypit grek kanë kultivuar dukurinë e mosbesimit dhe ksenofobisë veçanërisht ndaj emigrantëve shqiptarë. Duke mbështetur deklaratat që lidhin imigracionin e paligjshëm me rritjen e kriminalitetit, ato çuan në dhunë ndaj imigrantëve. Megjithë deklaratat zyrtare dhe denoncimet e strukturave politike, sociale dhe fetare greke, kjo sjellje mjaft e përhapur nuk është kufizuar.

Gjendja e emigrantëve shqiptarë në Itali

Komuniteti shqiptar është grupi i dytë më i madh në Itali pas atij Rumun. Në janar të vitit 2004, në Itali janë regjistruar 224,000 emigrantë shqiptarë me dokumenta të rregullta. Shqiptarët kanë zënë vend gjerësisht në mediat italiane, në mënyrë të veçantë pas valëve migratore të vitit 1991 dhe 1997. Imazhi i shqiptarëve i prezantuar në këto media i referohej një kategorie të kufizuar emigrantësh të lidhur me krimin. Shqiptarët përbëjnë një nga komunitetet e të huajve më të etiketuar dhe të përfolur. Mediat në fakt ndikuan në përhapjen tek qytetarët e thjeshtë të vendit pritës të një perceptimi ‘të përgjithshëm’ që i konsideron dhe perkufizon shqiptarët si kriminelë. Ky imazh negativ tashmë i mbrujtur

¹⁴ VKM nr 708, datë 16.10.2003

¹⁵ Raporti i Amnesty International, 2004

¹⁶ Departamenti i Shtetit i SHBA, Raportet për shtetet mbi praktikën e të drejtave të njeriut, Greqi 2003.

¹⁷ Informacion nga Komiteti Grek i Helsinkit, 2004

thellë në shoqërinë e shtetit fqinjë përbën pa dyshim një pengesë e madhe për integrimin shoqëror të shqiptarëve. Gjithsesi nuk janë vënë në dukje shkelje të rënda të të drejtave të njeriut ndaj shqiptarëve.

Ndihma sociale jashtë vendit

Problemet që mund të dalin në fushën e mbrojtjes sociale janë të paktën tre llojesh. Një problem vjen nga fakti që, për shkak të statusit të parregullt, shumica e emigrantëve shqiptarë jashtë vendit nuk kanë mundësinë e shërbimeve shëndetësore dhe sociale. Problemi i dytë mund të lindë kur mbrojtja sociale nuk organizohet si duhet në rastin e migracionit sezonal, edhe pse të rregullt. Veç kësaj ekziston edhe rreziku i humbjes së përfitimeve të sigurimeve shoqërore të përfituara gjatë qëndrimit jashtë vendit nëse nuk janë lidhur marrëveshje për të transferuar të drejtat.

II. Prezantimi i politikave aktuale

Ndërmjetësimi nga agjensitë private të punësimit

Është përcaktuar që ndërmjetësimi në rrugë private për punësim do të kryhet vetëm nga Agjensitë Private të Punësimit (neni 1). Në kohën që shkruajmë, ekzistojnë afërsisht pesë agjensi private punësimi të licënuara. Ato veprojnë kryesisht në Tiranë. Për të mbrojtur punëkërkuar nga abuzimi, Inspektorati Shtetëror i Punës kontrollon punën e agjensive me anën e inspektimeve.

Kuadri ligjor shqiptar për të drejtat e emigrantëve

Sipas nenit 8 të ligjit për emigracionin e shtetasve shqiptarë për qëllime punësimi, “Qeveria shqiptare ndihmon dhe lehtëson integrimin e emigrantëve në vendet pritëse, duke zbatuar të drejtat dhe detyrimet që lindin nga konventat ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është shtet palë”. Neni 12 shton që “Qeveria shqiptare kujdeset gjithashtu për shtetasit dhe familjet e tyre që jetojnë dhe punojnë në vendet pritëse por ende s’e kanë marrë statusin e emigrantit”. Neni 15 e angazhon qeverinë për të krijuar rregullore të përshtatshme lidhur me sigurimet shoqërore, duke thënë që “Sigurimet shoqërore për emigrantët shqiptarë afatgjatë dhe afatshkurtër rregullohen sipas legjislacionit shqiptar dhe atij të vendit pritës për sigurimet shoqërore, me marrëveshjet dypalëshe në këtë fushë dhe me konventat ndërkombëtare për sigurimet shoqërore në të cilat Republika e Shqipërisë është shtet palë.”

Zhvillimi i politikave të Bashkimit Evropian

BE është angazhuar në një politikë që synon mbrojtjen e të drejtave të emigrantëve në përgjithësi. Ajo synon pikë së pari t’u sigurojë shtetasve të vendeve të treta me qëndrim të ligjshëm në vendet e Bashkimit Evropian të drejta të barabarta me ato të shtetasve të BE siç është pranuar nga përfundimet e takimit të Tampere në tetor 1999. Mbi këtë bazë janë miratuar disa direktiva që rregullojnë njëkohësisht edhe pranimin në BE dhe të drejtat e njerëzve të pranuar. Synimi i dytë i politikës është të mbrojë të drejtat e shtetasve të vendeve të treta nëpërmjet parimit të trajtimit të barabartë. Janë miratuar edhe dy instrumenta ligjorë: direktiva e 29 qershorit 2000 në zbatim të parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave pavarësisht nga origjina racore dhe etnike dhe direktiva e 27 nëntorit 2000 që përcakton një kuadër të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe profesion. Së treti, zhvillime të kohëve të fundit në mënyrë të veçantë nevoja për të luftuar episodet shqetësuese të intolerancës, ksenofobisë dhe shfrytëzimit, synojnë përfshirjen e integritit të shtetasve të vendeve të treta në politikën e imigracionit. Një komunikatë për imigracionin, integrimin dhe punësimin është miratuar nga Komisioni Evropian në 3 qershor 2003 (COM(2003)336) dhe është pasuar nga

raporti i parë vjetor për migracionin dhe integrimin në 16 korrik 2004 (COM(2004)508). Ndërmjet shteteve anëtare është krijuar një rrjet pikash kontakti për integrimin . Një nga shqetësimet kryesore në këtë fushë të re është aftësia gjuhësore e emigrantëve, në mënyrë të veçantë e të sapoardhurve.

Pajisja me dokumenta të rregullta

Një nga faktorët, ndoshta më i rëndësishmi, që ka ndikuar pozitivisht në pozicionin e emigrantëve shqiptarë, ka qenë pajisja me dokumenta të rregullta e kryer nga vendet pritëse, në mënyrë të veçantë nga Italia dhe Greqia. Këto masa vazhdojnë ende.

Për sa i përket Greqisë, që nga janari 2004¹⁸ emigrantët mund të marrin leje me kohëzgjatje dy vjet dhe jo më një vit. Një periudhë prej dhjetë vjetësh qëndrim në Greqi mund të çojë në lëshimin e një lejeje pa kufizim kohor. Lejet dy vjeçare të qëndrimit do të kushtojnë rreth 300 Euro për person, ndërsa lejet e pakufizuara do të kushtojnë rreth 800 Euro për person.

Ndihma sociale

Shqipëria ka ratifikuar Kartën Sociale Evropiane (të rishikuar)¹⁹, që kërkon që shtetet palë të krijojnë një sistem sigurimesh shoqërore dhe të ndërmarrin hapa për lidhjen e marrëveshjeve dypalëshe/shumëpalëshe për të siguruar të drejtat që lidhen me mbrojtjen sociale. Ky trajtim gjendet edhe në ligjin për emigracionin të cituar më lart.²⁰ Qeveria shqiptare po përpiqet për krijimin e agjensive për kontributet e sigurimit vullnetar të emigrantëve në vendet pritëse.²¹

Emigrantët shqiptarë kanë të drejtën të jenë të siguruar në Shqipëri në skemën e sigurimit vullnetar.²² Për të nxitur sigurimin vullnetar, Qeveria shqiptare ka prodhuar fletëpalosje me informacion mbi skemën e sigurimit vullnetar për t'ua shpërndarë migrantëve me anën e ambasadave shqiptare në Greqi dhe Itali. Aktualisht 70% e personave të regjistruar në skemën e kontributeve vullnetare janë emigrantë.

Shqipëria ka ratifikuar shumë marrëveshje në fushën e mbrojtjes sociale për të siguruar të drejtën e sigurimeve, si marrëveshje me Bullgarinë, Rumaninë dhe Turqinë. Përfundimi i marrëveshjeve me vendet fqinjë, si edhe me ato vende që kanë numër të madh emigrantësh shqiptarë, është vlerësuar si përparësi. Në këtë kuadër Protokollin i Bashkëpunimit në nivel teknik ndërmjet Institutit Italian për Mbrojtjen Sociale dhe Institutit Shqiptar të Sigurimeve Shoqërore.²³ Ky protokoll bashkëpunimi është lidhur edhe me Greqinë.

III. Vlerësimi dhe perspektiva e politikave aktuale

Abuzimi nga agjensitë private të punësimit në Shqipëri

Inspektorati Shtetëror i Punës has vështirësi për të kontrolluar agjensitë private të punësimit mbi praktikën abuzive. Veç kësaj nuk ekzistojnë sanksione në rast se vihen re

¹⁸ Si rezultat i paketës ligjore të bashkëngjitur Ligjit nr. 3202/2003 për "Shpenzimet elektorale për zgjedhjet lokale, administratën dhe funksionimin e qeverisjes lokale".

¹⁹ Hyri në fuqi më 1/1/2003.

²⁰ Neni 15. parag.1. Ligji për Emigracionin

²¹ Po aty.

²² Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", Neni. 7¹⁸ Rregullorja nr. 35, datë 19.06.2002 "Për Sigurimin Vullnetar në Institutin e Sigurimeve Shoqërore"

²³ Nënshkruar më 27.03.1999

abuzime, përveç heqjes së liçensës. Heqja e liçensës nuk do të shmangë abuzimin, duke qenë se agjensitë, që shpesh punojnë edhe si agjensi udhëtimi, punojnë gjithashtu pa liçensë. Neni 9 i ligjit për emigracionin, që ndalon dhënien e informacionit të rremë, duket se nuk është i zbatueshëm për këto raste. Qeveria duhet të kërkojë zgjidhje nëpërmjet sanksioneve efikase, duke përfshirë ndoshta edhe veprën penale për agjensitë si edhe nga personat e vetëpunësuar të cilët përfitojnë nga dëshira dhe naiviteti i personave që kërkojnë shërbime migracioni.

Përpjekjet diplomatike

Qeveria e Shqipërisë ka mbrojtur shpesh të drejtat e emigrantëve, por gjendja e tyre jashtë vendit varet natyrisht nga ligji dhe politika si edhe nga vullneti i mirë politik i vendeve pritëse për të mbështetur këto të drejta. Me gjithë vështirësitë e mëdha dhe gjendjen e varfër të një pjese të tyre jashtë vendit, disa zhvillime nxitëse ia vlejnë të përmenden. Në këtë drejtim Zyra e Avokatit të Popullit të Greqisë ka përgatitur një formular në gjuhën shqipe për t'ua shpërndarë imigrantëve shqiptarë në Greqi për të lehtësuar paraqitjen e ankesave prej tyre. Nga ana tjetër, Greqia është pjesë e shteteve anëtare të BE që nuk ka zbatuar si duhet direktivat antidiskriminim siç tregon edhe veprimi i ndërmarrë në korrik 2004 kundër Greqisë nga Komisioni Evropian në Gjykatën Evropiane të Drejtësisë.

Standartet e legjislacionit të BE lidhur me të drejtat e shtetasve të vendeve të treta të pranishëm në shtetet anëtare të BE janë mjaft të larta dhe janë duke u përmirësuar me zhvillimet e politikës së përbashkët për emigracionin. Problemi është të sigurohet zbatimi i tyre i efektshëm dhe të luftohet diskriminimi ndaj shtetasve të vendeve të treta.

Lidhur me përpjekjet që duhet të ndërmerren nga shërbimet diplomatike dhe konsullore për të ndihmuar emigrantët shqiptarë mbi bazën e propozimeve të hartuara në pjesën e strategjisë për shërbimet konsullore, Qeveria shqiptare duhet të hartojë një politikë aktive për të përmirësuar zbatimin e efektshëm të të drejtave të emigrantëve shqiptarë. Veç kësaj ajo duhet të kërkojë bashkëpunimin e të gjithë partnerëve që mund të mobilizohen për këtë qëllim si autoritete dhe shoqata të shteteve të huaja, shoqata të emigrantëve shqiptarë dhe institucione ndërkombëtare të specializuara në mbrojtjen e migrantëve.

Një proces këshillues duhet të vendoset ndërmjet Greqisë dhe Shqipërisë për të shqyrtuar gjendjen e emigrantëve shqiptarë në ato vende. Një organizëm i veçantë i përbërë nga përfaqësues të qeverive duhet të krijohet në nivel të lartë ndërmjet ministrive të ndryshme që janë të ngarkuara me politikën e migracionit për këtë qëllim. Kontakte duhet të ndërmerren nga Shqipëria, në marrëveshje me qeverinë greke, me Avokatin e Popullit të Greqisë, i cili mbledh ankesat nga emigrantët dhe duket se është struktura e ngarkuar me zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë mbi bazën e direktivës së 29 qershorit 2000.

Rrjeti i diasporës duhet të përdoret për të informuar emigrantët mbi mundësitë për t'iu kundërvënë dhunimit të të drejtave të njeriut në strukturat vendase të monitorimit dhe nëse është e nevojshme edhe në ato ndërkombëtare, si tek Avokati i Popullit i Bashkimit Evropian dhe tek Komisioni i Peticioneve në Parlamentin Evropian, si edhe te strukturat e ngarkuara me zbatimin e konventave ndërkombëtare ose evropiane për mbrojtjen e migrantëve të ratifikuara nga Greqia dhe Italia.

Pajisja me dokumenta të rregullta

Në kuadrin e mbrojtjes së të drejtave të emigrantëve qeveria i vlerëson shumë këto masa. Në praktikë politikat e pajisjes me dokumenta të rregullta dhe zbatimi i tyre mund të

vijohet dhe të zhvillohet më tej. Procedurat për të marrë leje qëndrimi mbi këto baza shpesh janë shumë të gjata. Lëshimi i lejeve të përkohëshme nëse ato janë afatshkurtra mund të çojë në kalimin e migrantëve sërish në gjendje të parregullt, në varësi të kushteve për rinovimin dhe statusin ligjor gjatë procedurave të rinovimit.

Shqipëria duhet të nxisë politikat e pajisjes me dokumenta të rregullta në të cilat humbja e një pune të mos sjellë menjëherë humbjen e lejes së punës.

Në këndvështrimin e luftës kundër migracionit të parregullt duhet gjithsesi të theksohet se me hartimin e një politikë koherente dhe të qartë për migracionin, këto lloj masash ose pajisja periodike me dokumenta të rregullta duhet të bëhen të panevojshme.

Ndihma sociale

Marrëveshjet dypalëshe në vijim të Protokolleve të Bashkëpunimit me Italinë dhe Greqinë nuk janë arritur ende. Shqipëria duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të lidhur këto marrëveshje. Duhet të parashikohet mundësia e transferimit të përfitimeve të sigurimeve shoqërore në Shqipëri, si edhe mënyra e duhur për të mbuluar mbrojtjen sociale në rastin e migracionit sezonal.

Angazhimi i Shqipërisë për të krijuar agjensi jashtë vendit për të lehtësuar kontributin e sigurimit vullnetar ende nuk është materializuar. Edhe pse emigrantët kanë të drejtën e kontributit vullnetar, ata duhet t'i paguajnë këto kontribute në Shqipëri. Duhet të krijohen agjensi veçanërisht në Greqi dhe në Itali, në përputhje me Ligjin e Emigracionit për pagesën e kontributeve vullnetare nga emigrantët shqiptarë.

IV. Propozime për zbatim:

32. Të angazhohet dhe të nxisë me të gjithë partnerët e mundshëm një politikë aktive për mbrojtjen e të drejtave të emigrantëve jashtë vendit, pikë së pari në Greqi dhe Itali duke qenë vendet pritëse kryesore të shqiptarëve mbi bazën e propozimeve të mëposhtme.
33. Të kontaktohet qeveria greke dhe ajo italiane për të propozuar krijimin e një komisioni konsultativ të nivelit të lartë ndërmjet ministrive të ngarkuara me çështjet migratore në ato vende dhe në Shqipëri, i cili do të mblidhet një herë në vit për të shqyrtuar gjendjen e emigrantëve shqiptarë.
34. Ti kërkohet të Dërguarit Special të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut të Migrantëve të organizojë një vizitë në Greqi dhe Itali të përgatisë një raport për gjendjen e emigrantëve shqiptarë në këto vende.
35. Të kontaktohet Grupi Evropian i Autoriteteve Rajonale dhe Lokale në fushën e Imigracionit (ERLAI) me qendër në Bruksel, në të cilin autoritetet lokale greke dhe italiane janë të përfaqësuara, për të hetuar mbi mundësitë e mbështetjes së politikës për mbrojtjen e emigrantëve shqiptarë.
36. Të nxitet dhe të mbështetet vendosja e kontakteve të ngushta ndërmjet shoqatave të emigrantëve shqiptarë dhe shoqatave greke dhe italiane për mbrojtjen e imigrantëve;
37. Të vihen në dijeni shoqatat e emigrantëve shqiptarë në Greqi dhe Itali mbi rrugët e ndryshme për t'u ankuar ndaj shkeljes së të drejtave të emigrantëve nëpërmjet strukturave vendase dhe ndërkombëtare si edhe strukturat evropiane.
38. Të nxitet dhe mbështetet shoqatat e emigrantëve shqiptarë në Greqi dhe Itali për të kërkuar krijimin e strukturave lokale këshilluese për shtetasit e huaj në qytetet ku emigrantët shqiptarë janë të përqëndruar, mbi bazën e udhëzuesit të përgatitur nga Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Evropës dhe Këshillit të Evropës

39. Të monitorohet nga afër zbatimi nga ana e Greqisë dhe Italisë i Direktivës së BE të 22 Shtatorit 2003 mbi të drejtën e bashkimit familjar dhe Direktivës së BE të 25 Nëntorit 2003 lidhur me statusin e shtetasve të vendeve të treta të cilët janë me qëndrim afatgjatë, në mënyrë që të krijihen situata sa më të favorshme për emigrantët shqiptarë.
40. Të kërkohet kryerja e një studimi për të analizuar efektet konkrete të procedurave të ndryshme të pajisjes me dokumenta të rregullta të emigrantëve të parregullt shqiptarë, në mënyrë të veçantë në Greqi dhe Itali.
41. Të kërkohen dhe mbështeten procedura të tilla që sigurojnë vazhdimësinë e lejeqëndrimeve të rregullta, në mënyrë që të shmanget rënia në klandestinitet pas një periudhe të shkurtër, të emigrantëve të rregullt. Këto procedura të sigurojnë statusin e emigrantit, qoftë edhe si punëkërkues, kundrejt disa kushteve që duhen përcaktuar.
42. Të nxitet ulja e çmimeve të lejeve të qëndrimit në Greqi dhe të parashikohet nëse është e nevojshme mbështetja e veprimeve ligjore ndaj çmimeve të paekuilibruara.
43. Të ndërmerret lidhja e marrëveshjeve dypalëshe për mbrojtjen sociale.
44. Të zbatohen masat e parashikuara për agjensitë jashtë vendit që merren me kontributin vullnetar për sigurimet shoqërore.
45. Të kërkohen zgjidhje për të shmangur abuzimin nga ana e agjensive private të punësimit, nëpërmjet vendosjes së sanksioneve të efektshme, përfshirë këtu ndoshta edhe veprën penale.
46. Të nxisë pranë strukturave të duhura ndërkombëtare dhe vendase ratifikimin e shpejtë dhe hyrjen në fuqi të Konventave të Organizatës Ndërkombëtare të Punës që mbrojnë të drejtat e migrantëve dhe familjeve të tyre si baza më e fortë ligjore për të respektuar këto të drejta si edhe për të ndjekur ligjërisht rastet e abuzimit dhe keqtrajtimit.

B.1.2 Mobilizimi i komunitetit shqiptar jashtë vendit

I. Analiza e situatës aktuale

Në shekullin e fundit emigracioni i shqiptarëve mund të ndahet në tre faza kryesore. Periudha e parë ka të bëjë me periudhën përpara komunizmit kur largimet kanë qenë të mëdha. Periudha e dytë përfshin emigracionin gjatë periudhës së komunizmit i cili ka qenë përgjithësisht i paktë në numër. Periudha e tretë përkoi me ënien e regjimit komunist e cila u shoqërua me një largim masiv të emigrantëve kryesisht në mënyrë ilegale.

SHPËRNDARJA E EMIGRANTËVE SHQIPTARË NË BOTË

<i>VENDI</i>	<i>NUMRI I EMIGRANTEVE</i>
<i>Greqi</i>	<i>600 000</i>
<i>Itali</i>	<i>250 000</i>
<i>Gjermani</i>	<i>15 000</i>
<i>SHBA</i>	<i>150 000</i>
<i>Mbreteria e Bashkuar</i>	<i>50 000</i>

<i>Belgjika</i>	<i>5 000</i>
<i>Franca</i>	<i>2 000</i>
<i>Kanada</i>	<i>11 500</i>
<i>Zvicra</i>	<i>1 500</i>
<i>Austria</i>	<i>2 000</i>
<i>Vendet e Ulta</i>	<i>1 000</i>
<i>Turqia</i>	<i>5 000</i>

Emigrantët shqiptarë janë përqëndruar në kryesisht në: Greqi dhe Itali, si edhe në vende si SHBA, Mbretëria e Bashkuar dhe vende të tjera. Shumë emigrantë shqiptarë në Greqi dhe Itali nuk disponojnë dokumentacion të rregullt për të qëndruar atje dhe nuk janë integruar plotësisht në vendin e qëndrimit. Komunitetet Shqiptare jashtë vendit kanë një nivel të ndryshëm organizimi. Duke marrë në konsideratë këtë fakt, është e vështirë të flasësh për një Diasporë të mirëfilltë Shqiptare.

II. Prezantimi i politikave aktuale

Neni 8, pika 2 e Kushtetutës së Shqipërisë parashikon se ‘Republika e Shqipërisë mbron të drejtat e shtetasve shqiptarë me banim të përkohshëm ose të përhershëm jashtë kufijve të vet’.

Ligji “Për emigrimin e qytetarëve shqiptarë për motive punësimi” prezanton në mënyrë më të detajuar aspektet të ndryshme të politikës së Shtetit Shqiptar për komunitetet shqiptare jashtë vendit si psh. “Shteti garanton përkujdesjen dhe mbrojtjen e shtetasve të tij emigrantë, si dhe forcimin e lidhjeve të tyre me Republikën e Shqipërisë”.¹⁹ “Shteti shqiptar siguron dhe mbështet kontaktin e emigrantëve shqiptarë, nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur të organizatave të tyre, me organet e qeverisjes qendrore dhe vendore për të paraqitur dhe mbrojtur interesat e tyre”(Neni6). “Shteti mbështet dhe ndihmon ngritjen, forcimin dhe zhvillimin e komuniteteve shqiptare jashtë vendit, bashkëpunon me to, duke konsoliduar veprimtaritë e ndërmarra nga klube, bashkime, shoqata dhe familje shqiptare me synim forcimin e lidhjeve midis tyre dhe me atdheun” (Neni 11). Paragrafi i dytë (i nenit 11) ka të bëjë me ruajtjen e bashkësive shqiptare jashtë vendit “Shteti, duke respektuar legjislacionin e shtetit pritës, si dhe marrëveshjet dypalëshe dhe shumëpalëshe në të cilat Republika e Shqipërisë është palë, kujdeset për arsimimin e emigrantëve dhe të familjeve të tyre në gjuhën shqipe, krijon kushte për ruajtjen e gjuhës, kulturës dhe trashigimisë kombëtare, si dhe të lidhjeve shpirtërore në mes komuniteteve të emigrantëve”. Nga ana tjetër, neni 5, shërben si dispozitë themelore për liritë dhe të drejtat politike të emigrantëve.

Shtetësia shqiptare rregullohet nga Ligji Nr. 8389, datë 05.08.1998 “Për Shtetësinë Shqiptare”. Sipas Nenit 7 të këtij ligji “kushdo që lind duke pasur qoftë edhe njërin prej prindërve me shtetësi shqiptare, e fiton automatikisht shtetësinë shqiptare”. Një nga kushtet e natyralizimit është qëndrimi në vend për një periudhë kohe jo më pak se pesë vjet. Ky afat mund të reduktohet në tre vjet qëndrim për personat që provojnë se kanë

¹⁹ Ligji Nr. 9034, dt.20.03.03, Neni 1, Kreu I, Dispozita të përgjithshme, Pika 2.

origjinë Shqiptare deri në dy shkallë, qoftë edhe vetëm nga njëri prind dhe deri në një vit qëndrimi në vend për personat që kanë lidhur martesë dhe kanë bashkëjetuar me një shtetas(e) shqiptar(e) prej jo më pak se 3 vjetësh. Qëndrimi në Shqipëri për një afat të caktuar kohe nuk është i nevojshëm për t'u përmbushur nëse një individ paraqet interes shkencor, ekonomik, kulturor dhe kombëtar për Shqipërinë. Ligji lejon shtetësinë e dyfishtë.

Duhet përmendur gjithashtu edhe ekzistenca e Institutit të Diasporës në Ministrinë e Punëve të Jashtme. Detyrat e tij janë: të sigurojë informacion të plotë dhe të gjithanshëm për diasporën shqiptare, për përgatitjen e atlasit gjeografik dhe demografik; të nxisë të gjitha kontaktet e mundshme ndërmjet të gjitha niveleve të diasporës dhe Shqipërisë; të nxisë dhe të garantojë qytetarët shqiptarë të cilët jetojnë dhe punojnë jashtë vendit; të identifikojë studentët dhe specialistët që kryejnë studimet universitare dhe pasuniversitare jashtë vendit.

Politika e imigracionit e vendeve pritëse, sigurisht ka rëndësi kryesore për situatën e diasporës jashtë vendit. BE dhe vendet anëtare po hartojnë politika të reja për integrimin e emigrantëve. Mësimi dhe përmirësimi nga emigrantët i gjuhës së vendit pritës përbën një nga qëllimet kryesore të kësaj politike. Një masë e tillë synon të ndihmojë emigrantët shqiptarë që të integrohen në shoqëritë e këtyre vendeve dhe t'i pajisë ata me aftësitë e duhura për gjetjen e mundësive të punës.

III. Vlerësimi dhe perspektiva e politikës aktuale

Kuadri ligjor pasqyron shumë mirë rëndësinë e komuniteteve shqiptare jashtë vendit, por me qëllim që të konsolidohen politikat e caktuara, zbatimi i ligjeve është shumë i rëndësishëm. Siç kanë treguar eksperiencat të ndryshme në vende të ndryshme të botës, këto politika përbëjnë një mjet shumë efektiv për nxitjen e zhvillimit të vendit të origjinës. Komunitetet e emigrantëve jashtë vendit mund të luajnë rolin e ndërmjetësve për zhvillimin e biznesit, tregtisë dhe investimeve ndërmjet vendit pritës ku ata jetojnë dhe Shqipërisë. Nëse një gjë e tillë nuk do të korrespondonte në një farë mase edhe me interesin e tyre personal, emigrantet nuk do të angazhoheshin në iniciativat e tilla. Duhet të jetë e qartë se një politikë që synon mobilizimin e komuniteteve shqiptare jashtë vendit merr kuptim vetëm nëse zbatohet në një kontekst global të favorshëm për biznesin, tregtinë dhe investimet.

Për shkak të diversitetit të grupeve të emigrantëve shqiptarë, identifikimi i personave me origjinë të përbashkët kombëtare dhe bërja e tyre pjesë e rrjeteve të ndërvarura në funksion të së ashtuquajtur "Diasporë" përbën një objektivi të kësaj politike. Këto rrjete i grupojnë emigrantët shqiptarë mbi baza cilësore, si p.sh., profesioni, vendndodhja, ndërsa Diaspora do t'i grupojë ata mbi baza sasiore.

Politika mbi Diasporën synon të përfshijë emigrantët me origjinë shqiptare në vendet ku ata kanë emigruar dhe jo minoritetet në vendet fqinje (të njohur ndryshe si diaspora historike). Përfshirja e diasporës historike siç janë arbëreshët e Italisë mund të përdoret për ruajtjen dhe forcimin e lidhjeve të këtyre personave me Shqipërinë në kontekstin e një bote globale, ku individët mund të zhvillojnë më shumë se një identitet pa vënë në pikëpyetje anëtarësinë në shoqërinë e vendit të cilit i përkasin apo jetojnë.

Objektivi i politikës shqiptare në lidhje me komunitetet shqiptare jashtë vendit duhet të jetë në përputhje me politikën evropiane për ruajtjen e gjuhës shqipe nga brezat e

ardhshëm të emigrantëve shqiptarë, duke synuar në të njëjtën kohë përmirësimin e dijës së vendit pritës nga emigrantët.

Kështu, mobilizimi i diasporës kulturore duhet të shikohet si mjet për nxitjen e diversitetit kulturor në vendet pritëse. Megjithatë, kjo gjë do të ketë potencialisht efekt ekonomik, i cili është një dimension i analizuar në pjesë të tjera të strategjisë.

IV. Propozime për zbatim:

47. Mobilizimi i diasporës shqiptare dhe ndihma në organizimin e saj të jenë ndër prioritetet e politikës për migrimin dhe të promovohen kudo në botë.
48. Identifikimi dhe përcaktimi i shteteve në të cilat komuniteti shqiptar do të jetë prioritar në politikën për diasporën.
49. Ndërmarrja e një studimi të thelluar mbi situatën dhe dinamikën e komunitetit shqiptar në këto vende dhe mundësitë për t'i lidhur ato me diasporën në dobi të Shqipërisë.
50. Pajisja e Institutit të Diasporës pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme me të gjitha mjetet e nevojshme për zbatimin e politikës për diasporën.
51. Krijimi i një banke të dhënash me të gjitha shoqatat shqiptare në vendet që gjykohen si prioritare për politikën kombëtare me diasporën.
52. Krijimi i një banke të dhënash të gazetave, radiove dhe televizioneve që funksionojnë në vendet që gjykohen si prioritare për politikën kombëtare me diasporën.
53. Organizimi në Tiranë i kongresit të parë të diasporës shqiptare për përcaktimin e një plani për ruajtjen e kulturës dhe mobilizimin e diasporës shqiptare.
54. Fillimi i një debati për përfaqësimin e diasporës shqiptare nëpërmjet një autoriteti/institucioni të përhershëm që do të kishte funksione të tilla si p.sh. të drejtën e dërgimit të propozimeve parnë qeverisë dhe parlamentit të Shqipërisë.
55. Fillimi i një fushatë për mbledhjen e kontributeve financiare nga ana e diasporës të cilat do të shtohen buxhetit të parashikuar nga qeveria shqiptare dhe që do të mundësojë organizimin e kongresit.
56. Të inkurajohet dhe ndihmohet krijimi i rrjeteve/shoqatave të emigrantëve shqiptarë në botë në bazë të kriterëve të ndryshme të përbashkëta si p.sh., profesioni, vendndodhja gjeografike, interesat e përbashkëta dhe aftësitë.
57. Përcaktimi i mjeteve (gazeta, faqe interneti) për lidhjen e këtyre rrjeteve në një diasporë të vetme.
58. Të mbështetet zgjerimi i zonës së transmetimit nga TVSH duke përfshirë edhe vendet e tjera ku gjenden komunitete emigrantësh shqiptarë.
59. Të vazhdojë prodhimi nga RTSH i programeve të cilat janë specifike për diasporën dhe të kërkohet transmetimi i tyre në bashkëpunim me shërbimet radiotelevizive në vendet pritëse.
60. Të shqyrtohet mundësia e përmblidhjes së parimit të respektimit të barabartë të të drejtave politike për emigrantët; të kryhet një studim për mundësinë e ushtrimit të të drejtës së votës për zgjedhjet parlamentare nga ana e emigrantëve jashtë vendit praën ambasadave dhe konsullatave shqiptare.
61. Marrja e masave për të inkurajuar dhe mbështetur hapjen e kurseve të gjuhës shqipe në vendet pritëse të emigrantëve.
62. Krijimi dhe nxitja e programeve për mësimdhënien e gjuhës shqipe për fëmijët e emigrantëve shqiptarë në bashkëpunim me strukturat përkatëse të vendeve pritëse.
63. Krijimi i mundësive për studentët shqiptarë që të mirëprehen dhe të ndihmohen nga anëtarë të diasporës shqiptare për lehtësuar studimet e tyre në universitete të huaja.

64. Tërheqja e diasporës shqiptare në Shqipëri për qëllime turizmi dhe për të qëndruar për periudha më të gjata kohore.
65. Përfshirja e diasporës shqiptare në konceptimin dhe zbatimin e politikave të dërgesave të emigrantëve dhe përcaktimi i masave për tërheqjen e investimeve nga diaspora.


B.1.3 Orientimi i dërgesave të emigrantëve drejt investimeve në biznes

I. Analiza e situatës aktuale

Rëndësia e dërgesave të emigrantëve

Dërgesat e emigrantëve përbëjnë mekanizmin kryesor të uljes së varfërisë në Shqipëri dhe rritjen e të ardhurave në familje në veçanti. Ato jo vetëm sigurojnë një mbështetje të rëndësishme ekonomike për familjet e emigrantëve, por edhe për stabilitetin shoqëror dhe ekonomik të vendit. Modeli i përdorur i dërgesave të emigrantëve në Shqipëri tregon se ato janë përdorur kryesisht për të plotësuar nevojat ditore (ushqim, veshje, etj); së dyti, për të përmirësuar cilësinë e jetesës (pajisje elektronike, mobilim shtëpish etj); së treti, për zgjerimin dhe ndërtimin e shtëpive të reja. Po ashtu, një pjesë e vogël e dërgesave të emigrantëve përdoren për të ruajtur traditën, (martesat) etj, dhe mbahen në banka apo në shtëpi. Vetëm në disa raste dërgesat e emigrantëve përdoren për të blerë prona të patundshme në sektorët e shërbimeve, bujqësisë, etj.

Gatishmëria për investimet e migrantëve shqiptarë sipas aktiviteteve të tyre ekonomike



Burimi: Qendra për Studime Sociale dhe Ekonomike
Burimi: Vëzhgim mbi dërgesat e emigrantëve në monedhë të huaj, Janar 2003

Sipas një analize të fluksit të dërgesave të emigrantëve, rezultojnë një rritje e konsiderueshme me kalimin e viteve. Dërgesat e emigrantëve luajnë një rol të madh në financimin e pjesëshëm të defiçitit të lartë tregtar, por ato nuk mund të konsiderohen si një faktor i përhershëm, pasi është e vështirë të parashikohen flukset e dërgesave të emigrantëve në periudhë afat-mesme.

Dërgesat e emigrantëve për periudhën 1992 – 2003

Në milionë \$

Vitet	PBB (GDP)	IHD (FDI)	Bilanci tregtar	Te ardhurat e emigrantëve	Ne % te PBB	Ne % te IHD	Ne % te bilancit tregtar	Kursi i kembimit Lek /USD
1993	1228.0	58.0	-489.7	274.7	22.4	473.6	56.1	102.1
1994	1948.0	53.0	-459.9	378.1	19.4	713.4	82.2	94.7
1995	2476.0	70.0	-475.2	384.7	15.5	549.6	81.0	92.8
1996	3013.2	90.0	-678.3	499.5	16.6	555.0	73.6	104.5
1997	2163.8	48.6	-534.9	267.2	12.3	549.8	50.0	148.9
1998	2737.9	45.0	-603.7	453.5	16.6	1007.8	75.1	150.6
1999	3444.4	41.3	-662.8	356.6	10.4	863.4	53.8	137.7
2000	3694.5	143.0	-821.0	530.8	14.4	371.2	64.7	143.7
2001	4103.0	220.2	-1027.0	614.9	15.0	279.2	59.9	143.5
2002	4494.0	135.0	-1155.2	606.8	13.5	449.5	52.5	140.2
2003	6111.4	178.0	-1336.3	778.1	12.7	437.1	58.2	121.9

Burimi: Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave

Rëndësia e dërgesave të emigrantëve për ekonominë shqiptare, mund të kuptohet me kontributin e tyre në PBB-në e vendit, i cili mendohet të jetë në masën 1/6. Rëndësia e tyre mund të matet kur krahasohen dërgesat e emigrantëve me Investimet e Huaja Direkte (IHD) apo Ndhma e Huaj për Zhvillim (NHZH). Në periudhën 1993-2003, Investimet e Huaja Direkte në ekonominë shqiptare u vlerësuan të jenë 1082.1 milion dollarë, ndërkohë që vlera e akumuluar e dërgesave të emigrantëve ishte 5144.9 milion dollarë. Kështu, dërgesat e emigrantëve kanë qenë më të konsiderueshme se ndihma e huaj që Shqipëria ka marrë çdo vit nga institucionet ndërkombëtare (që vlerësohen të jenë 3104 milion Dollarë nga 1992-2002).

Dërgesat e emigrantëve luajnë rol të rëndësishëm në stabilitetin makroekonomik të vendit duke financuar importet, ndikojnë në vlerën e monedhës lokale dhe në zhvillimin e shpejtë të ndërtimit dhe sektorëve të shërbimit.

Si rrjedhojë dërgesat e emigrantëve kanë qënë faktori kryesor në përcaktimin e një prej karakteristikave të tranzicionit shqiptar, dmth konsumi i brendshëm është më i madh se prodhimi kombëtar. Në këtë këndvështrim, krahasuar me ekonomitë e tjera në tranzicion të vendeve të Europës lindore dhe qendrore, Shqipëria është i vetmi vend i ngjashëm me Gjermaninë lindore.


Karakteristikat kryesore të dërgesave të emigrantëve dhe kanalizimi i transfertave

Nuk mund të bëhet një vlerësim i saktë i fluksit të dërgesave të emigrantëve pasi ato transferohen jashtë sistemit bankar.

Transferimi i dërgesave të emigrantëve në Shqipëri bëhet i mundur nëpërmjet dy kanaleve, ato formale dhe informale. Sipas tabelës së mëposhtme, rrugët informale

vazhdojnë të jenë mënyra kryesore e transferimit të dërgesave të emigrantëve në Shqipëri. Sipas vlerësimeve të Bankës së Shqipërisë, rreth 61 % e volumit të dërgesave të emigrantëve për vitin 2001 u transferuan nëpërmjet këtyre kanaleve. Kjo kryesisht bëhet nga vetë emigrantët apo nga rrethi i gjerë i të afërmëve dhe miqve.

Dinamika e dërgesave të emigrantëve dhe transferimi i tyre nëpërmjet rrugëve formale dhe joformale



Burimi: Banka e Shqipërisë, 2003

Rrugët e transferimit të dërgesave të emigrantëve në Shqipëri varen nga një numër faktorësh, si statusi i punëtorëve shqiptarë në vendin pritës, migracioni afatshkurtër apo aftëgjatë, zhvillimi dhe efektiviteti i sistemit bankar në Shqipëri, besimi i emigrantëve në sistemin bankar i cili u thye ndjeshëm nga kolapsi i skemave piramidale në vitin 1997, niveli i informacionit të migrantëve apo të afërmeve të tyre për sistemin bankar, kosto e lartë e transfertave për sasi të vogla të parave, ekzistenca dhe efektiviteti i rrugëve joformale, mungesa e dëshirës e migrantëve për të treguar sasi të parave të transferuara në Shqipëri. Kjo e fundit mund të jetë si rezultat i mosbesimit të shtetasve tek autoritetet/bankat vendase.

Dërgesat e emigrantëve të transferuara në rrugë informale mbartin risk. Një pjesë e emigrantëve përdorin korrierë apo shërbime të tjera të transferimit të parave duke paguar një komision. Ky element vazhdon të jetë i rëndësishëm, por praktikisht i pamundur të studjohet në mënyrë të saktë.

II. Prezantimi i politikave aktuale

Baza ligjore për politikën e dërgesave të emigrantëve është në nenin 14 të ligjit Nr. 9034, datë 20.03.2003 për “Emigracionin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi” sipas të cilit “Qeveria e Shqipërisë krijon lehtësira dhe kushte favorizuese për shpërndarjet monetare të emigrantëve nëpër bankat shqiptare”.

Qeveria synon me anë të programit të saj për periudhën 2002-2005, “të inkurajojë thithjen formale të dërgesave të emigrantëve duke ofruar një ambjent të favorshëm për përmirësimin e raportit ndërmjet konsumit dhe investimit afatgjatë”. Për të nxitur emigrantët që të investojnë dërgesat e tyre në aktivitete biznesi janë ndërmarrë dhe vazhdojnë të ndërmerren reforma të përgjithshme.

Miratimi i Ligjit për Bankën e Shqipërisë dhe Ligjit për Sistemin Bankar janë disa nga hapat e ndërrmarra në fillim të viteve nëntëdhjetë. Progres është bërë edhe në nxitjen e investimeve të brendshme dhe të huaja. Qeveria ka miratuar së fundmi strategjinë afatmesme “Për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme”. Ky dokument strategjik synon të krijojë një klimë të favorshme për ngritjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Për më tepër, institutet e mikrokreditit dhe mikrofinancës kanë qenë efektive duke i shërbyer atyre që nuk plotësojnë kriteret për të qenë klientë të bankave tregtare. Rëndësia në rritje e instituteve shqiptare të mikrokredit jepet në “Programin Buxhetor Afatmesëm për periudhën 2004-2006”, që është një program buxhetor i përgatitur nga Ministria e Financës në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillimin Social dhe Ekonomik.

III. Vlerësimet dhe perspektivat e politikës aktuale

Pavarësisht nga rëndësia që paraqesin politikat për thithjen e dërgesave të emigrantëve, akoma nuk është zhvilluar dhe përpunuar një politikë për menaxhimin dhe përdorimin e dërgesave të emigrantëve në dobi të zhvillimit shoqëror. Deri më sot masat e politikave që synojnë kanalizimin e dërgesave të emigrantëve nëpërmjet strukturave zyrtare dhe nxitjen e kursimeve dhe investimeve në vend janë të pamjaftueshme. Dobësia e sistemit financiar lejon përdorimin ekskluziv të dërgesave të emigrantëve për blerjen e mallrave të importit dhe kushtëzon në mënyrë të ndjeshme efektin pozitiv që mund të ketë përdorimi i tyre në zhvillimin e sistemit ekonomik kombëtar.

Për menaxhimin e dërgesave të emigrantëve duhet hartuar dhe më tej zbatuar një politikë koherente për dy arsye: Së pari, nga vetë shtrirja dhe ndikimi në ekonominë e vendit. Së dyti, fluksi i dërgesave të dërguara nga emigrantët do të ulet me siguri në periudhë afatgjatë për shkak të integritit të vazhdueshëm të emigrantëve në vendet pritëse.

Stabiliteti ekonomik dhe një klimë e favorshme për investime janë kushte bazë të nevojshme për të zbatuar çdo politikë për dërgesat e emigrantëve. Qëllimi kryesor nuk është vetëm rritja e flukseve të dërgesave të emigrantëve, por dhe kthimi i tyre në investime frytdhënëse në Shqipëri. Si rrjedhojë, një politikë e tillë duhet të identifikojë masa si:

- **Rritja e fluksit të dërgesave të emigrantëve nëpërmjet strukturave zyrtare:** flukset e larta të dërgesave të emigrantëve që kalojnë në kanalet jozyrtare shton kërkesën për përmirësimin e kanaleve zyrtare në emër të efikasitetit, sigurisë, kostos dhe anonimitetit. Ndër emigrantët e rregullt, vetëm një e treta e tyre rezultuan të kenë akses për në bankë. Raporti i tyre me strukturat bankare vështirësohet nga problemet e gjuhës (zakonisht formularët janë të shkruar në gjuhën e vendit pritës) dhe në shumë raste kërkohen shumë dokumente për të hapur një llogari bankare. Zgjerimi i sistemit bankar në të gjithë vendin dhe krijimi i mundësive të reja për transferimin e parave janë elementë të rëndësishëm i një politike të tillë. Në veçanti, bankat shqiptare mund të marrin dërgesat e emigrantëve shqiptare që punojnë jashtë vendit nëpërmjet ndërmjetësimit të “instituteve korresponduese bankare” në vendet pritëse dhe organizatat shqiptare të mikrokreditit dhe mikrofinancimit të cilat mund të shërbenin si agjenci lokale ku mund të kanalizohet ky proces.
- **Ndikimi i dërgesave të emigrantëve në zhvillimin e vendit:** duket se edhe bankat nuk janë shumë të interesuara në një politikë e cila do të nxiste përdorimin e kredive dhe kursimeve të emigrantëve, si edhe në një strategji që do të synonte

kapjen e tregut të dërgesave të emigrantëve. Zakonisht, emigrantët nuk janë në fokusin e shërbimeve të tyre pasi ky grup klientësh konsiderohen si punëtorë të pastabilizuar dhe transaksionet e tyre kanë kthim relativisht të ulët dhe kosto e menaxhimit të këtij shërbimi është e lartë. Për emigrantët mund të ofrohen produkte të ndryshme financiare. Këtu përfshihet lidhja midis dërgesave të emigrantëve dhe investimeve (për shembull lidhja e fluksit të dërgesave të emigrantëve me kreditë apo projektet e mikro-kreditit) dhe mbështetja e kontributit të migrantëve dhe shoqërive të migrantëve me zhvillimin e vendit. Së fundmi, rritja e ndikimit të dërgesave të emigrantëve mund të inkurajohet me anë të forcimit të rrjeteve financiare dhe rrjetit shpërndarës në qytetet marrëse të dërgesave të emigrantëve në Shqipëri, ku përfshihen zonat rurale. Një shpërndarje efikase e dërgesave të emigrantëve mund të përmirësohet nëse do të autorizoheshin institucione mikro-financiare dhe /ose unione krediti të cilat kanë rrjet të shtrirë financiar në vend, që merren me shtresën e popullsisë me të ardhura të ulta – që të marrin pjesë në tregun e dërgesave të emigrantëve, ose si aktor i jashtëm ose si një partner shpërndarës i institucioneve ekzistuese.

IV. Propozime për zbatim:

- | | |
|-----|--|
| 66. | Përpunimi dhe zbatimi i <u>menjëhershëm</u> i një politike koherente dhe të plotë për administrimin e dërgesave të emigrantëve; |
| 67. | Marrja e masave për kalimin e dërgesave të emigrantëve nga rrugët informale të transferimit në ato formale, por më pak të kushtueshme; |
| 68. | Marrja e masave për të rritur flukset e dërgesave të emigrantëve duke motivuar emigrantët që sjellin kursimet e tyre në Shqipëri, si p.sh. me anë të normave të favorshme të këmbimit, dhe mundësia për t'i mbajtur ato në valutë të huaj. |
| 69. | Nxitja e shoqërive private për të tërhequr dërgesat e emigrantëve nëpërmjet produkteve financiare, si p.sh. letra me vlerë. |
| 70. | Informimi i emigrantëve për mundësitë e investimeve në Shqipëri me anë të medias, bankave (internet, broshura), etj. |
| 71. | Motivimi i emigrantëve të cilët investojnë të ardhurat e tyre në sektorë të vecantë të ekonomisë. |
| 72. | Përmirësimi dhe zgjerimi i shërbimeve bankare në vendet pritëse të emigrantëve si edhe për të afërmit e tyre në Shqipëri (kryesisht në zonat rurale) për shembull me anë të ndërmjetësimit të “institucioneve korresponduese bankare”. |
| 73. | Nxitja e bankave në vendet pritëse që, me ndihmën e shoqatave të emigrantëve shqiptarë, të përcaktuar shërbime <i>ad hoc</i> për emigrantë. |
| 74. | Krijimi i fondeve për zhvillim në nivel lokal për të mbështetur investimet nëpërmjet dërgesave të emigrantëve. |
| 75. | Ndihmë për institucionet e mikrokreditimit dhe mikrofinancës për zbatimin e politikave që synojnë kanalizimin e dërgesave të emigrantëve nëpërmjet marrëveshjeve me institucione financiare në vendet pritëse. |
| 76. | Inkurajimi i shoqatave të emigrantëve për nxitjen e zhvillimit lokal nëpërmjet mbledhjes vullnetare të donacioneve nga anëtarët për të financuar projekte të ndryshme në qytetin apo fshatin e tyre. |

B.2. Hartimi i politikave të përshtatshme për emigracionin

B.2.1. Menaxhimi i migracionit qarkullues të shqiptarëve

B.2.1.1. *Informimi mbi mundësitë e emigracionit*

I. Analiza e situatës aktuale

Në bazë të “Ligjit mbi Emigracionin e Shtetasve Shqiptarë për Motive Punësimi” emigrantët kanë të drejtën e informimit dhe këshillimit falas. Ministra e Punës dhe Çështjeve Sociale (MPCÇS) është autoriteti shtetëror përgjegjës për sigurimin e këtij informacioni. Në praktikë, informacioni në lidhje me emigracionin për qëllime punësimi sigurohet nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit (SHKP) dhe nga zyrat e tij në nivel rajonal dhe lokal. Këto zyra shërbejnë edhe si ndërmjetëse midis punëmarrësve shqiptarë dhe punëdhënësve të huaj.

Ligji për Emigracionin²⁵ përcakton si burim informacioni Agjencitë Private të Punësimit. Mbështetur në këtë ligj, qeveria njih dhe mbështet aktivitetin e agjencive private të punësimit për ndërmjetësimin e punëkërkuësve dhe punëdhënësve të huaj në dhënien e informacionit dhe menaxhimin e procesit të punësimit për qytetarët shqiptarë brenda dhe jashtë vendit. Këto shërbime duhet të jenë pa pagesë për punëkërkuësit, përveç shpenzimeve administrative. Punëdhënësi duhet të mbulojë shpenzimet e shërbimeve të ndërmjetësimin.

Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (I.O.M.) në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale ka krijuar Qendrën e Asistencës për Migrantët (Q.A.M). Kjo është një qendër informacioni që i shërben personave të interesuar që emigrojnë. Qendra ofron informacion në lidhje me aplikimet për vizë, jep udhëzime për të aplikuar në programe të veçanta të emigrimit, jep informacion mbi legjislacionin e emigracionit dhe informacione të tjera që kanë lidhje me kulturën e vendit ku individit synon të largohet. Gjithashtu jepet informacion shtesë lidhur me çështje si qëndrimi afatgjatë, marrja e shtetësisë etj. Një këshilltar për migracionin i përgjigjet klientëve duke ofruar këshilla mbi çështjet që lidhen me migracionin. Qendra e ka filluar aktivitetin e saj që në vitin 2003. Ajo i ka shërbyer rreth 600 personave nga e gjithë Shqipëria. Pjesa më e madhe e personave që janë drejtuar për informacion për emigracion kanë qenë meshkuj me arsim të mesëm. Vendet më të kërkuara janë Kanadaja, Italia, dhe Greqia. IOM-i është në proces të zgjerimit të shërbimeve jo vetëm në Tiranë po edhe në ato zona të Shqipërisë ku emigracioni i parregullt është më i ndjeshëm.

Në lidhje me imigracionin, Ministria e Punëve të Jashtme ofron informacion për të huajt të cilët duan të vendosen në Shqipëri. Kjo Ministri ka një faqe interneti ku mund të gjenden adresat e ambasadave shqiptare.

II. Prezantimi i politikave aktuale

Drejtoria e Migracionit në MPCÇS aktualisht po punon për përgatitjen e broshurave informuese mbi emigracionin në Itali dhe Greqi.

Shërbimi Kombëtar i Punësimit ka pësuar një sërë ndryshimesh në aspektin strukturor kohët e fundit: çështjet e migracionit tani mbulohen nga Sektori për Marrëdhëniet e Punës dhe Migracionit në Drejtorinë e Punësimit. Disa nga objektivat, misioni dhe detyrat të parashikuara në mënyrë specifike në rregulloren e Institucionit janë:

²⁵ Neni 18 i Ligjit për Emigracionin e Shtetasve Shqiptarë për Motive Punësimi.

- Mbështetja e departamenteve respektive të Zyrave Rajonale të Punësimit (ZRP) për zbatimin korrekt dhe në kohë të detyrimeve që rrjedhin nga aktet ligjore dhe nënligjore, si edhe udhëzimet dhe rregulloret respektive në këtë fushë.
- Koordinimi i punës në këtë fushë midis ZRP dhe MPCÇS për të zbatuar objektivat e MPCÇS.
- Mbledhja e informacionit nga ZRP dhe raportimi i këtij informacioni në strukturat përkatëse në Drejtorinë e Përgjithshme të SHKP në kohën e duhur.
- Bashkëpunimi me Drejtorinë e Migracionit në MPCÇS për shkëmbim të ndërsjellë informacioni.

Me miratimin e rregullores për Sektorin e Marrëdhënieve të Punës dhe Migracionit, SHKP, zyrat lokale dhe ato rajonale do të rrisin efektivitetin e punës në menaxhimin e çështjeve të migracionit.

III. Vlerësimet dhe perspektivat e politikës aktuale

MPCÇS e njih nevojën për informim për personat që janë të interesuar të emigrojnë. Vendimi për të emigruar shpesh bazohet në informacion të pakët dhe në idealin e një jete më të mirë jashtë vendit. Shpesh, njerëzit bien pre e kontrabandistëve apo trafikantëve të cilët u premtojnë atyre një jetë më të mire. Për të mënjanuar këto situata, emigrantët e ardhshëm duhen informuar mbi mundësitë e ligjshme për të emigruar dhe me kërkesat që duhet të plotësohen, në veçanti për të punuar jashtë shtetit. Emigrantët në një treg pune të huaj jo gjithmonë janë në dijeni të të drejtave të tyre. Duke qenë pa përkrahje, emigrantët shpesh ballafaqohen me situata kur punëdhënësit i trajtojnë ata ndryshe nga punëtorët vendas. Emigrantët duhet të vihen në dijeni të të drejtave të tyre për të kundërshtuar dhe apeluar ndaj diskriminimit.

Grupi i përzgjedhur

Sigurimi i informacionit nga institucionet shtetërore dhe agjencitë private të punësimit kryesisht fokusohet tek emigrantët për motive punësimi, kjo e mbështetur në Ligjin për Emigracionin i cili mbulon emigracionin për qëllime punësimi. Si rezultat, fokusi i ligjit është shumë i ngushtë. Informacioni duhet të jetë i disponueshëm për të gjithë llojet e emigrantëve si anëtarët e familjes, studentët dhe njerëzit që lrgohen jashtë vendit për periudha të shkurtra për arsye biznesi apo shëndetësore.

Burimet e informacionit

Ashtu siç u përmend më lart, zhvillimi i materialeve siç janë broshurat është një hap në drejtimin e duhur për nxitjen e dhënies së informacionit. Këto broshura duhet të jenë të disponueshme në të gjitha vendet ku emigrantet e mundshëm mund të pyesin për informacion si: zyra kombëtare, rajonale, dhe lokale të punësimit; librari; posta; zyrat e pasaportave, bashki, OJQ që kryejnë shërbime për emigrantët, bashkitë, pikat e hyrjes dhe daljes etj.

Informacioni gjithashtu duhet të jetë i disponueshëm edhe në internet: një faqe e veçantë e internetit për emigracionin duhet të krijohet nga MPCÇS e cila do të përmbajë të gjithë informacionin përkatës. Për të lehtësuar përdorimin e saj, faqe të tjera interneti të institucioneve shqiptare duhet të kenë një lidhje me atë faqe. Adresa e kesaj faqeje interneti duhet të përmendet edhe në fletushka informative dhe broshura të ndryshme.

Politika e Qeverisë për dhënie informacioni duhet të jetë më aktive. Një fushatë mediatike duhet të ndërmerret për t'i vënë njerëzit në dijeni të informacionit që ata mund

të marrin mbi emigracionin, p.sh. mund të bëhen reklama televizive dhe radiofonike ku të tregohen burimet se ku mund të merret informacioni mbi emigracionin. Prezantime dhe seminare mbi rrezikun e migracionit të paligjshëm dhe trafikimit mund të zhvillohen nëpër shkolla dhe universitete në të gjithë vendin.

Llojet e informacionit

Informacioni duhet të përfshijë të gjitha aspektet e emigracionit. Vëmendje e veçantë i duhet kushtuar:

- Rreziqeve dhe pasojave të migracionit të paligjshëm, në veçanti trafikimit të qënieve njerëzore.
- Rrugëve të mundshme ligjore për të emigruar.
- Mundësive të ndërmjetësimit për një punë jashtë shtetit.
- Të drejtave të emigrantëve për motive punësimi në vendin e destinacionit.
- Rëndësia e regjistrimit në faza të ndryshme (përpara nisjes, në vendin e destinacionit dhe në kthim).
- Pasojat në fushën e mbrojtjes sociale të emigrantëve dhe familjeve të tyre.
- Çështjet në fushën e taksave.
- Çështjet që kanë të bëjnë me të drejtën e votës.

Institucionet që trajtojnë emigracionin duhet të japin si informacion të përgjithshëm edhe këshilla në nivelin personal në lidhje me migracionin. Informacioni mund të përfshijë edhe çështje shumë praktike, siç është disponueshmëria e formularëve të aplikimit dhe dhënia e ndihmës për t'i plotësuar ato. Q.A.M e menaxhuar nga I.O.M-i mund të merret si shembull për shërbimet ndaj migrantëve potencialë. Të tilla qendra mund të krijohen edhe në nivel lokal nëpërmjet marrëveshjeve institucione lokale dhe organizatave jo-fitimprurëse.

Institucionet që merren me shpërndarjen e informacionit

Sportelet e Emigrantëve siç janë propozuar në pjesën që përshkruan Kuadrin Institucional duhet të ngarkohen me shpërndarjen e informacionit për emigrantët. Këto sportele duhet të vendosen në të gjithë vendin duke përdorur kapacitetet administrative ekzistuese për shembull të ShKP-ve të bashkive. Informacioni dhe ndihma duhet t'i drejtohet të gjithë kategorive të emigrantëve. Personeli i disponueshëm në ato zyra duhet të marrë trajnimin e duhur.

IV. Propozime për zbatim:

- | | |
|-----|--|
| 77. | Politikat mbi informimin për emigracionin duhet t'i drejtohen çdo kategorie të emigrantëve dhe jo vetëm emigrantëve për motive punësimi; |
| 78. | Ngritja e Sporteleve të Emigracionit, sipas propozimit në pjesën e Kuadrin Institucional, në cilësinë e institucionit që do të merret me dhënie e informacionit për migrim; trajnimi i punonjësve që do të merren me dhënie e informacionit; |
| 79. | Hartimi i fletëpalosjeve që japin informacion të detajuar mbi emigracionin dhe shpërndarja e tyre në vend nëpërmjet shërbimeve të ndryshme publike; |
| 80. | Hapja e një faqeje interneti ku të jepet informacion i detajuar mbi emigracionin; |
| 81. | Fillimi i një fushate informative nëpërmjet reklamave televizive dhe radiofonike të cilat do të rrisin njohjen mbi burimet e informimit për emigracionin. |
| 82. | Organizimi në shkolla dhe universitete në të gjithë vendin, i seminarëve mbi rreziqet e emigracionit të paligjshëm dhe trafikimit të qënieve njerëzore. |

83. Sinkronizimi i eksperiencave të komuniteteve dhe shoqatave jashtë Shqipërisë me qëllim krijimin e një imazhi më të qartë dhe të besueshëm të situatës në vendin pritës.

B.2.1.2. Regjistrimi i emigrantëve

I. Analiza e situatës aktuale

Lidhur me regjistrimin, duhet bërë dallimi midis regjistrimit të gjendjes civile dhe regjistrimit të emigrantëve. I pari është një element bazë për çdo shtet, ndërsa i dyti shndërrohet në element kyç në aspektin e menaxhimit të emigracionit.

Regjistrimi civil në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile është përgjegjësi e Zyrave të Gjendjes Civile. Ligji mbi Gjendjen Civile u krijon mundësi qytetarëve shqiptarë të regjistrohen nëpër ambasadat tona jashtë vendit. Në ligj citohet se “Përfaqesite diplomatike dhe konsullore shqiptare mbajnë libra aktesh të gjendjes civile, administrojnë dokumentacionin dhe kryejnë veprime të gjendjes civile për shtetasit shqiptarë, që janë me banim të përhershëm jashtë Shqipërisë, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj dhe dispozitave të tjera ligjore.”²⁶ Regjistrimi i ndryshimeve të Gjendjes Civile nëpër ambasada bëhet vullnetarisht.

Nga ana tjetër, baza ligjore për regjistrimin e emigrantëve për punë mund të gjendet në ligjin për “Emigrimin për Motive Punësimi” në nenin 8 i cili thekson se “Shtetasit shqiptarë që dëshirojnë të emigrojnë jashtë Shqipërisë për qëllime punësimi regjistrohen në një regjistër të veçantë “Për emigrantët” i cili mbahet nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale”.

II. Prezantimi i politikave aktuale

Shërbimi i Gjendjes Civile deri në këtë moment nuk ka mundësi të identifikojë personat që jetojnë jashtë. Për momentin nuk ekziston një mekanizëm regjistrimi i detyrueshëm për ata që largohen nga vendi.

Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale ka miratuar një Udhëzim²⁷ për funksionimin e një regjistri qendror në Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale dhe një regjistër në nivel rajonal dhe lokal. Emigrantët mund të regjistrohen në zyrën rajonale dhe lokale të punësimit në tre faza të ndryshme të udhëtimit të tyre: kur ata duan të emigrojnë për qëllime punësimi; kur i kanë përfunduar procedurat për nisje dhe kur kthehen. Regjistri nuk funksionon akoma në praktikë pasi udhëzimi është nxjerrë vetëm në 16 Korrik 2004, megjithatë ai përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt mbledhjes së informacionit mbi emigrantët.

III. Vlerësimi dhe perspektiva e politikave aktuale

Kur bëhet fjalë për menaxhimin e suksesshëm të emigracionit, regjistrimi është padyshim i domosdoshëm për t'i ofruar qeverisë të dhënat e nevojshme për të hartuar dhe

²⁶ Neni 65 i Ligjit për Gjendjen Civile Nr. 8950, datë 10. 10. 2002

²⁷ Nr. 1297, datë 16. 07. 2004

monitoruar një politikë pro-aktive. Për të bërë këtë, duhet të merret në konsideratë grupi i përzgjedhur, fazat e regjistrimit, institucioni përgjegjës për regjistrimin, të dhënat që duhen regjistruar dhe çështja e regjistrimit vullnetar/të detyruar, në mënyrë të veçantë përfitimet që mund të ketë migranti nga të qenit i regjistruar, kostot e mundshme si edhe lidhja e regjistrimit me Regjistrin Kombëtar të Gjëndjes Civile dhe me bazat e tjera të të dhënave.

Grupi i përzgjedhur

Regjistrimi i emigrantëve bazohet në Ligjin për Emigracionin për Motive Punësimi i cili merret vetëm me regjistrimin e emigrantëve për motive punësimi. Në kuadrin e arsyeve për të pasur një regjistër- të pasurit e një vështrimi të qartë mbi lëvizjen e qytetarëve jashtë dhe aftësitë e tyre- ky regjister ka një fokus shumë të ngushtë. Regjistrimi duhet të përfshijë të gjithë emigrantët²⁸, ku përfshihen studentët dhe anëtarët e familjeve të emigrantëve.

Fazat e regjistrimit

Zyrat Rajonale dhe Lokale të Punësimit merren me regjistrimin e emigrantëve për qëllime punësimi. Siç u përshkrua më lart, regjistrimi deri tani është konceptuar si një proces me tre faza, ku përfshihet: dëshira, para-nisja dhe kthimi.

Ngrihet problemi nëse regjistrimi në këto tre faza është i përshtatshëm dhe i nevojshëm për të gjithë emigrantët. Është e qartë se “faza e dëshirës” është më e përshtatshme vetëm për menaxhimin e migracionit për motive punësimi. Zyrat e punësimit mund të regjistrojnë punëkërkuarit të cilët duan të punojnë jashtë vendit. Statistikat e këtij regjistri do të luanin një rol të rëndësishëm në politikën e vendit për migracionin për motive punësimi. Regjistrimi në “fazën e dëshirës” do të kishte kuptim vetëm për migrantët për qëllime punësimi.

Regjistrimi i para- nisjes mund të shërbejë për disa qëllime:

- Së pari, i jep qeverisë të dhëna të qarta se kush jeton në vend dhe kush (përkohësisht) jo. Këto të dhëna mund të krahasohen dhe të administrohen paralelisht me regjistrat e Shërbimit të Gjëndjes Civile për t’u qartësuar mbi përbërjen e popullsisë lokale.
- Së dyti, mund të përdoret për të marrë informacion rreth karakteristikave të emigrantëve jashtë shtetit.
- Së treti, regjistrimi përpara nisjes mund të përdoret nga qeveria si një mundësi për të informuar qytetarët e saj rreth vështirësive dhe rreziqeve të emigracionit (ilegal).

Gjithashtu mund të përdoret si një mënyrë për të kontrolluar dokumentat nëpërmjet përfaqësuesve diplomatikë dhe konsullorë jashtë shtetit. (Si psh. të kontrollojnë përmbajtjen e kontratës së punës apo nëse punëdhënësi është me mirëbesim (bona fide). Kjo masë do të shmangte situatat abuzive ndaj emigrantëve.

Në planin e veprimit të Strategjisë do të përcaktohet në mënyrë të detajuar qëllimi i regjistrimit, forma dhe modeli më i mirë në përputhje edhe me procesin e modernizimit të Regjistrimit të Gjëndjes Civile.

²⁸ Ky nocion duhet ripërkufizuar për qëllim regjistrimi.

Regjistrimi i kthimit do të ndihmojë në njohjen e flukseve migratore dhe do të mundësojë krahasimin e të dhënave të mbledhura me ato të Regjistrit të Gjendjes Civile.

Edhe pse nuk përmendet në Udhëzimit, regjistrimi në ambasada apo konsullata në vendet e destinacionit do të lehtësojë organet konsullore në ofrimin e shërbimeve për emigrantët dhe do të sigurojë të dhënat e nevojshme për hartimin e politikave mbi mobilizimin e komuniteteve të emigrantëve.

Institucionet regjistruese

Regjistrimi jashtë vendit domosdoshmërisht bëhet në ambasada dhe konsullata. Për regjistrimin e emigrantëve në Shqipëri ngrihet problemi se kush do të jetë institucioni përgjegjës për regjistrimin në faza të ndryshme.

Është e kuptueshme se regjistrimi nga policia kufitare nuk është i mundur dhe i rekomandueshëm sepse kërkon shumë kohë, dhe në veçanti nëse të dhënat që do të mblidhen janë shumë të detajuara, ato mund të keqkuptohen nga qytetarët si një formë kontrolli në kundërshtim me të drejtën për t'u larguar nga vendi.

Në bazë të udhëzimit të nxjerrë nga MPÇS, Shërbimi Kombëtar i Punësimit dhe zyrat e tij rajonale dhe lokale merren me regjistrimin e emigrantëve për punësim. Kjo detyrë mund të zgjerohet me regjistrimin e të gjithë emigrantëve. Gjithsesi duhet të mendohet edhe për përdorimin e strukturave të tjera ekzistuese për regjistrimin e emigrantëve.

Në lidhje me rrjetin kompjuterik i cili nevojitet të krijohet, mund të krijohet një lidhje me Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.

Të dhënat

Regjistrimi i emigrantëve mund dhe duhet t'i ofrojë qeverisë të dhënat përkatëse për menaxhimin pro-aktiv të emigracionit. Megjithatë, përmbajtja e të dhënave që duhen regjistruar varet nga qëllimet e politikave të emigracionit si edhe nga garancitë dhe dispozitat ligjore në lidhje me fshehtësinë dhe trajtimin e të dhënave personale.

Regjistrimi i para-nisjes është faza më e rëndësishme, e cila duhet të përfshijë detaje në lidhje me personin si arsytet për emigracion, mosha, formimi, aftësitë dhe eksperiencia profesionale e emigrantit, periudha e parashikuar për emigracion, emri dhe adresa e personave që kanë në varësi dhe mundësisht adresa në vendin pritës. Formulari i fazës së nisjes i hartuar për emigrantët për qëllime punësimi, mund të jetë një pikë fillimi për regjistrimin në fazën e dytë.

Në lidhje me gjendjen civile, emigrantet duhet të detyrohen që të deklarojnë mungesën e tyre në zyrat e gjendjes civile dhe sipas rastit t'u hiqet adresa nga regjistri nëse qëndrojnë jashtë vendit për një periudhë kohe që do të parashikohet në detaje në legjislacion. Në momentin e kthimit ata duhet të jenë të detyruar të regjistrohen. Ligji për Gjendjen Civile duhet të ndryshohet me qëllim që të specifikohen këto detyrime për shtetasit shqiptarë.

Regjistrimi i detyrueshëm

Regjistrimi i detyrueshëm në Zyrat e Gjendjes Civile në rast largimi jashtë vendit dhe ri-regjistrimi pas kthimit janë dy elementë të domosdoshëm për një regjistër të besueshëm të gjendjes civile. Në lidhje me emigracionin, duhet të vendoset nëse regjistrimi duhet të jetë i detyrueshëm apo vullnetar për secilën nga fazat. Në rastin më të mirë regjistrimi duhet të jetë me dëshirë dhe i lidhur me një sërë përfitimesh që do të ketë emigranti, por

gjithsesi ky veprim duhet të jetë i detyrueshëm për të gjithë personat që qëndrojnë jashtë vendit për një periudhë të gjatë kohe, periudha të cilat duhet të përcaktohen me ligj. Për shkak të nevojës për të dhëna të sakta për menaxhimin e emigracionit është e qartë se zgjedhja duhet të jetë në favor të regjistrimit të detyrueshëm. Shembuj nga vende të tjera tregojnë se një detyrim i tillë jo gjithmonë zbatohet. Ai duhet të shoqërohet me stimuj. Mundësia për të votuar në ambasadë duhet të kushtëzohet me regjistrimin e personit. Në fazën e para-nisjes, emigrantët duhet të vihen në dijeni të faktit se regjistrimi është një mënyrë për të lehtësuar shërbimet konsullore sepse ata mund t'i konsiderojnë regjistrimet e detajuara si ndërhyrje në jetën e tyre private. Organet kompetente duhet të përcaktojnë me kujdes se çfarë të dhënash nevojiten për menaxhimin eficient të migracionit.

IV. Propozime për zbatim:

84. Organizimi i një debati publik mbi qëllimin e sistemit të regjistrimit të emigrantëve për të hartuar politika të sakta në këtë aspekt;
85. Përcaktimi i mundësive për regjistrimin e detyrueshëm të emigranteve dhe përcaktimi se në cilën fazë (para-nisja nga Shqipëria apo në vendin e destinacionit nëpërmjet ambasadave apo konsullatave shqiptare);
86. Parashikimi i stimujve për të inkurajuar emigrantët që të regjistrohen në faza të ndryshme;
87. Shtirirja e regjistrimit të parashikuar për emigrantët për motive punësimi edhe tek kategoritë e tjera të emigrantëve;
88. Përcaktimi i të dhënave që duhen mbledhur në përputhje me qëllimet e regjistrimit;
89. Kryerja e një studimi teknik të detajuar për të analizuar modalitetet e zbatimit për sistemin e regjistrimit sipas opsioneve dhe alternativave të politikave në lidhje me pikat e përmendura më lart;
90. Përmirësimi i Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile me adresat e qytetarëve që jetojnë jashtë vendit dhe krijimi i një lidhjeje me sistemin e regjistrimit nëpër ambasadë;
91. Përshtatja e Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile me informacionin në lidhje me mungesën e qytetarëve në vend për periudha të cilat duhet të parashikohen qartë në ligj.

B.2.1.3. Marrëveshjet dypaleshe të punësimit ndërmjet Shqipërisë dhe shteteve anëtare të BE.

I. Analiza e situatës aktuale

Deri më sot janë nënshkruar tre marrëveshje punësimi sezonal, respektivisht me Greqinë²⁹, Italinë³⁰ dhe Gjermaninë³¹. Të gjitha marrëveshjet kanë parashikuar periudhën maksimale gjatë së cilës emigranti lejohet të qëndrojë në vendin pritës për qëllimin e përshkruar në marrëveshje.

²⁹ Nënshkruar në 1997.

³⁰ Nënshkruar në vitin 1996.

³¹ Nënshkruar në vitin 1991.

Marrëveshja me Gjermaninë kishte si qëllim t'u ofronte rreth 500-1000 punëtorëve emigrantë në vit trajnime profesionale, trajnime mbi gjuhën gjermane dhe eksperiencë pune. Marrëveshja aktualisht nuk është funksionale. Marrëveshjet me Greqinë dhe Italinë janë marrëveshje për punësim sezonal.

Përveç marrëveshjeve në nivel kombëtar, rajonet italiane po përcaktojnë nën-kuota për emigracion për motive punësimi në kuadrin e kuotave vjetore të parashikuara në legjislacionin italian. Këto rajone mund të arrijnë marrëveshje për punësim sezonal në bazë të nevojave të tyre. Në këtë drejtim, janë bërë kontakte me rajonin e Lombardisë, të Pulias etj.

Nuk ka të dhëna të sakta mbi numrin e emigrantëve që janë punësuar në bazë të këtyre marrëveshjeve, megjithatë mendohet se numri i tyre është i kufizuar, pasi marrëveshjet nuk funksionojnë siç duhet.

Njerëzit që duan të emigrojnë për qëllime punësimi mund të regjistrohen në Zyrat e Punësimit të cilat bashkëpunojnë me agjencitë private të punësimit. Këto zyra dhe agjencitë private të punësimit ndërmjetësojnë me punëdhënësit e huaj. Në praktikë, agjencitë private të punësimit përballen me vështirësi për të gjendur punësim jashtë vendit për klientët e tyre jashtë si pasojë e strukturave paralele informale apo kërkesave të shumta burokratike që duhen përmbushur.

II. Prezantimi i politikave aktuale

Marrëveshjet e punësimit sezonal të lidhura me Italinë, Greqinë dhe Gjermaninë tregojnë për interesimin e organeve kompetente për të diskutuar në nivel politik dypalësh çështjet e punësimit jashtë vendit. Megjithatë, zbatimi i kufizuar i marrëveshjeve ekzistuese mund të ketë ardhur nga fakti se institucionet përgjegjëse për zbatimin apo monitorimin e tyre nuk janë të përcaktuara qartë, shoqëruar kjo edhe me kërkesat e shumta burokratike. Nga ana tjetër, shtetet pritëse janë tërhequr në një fare mase nga zbatimi i plotë i kërkesave të marrëveshjes për shkak se shumë punëtorë emigrantë nuk janë kthyer në vend pas përfundimit të afatit të punësimit sezonal.

III. Vlerësimi dhe perspektiva e politikave aktuale

Megjithë efektin pozitiv që ka emigracioni për vendin në shumë drejtime si në uljen e presionit në tregun e brendshëm të punës dhe si pasojë uljen e nivelit të papunësisë, nivelin e lartë të kursimeve të dërguara në vend- Shqipëria nuk mund t'i bazojë politikat e saj të ardhshme në emigracionin e vazhdueshëm të qytetarëve të saj. Zhvillimi i vendit nuk duhet të shoqërohet me humbjen në mënyrë të vazhdueshme të fuqisë punëtore. Nga ana tjetër, shtetet e BE-së kanë një tendencë për të pranuar gjithmonë e më pak emigrantë për shkak të situatës së brendshme politike dhe ekonomike.

Shqipëria tashmë është e angazhuar në luftën kundër emigracionit të paligjshëm dhe ka marrë masa efektive në këtë drejtim. Miratimi i Strategjisë Kombëtare për Migracionin do të hedhë bazat mbi politikat e ardhshme në lidhje me emigracionin, në veçanti në lidhje me emigracionin për motive punësimi. Në përputhje edhe me politikat e imigracionit të shteteve anëtare evropiane, Shqipëria mund të nënshkruajë dhe të marrë masa të mjaftueshme për zbatimin në praktikë të marrëveshjeve në kuadrin e migracionit sezonal, duke u perpjekur të rrisë emigracionin afatshkurtër dhe të sigurojë kuota shtesë për emigracion për motive punësimi aty ku është e mundur. Negociatat duhet të bazohen

në një studim të përgjithshëm të fuqisë punëtore në vend dhe në një politike afatgjatë të arsimit me qëllim që të përqsë kërkesat për fuqi punëtore me përgatitjen e tyre profesionale.

- Emigracioni sezonal ka nevojë të menaxhohet në përputhje me kërkesën dhe nevojat e shteteve fqinje dhe avantazhet e këtij lloj migracioni për Shqipërinë (marrjes së zakoneve të reja dhe një sërë aftësish të reja profesionale, shtimit të shpejtë të dërgesave në para dhe në të njëjtën kohë mënjanon humbjen e popullsisë lokale pasi emigrantet sezonalë do të kthehen). Paralelisht, duhet të zhvillohet një politikë e cila të synojë gjallërimin e sektorit bujqësor në Shqipëri për të favorizuar punësimin e punëtorëve në vend;
- Emigracioni i përkohshëm – përveç atij sezonal - mund të trajtohet me më shumë kujdes. Kjo mund të bëhet për shembull me anë të negociatave më aktive për rritjen e kuotave për punësimin e emigrantëve në vendet pritëse, e në veçanti me Italinë. Trajnimet profesionale jashtë vendit janë një tjetër aspekt që duhet inkurajuar ose nëpërmjet përfundimit të programeve dypalëshe të trajnimeve profesionale, ose duke ndihmuar të rinjtë të gjejnë vende të tilla pune jashtë vendit që mundësojnë fitimin e aftësive të reja.
- Politikat e migracionit qarkullues duhet të parashikojnë motivime dhe shërbime të tjera të përshtatshme për emigrantët që kthehen në vend me mbarimin e periudhës së emigracionit legal. Emigrantët që respektojnë afatet e vizës duhet të jenë përfitues të shërbimeve apo motivimeve si nga vendi pritës dhe shteti ynë, psh. në marrëveshjet e punësimit sezonal mund të parashikohen lehtësira të tilla si ato që trajtojnë në mënyrë preferenciale punëkërkuesit që kanë respektuar afatet duke u kthyer në vend në përfundim të sezonit (personat që provojnë se janë kthyer në Shqipëri do të kenë preferencë vitet e tjera apo do të përfitojnë nga ky status gjatë viteve në vazhdim);
- Programet e trajnimeve profesionale duhet të parashikojnë që punëtorët e trajnuar të kenë prioritet për të gjetur një pune sapo të kthehen në vend mundësisht me anë të parashikimit të kuotave ad hoc apo motivimeve të tjera që do të mund t'i ndihmojë personat të gjejnë një punë në Shqipëri;
- Emigrantët e përkohshëm me aftësitë dhe kapitalet e nevojshme duhet të stimulohen për të ngritur ndërmarrje të vogla dhe të mesme pas kthimit të tyre.

Gjithashtu, duhet të negociohet me vende të vecanta dhe me BE-në në të ardhmen për adoptimin e një politike moderne e cila mund të përkufizohet si “një derë gjysëm e hapur” mbështetur në lëvizjen e njerëzve në formën e emigracionit qarkullues e cila shpesh është prezantuar si një model i ri, në veçanti nga Komisioni Evropian, megjithëse deri më sot është një fenomen shumë pak i zbatuar. Qëllimi është të lehtësojë lëvizjen e njerëzve në përfitim të shteteve pritëse dhe atyre të origjinës, në veçanti shmangjen e situatave ku emigrantët qëndrojnë në vendin pritës nga frika se pasi të largohen në vendin e origjinës nuk do të mund të kthehen në vendin pritës (fenomeni i ashtuquajtur bllokimi i migrantëve në vendet pritëse pavarësisht nga statusi i tyre ligjor).

- Shqipëria duhet të përpiqet të bindë shtetet e treta që të përfshijnë në dispozitat e legjislacionit të tyre të drejtën e kthimit të shtetasve të vendeve të treta duke përfshirë edhe shqiptarët që përfitojnë nga statusi i qëndrimit afatgjatë në atë vend

- në bazë të direktives së BE-së të datës 25 Nëntor 2003 apo të rregullave favorizuese kombëtare pas një mungese të gjatë (shih nenin 9 të direktivës së përmendur e cila parashikon humbjen apo heqjen e statusit të qëndrimit afatgjatë në rast mungese për 12 muaj në vazhdimësi duke mos lejuar shtetet anëtare të cënojnë këtë parim);
- Personave, të cilët kanë marrë statusin e pensionistit pasi kanë punuar një numër të caktuar vitesh në atë vend, nuk duhet t'u mohohet e drejta që të qëndrojnë në rast të kthimit të tyre në Shqipëri dhe të lejohen të vazhdojnë të përfitojnë nga sistemi i sigurimeve shëndetësore nga ai vend;
 - Emigrantët (për shembull studentët shqiptarë të cilët kanë studiuar jashtë) që kanë qëndruar ligjërisht në një vend të tretë për një periudhë të caktuar kohe e cila duhet të parashikohet në marrëveshjet me vendin pritës, duhet të kenë mundësi të mbajnë dhe të ruajnë kontaktet personale dhe profesionale që ata kanë krijuar. Ata duhet të mundësohen të marrin viza me shumë hyrje-dalje të vlefshme për një kohë të gjatë. Strategjia aktuale ka parashikuar në pjesën që i kushtohet politikave për vizat afatshkurtra disa propozime për këtë qëllim.

Marrëveshjet e punësimit me vendet e treta janë me interes të madh për Shqipërinë dhe janë një mënyrë efektive për të arritur qëllimet e politikave që lidhen me emigracionin sezonal, shtimin e rrugëve për emigracionin e ligjshëm, luftën kundër emigracionit të paligjshëm dhe mbrojtjen e të drejtave të emigrantëve.

Marrëveshje të tilla akoma nuk janë negociuar nga Shqipëria me shtetet anëtare të Bashkimit Evropian për faktin se Këshilli i Ministrave i BE-së për momentin nuk ka miratuar direktivën për punëtorët emigrantë, të propozuar nga Komisioni në korrik të vitit 2001. Ky fakt nuk duhet ta pengojë Shqipërinë të përpiqet të përdorë rrugët/mjetet e Bashkimit Evropian, dhe në veçanti institucionet e ardhshme të cilat do të krijohen për të zbatuar Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit, që të parashtrijë kërkesat e veta.

Duke marrë parasysh lidhjet e ngushta midis Greqisë dhe Italisë, marrëveshjet me këto dy vende meritojnë prioritet. Për të arritur qëllimet e lartpërmendura, duhet negociuar në një fazë të dytë të marrëveshjeve bilaterale me këto dy vende, në vend të ndryshimit të marrëveshjeve ekzistuese. Qeveria duhet të shtrijë synimet e veta edhe në shtete të tjera që kanë mungesë të fuqisë punëtore për të lidhur marrëveshje të tjera punësimi duke u mbështetur edhe në eksperiencën e fituar nga negociatat me Greqinë dhe Italinë. Në këtë drejtim mund të kërkohet edhe ekspertiza e organizatave ndërkombëtare si psh. Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO).

Instrumentat e lartpërmendura mund të përdoren si një mjet për të kontribuar në zhvillimin e një politike punësimi për Shqipërinë. Një politike e tillë emigracioni do të ketë kuptim vetëm nëse zhvillohet në kuadrin e një politike më të gjerë e cila synon në zhvillimin e punësimit në vend e bazuar në tërheqjen e investimeve kombëtare dhe të huaja si edhe krijimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme ku një rol të rëndësishëm do të luanin burimet e emigrantëve Shqiptarë.

IV. Propozime për zbatim:

- | | |
|-----|---|
| 92. | Rishikimi i marrëveshjeve për punësimin sezonal të emigrantëve me Greqinë dhe Italinë dhe, në se gjykohet e nevojshme, rinegociimi i tyre duke përfshirë elementë të rinj që mund të kenë dalë; |
|-----|---|

93. Të kërkohej nënshkrimi i marrëveshjeve për punësim të përkohshëm, të cilat të përfshijnë, mundësisht edhe kurse profesionale për emigrantët;
94. Në të gjitha marrëveshjet, të përfshihen masa dhe dispozita që favorizojnë kthimin e emigrantëve në Shqipëri (si për shembull trajnime profesionale plotësuese në Shqipëri apo ndihmesë për të krijuar ndërmarrje të vogla apo të mesme);
95. Të nxitet emigracioni qarkullues midis Shqipërisë dhe vendeve të treta nëpërmjet përdorimit të procedurave favorizuese për lëvizjen e emigrantëve shqiptarë, si mundësia e kthimit në vendet pritëse në bazë të statusit evropian për qëndrim afatgjatë, ruajtjes së sigurimeve shoqërore për pensionistet në vendet pritëse në rast të kthimit në Shqipëri dhe lehtësimit i vizave për emigrantët legalë pas një periudhe kohe të qëndrimit jashtë;
96. Shfrytëzimi i eksperiencës së marrë me dy partnerët kryesorë (Italinë dhe Greqinë) për të shqyrtuar mundësinë e nënshkrimit të marrëveshjeve të punësimit me vende të tjera, në bazë të interesave reciproke;
97. Përfshirja e ILO-s në hartimin e marrëveshjeve, për të përfituar nga ekspertiza e kësaj organizate me qëllim që të sigurohet respektimi i standarteve ndërkombëtare.

B.2.1.4 Studentët shqiptarë në shtetet anëtare të BE-së

I. Analiza e situatës aktuale

Faktorët që ndikojnë në vendimarrjen e të rinjve për të studiuar jashtë shtetit janë të shumtë, ku cilësia e arsimit të ofruar është një nga faktorët kryesorë. Institucionet arsimore në vend vuajnë nga mungesa e burimeve, si materiale ashtu edhe njerëzore dhe metodologjia e mësimdhënies që aplikohet në shkollat shqiptare është shpesh e vjetëruar. Një tjetër arsye që i detyron studentët shqiptarë të studiojnë jashtë është numri i kufizuar i kuotave të pranimit në universitetet tona. Kërkesa për të studiuar në universitet është më e lartë se kapaciteti ekzistues, si pasojë shumë të rinj janë të detyruar të aplikojnë në universitete të huaja. Gjithashtu, ekzistojnë fusha studimi për të cilat nuk ka programe në Shqipëri; kështu ata që duan të specializohen në këto fusha, veçanërisht në nivel pasuniversitar detyrohen të shkojnë jashtë. Aktualisht rreth 5.000 të rinj shqiptarë studiojnë vetëm në universitetet italiane.

II. Prezantimi i politikave aktuale

Duke qenë se Shqipëria është ende në hapat e para të procesit për t'iu afruar standarteve të BE-së, ajo nuk përfiton nga shumë programe arsimore të disponueshme për shtetet anëtare dhe ato kandidatë, siç është programi Leonardo da Vinci dhe Sokrates (ky i fundit përfshin programin Erasmus). Megjithatë, Shqipëria është një vend partner në programin Tempus objektiv i të cilit është ndër të tjera të favorizojë lëvizshmërinë e studentëve.

Një tjetër program i BE-së ku Shqipëria është e përfshirë është Erasmus Mundus e aprovuar nga BE-ja në dhjetor 2003. Ai është një program bashkëpunimi në fushën e arsimit të lartë i cili synon në promovimin e BE-së si qendër e shkëlqyer arsimore në botë. Programi ofron bursa të financuara nga BE-ja për qytetarët e vendeve të treta të cilët marrin pjesë në këto kurse specializimi.

Shqipëria gjithashtu përfiton nga programet e sponsorizuara nga disa vende evropiane. Italia është një sponsor shumë i madh i marrëveshjeve dypalëshe arsimore dhe vendi

kryesor pritës për studentët shqiptarë. Bursat për studentët shqiptarë ofrohen edhe nga Greqia, Britania, Gjermania dhe Holanda. Shumica e tyre administrohen nga ambasadat e këtyre vendeve me përjashtim të bursave të Polonisë dhe Republikës Çeke të cilat administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

III. Vlerësimi dhe perspektiva e situatës aktuale

Informacioni për studentët shqiptarë në universitetet jashtë vendit për momentin është i kufizuar. Vlen të përmendet baza e të dhënave e krijuar nga fondacioni Soros për studentët pasuniversitarë ndërsa Këshilli Britanik ka mbështetur krijimin e një faqeje interneti të bursave aktuale dhe atyre të viteve të shkuara sipas programeve britanike të bursave FCO.

Në mënyrë që të maksimizohen përfitimet e individit dhe të vendit në tërësi politikat që trajtojnë problemet e studentëve jashtë vendit duhet të bazohen në të dhëna të sakta. Për pasojë, është e nevojshme të mblidhet i gjithë informacioni i disponueshëm duke grumbulluar të gjitha studimet apo të dhënat ekzistuese dhe të bëhet një listë e studentëve shqiptarë të cilët përfitojnë programe para dhe pas universitare, në lidhje të ngushtë me vendet e destinacionit. Ministria e Arsimit dhe Shkencës duhet të punojë në hartimin e platforme politikash për studentët që studiojnë jashtë dhe përfitimet që ka dhe duhet të ketë Shqipëria nga ky fenomen.

Prania e njerëzve të kualifikuar përbën një element kyç për zhvillimin e vendit. Është shumë e rëndësishme që bursat që u ofrohen të rinjve shqiptarë jashtë vendit të përdoren në favor të zhvillimit të Shqipërisë dhe t'u japin studentëve që e meritojnë. Prioritet për bursa studimi duhet të kenë studentët e diplomuar të cilët kanë dhënë prova që mund të dalin me sukses në studime universitare dhe t'u japë atyre mundësinë të fillojnë studime pasuniversitare, apo për studentët që kanë dalë me nota të mira në shkollë të mesme. Dhënia e këtyre bursave duhet të shoqërohet me detyrimin për t'u kthyer (Shiko kapitullin për eliminimin e largimit të trurit nga Shqipëria).

IV. Propozime për zbatim:

- | | |
|------|--|
| 98. | Duhet të realizohet një studim i detajuar mbi flukset e studentëve shqiptarë në universitetet jashtë vendit për të hartuar një politikë adekuate mbi studentët në botë dhe zhvillimin e Shqipërisë; |
| 99. | Në bazë të rezultateve të këtij studimi, të hartohet një politikë me qëllim që bursat të përdoren në favor të zhvillimit të Shqipërisë duke bashkëpunuar edhe me donatorët në këtë drejtim. |
| 100. | Nxitja e universiteteve shqiptare për të shfrytëzuar mundësitë e ofruara nga neni 21 i direktivës së BE-së i vitit 2003 “mbi kushtet e pranimit të qytetarëve të vendeve të treta për qëllime studimi, shkëmbim eksperiencash, trajnime pa pagesë ose shërbimeve vullnetare” të cilat ofrojnë një bazë ligjore për nënshkrimin e marrëveshjeve midis një institucioni të lartë arsimor të një vendi të tretë dhe institucionit të një shteti anëtar të BE-së për hyrjen dhe qëndrimin e studentëve, për të lehtësuar dhe përshpejtuar procedurat e pranimit të studentëve shqiptarë në territorin e shteteve anëtare të BE-së. |
| 101. | Marrja e masave të nevojshme për të promovuar dhe zbatuar programet evropiane për Shqipërinë si ai i Tempus dhe Erasmus Mundus. |

B.2.1.5 Politika e Vizave

I. Analiza e situatës aktuale

Vizat afat shkurtër për në BE³²

Aktualisht Shqipëria bën pjesë në të ashtuquajturën “lista e zezë”³², e cila nënkupton se qytetarët e saj duhet të aplikojnë për vizë për të hyrë në territorin e vendeve anëtare të BE-së. Shtetasit shqiptarë kanë vështirësi për të marrë vizë për në BE. Këto vështirësi fillojnë që nga radhët e gjata, mungesa e informacionit në lidhje me dokumentacionin e nevojshëm për aplikim, procedura të gjata dhe refuzime pa baza të qarta.

Marrëveshjet për regjimin e vizave

Gjatë viteve të fundit Qeveria shqiptare ka bërë marrëveshje të ndryshme dypalëshe në lidhje me vizat. Disa prej tyre, kryesisht jo me shtetet e BE-së, parashikojnë masa lehtësuese si përshpejtimi i procedurave apo dhënia e vizave me shumë hyrje-dalje ku përfshihen shtetasit me pashaportë diplomatike dhe biznesmenët.

Lëvizja e banorëve që jetojnë pranë kufirit

Në vitin 1997, Qeveria shqiptare ka nënshkruar një marrëveshje me Qeverinë maqedonase për qarkullimin e shtetasve që jetojnë në zonat kufitare. Një marrëveshje e tillë i jep të drejtën banorëve të fshatrave në kufi që ta kalojnë kufirin dy herë në muaj. Qëndrimi në vendin tjetër nuk duhet t'i kalojë 48 orët. Shtetasit shqiptarë nuk kanë nevojë të aplikojnë në ambasadë por mund ta marrin vizën në kufirin midis dy vendeve.

II. Prezantimi i politikave aktuale

Në fund të 2002, u ngrit një Grup Pune për lehtësimin e lëvizjes së lirë të qytetarëve shqiptarë. Grupi i punës hartoi një plan ku përcaktoheshin hapat që duhet të ndërmerren institucionet shqiptare që t'i kërkonin shteteve anëtare të BE lehtësimin apo heqjen e rregjimit aktual të vizave për shtetasit e saj. Që nga viti 2002 Qeveria ka intensifikuar përpjekjet për të negociuar dhe përfunduar marrëveshjet dypalëshe me shtete të ndryshme mbi lehtësimin apo heqjen e rregjimit të vizave.

Shengeni Ballkanik

Qeveria shqiptare mbështet krijimin e një “Shengeni Ballkanik”. Ky koncept i bazuar në modelin e marrëveshjes Shengen do të thotë lëvizje e lirë brenda rajonit. Kryeministri shqiptar e ka hedhur këtë ide në kuadrin e procesit të stabilizim asociimit. Në këtë kuadër, Ministri i Punëve të Jashtme ka kërkuar mbështetje për këtë ide nga vendet e Ballkanit Perëndimor. Nga rajoni ka patur reagime pozitive.³³

III. Vlerësimi dhe perspektiva e situatës aktuale

³² Vizat e qëndrimit për periudha më të gjata se tre muaj nuk do të ndikohen nga kjo strategji. Traktati Shengen nuk i trajton këto lloj vizash të cilat identifikohen me shkronjën “D” pasi ato rregullohen ekskluzivisht nga legjislacionin kombëtar i shteteve anëtare.

³² Council Regulation (EC) Nr 539/2001, date 15 Mars 2001

³³ Shih reagimin e Këshilltarit të Ministrisë të Jashtëm për bashkëpunim rajonal në Serbi-Mali i Zi . Ljubisa Perovic në 29 Korrik 2004.

Konceptit të së drejtës për lëvizje të lirë i duhet kushtuar vëmendje e veçantë. Në kuptimin e parë, ky nocion do të thotë e drejta për qytetarët e BE-së të vendosen në një shtet tjetër anëtar pa kufi kohor nëse janë plotësuar kushtet bazë (sigurimi shëndetësor dhe mjete të mjaftueshme për të jetuar). Kjo është e mundur për vetë shtetet anëtare, me një përjashtim thelbësor për dhjetë vendet anëtare të reja pas zgjerimit të fundit, të cilat nuk do të gëzojnë të drejtën e lëvizjes së lirë për qëllime punësimi për një periudhë tranzitore që do të zgjasë deri në shtatë vjet. Në një kuptim më të ngushtë dhe të fundit, ajo i referohet udhëtimit të lirë pa kontrollë të brendshme kufitare për një periudhë deri në tre muaj në zonën Shengen, e cila përbëhet nga shtetet anëtare të BE- së duke hequr Britaninë dhe Irlandën, dhe shtuar Norvegjinë, Islandën dhe Zvicrën në të ardhmen.

Shumë vende të BE-së sugjerojnë se është herët që Shqipëria të hiqet nga lista e zezë të paktën në periudhë afatshkurtër apo afatmesme. Edhe nëse ndodh, kjo nuk do t'i japë të drejtën shqiptarëve që të jetojnë në shtetet anëtare për më shumë se tre muaj, as që ata të punojnë jashtë për më pak se tre muaj. Qeveria në periudhë afat shkurtër dhe afatmesme më shumë do të përqëndrohet në lehtësimin e regjimit të vizave për qytetarët dhe në një periudhë afatgjatë në heqjen e Shqipërisë nga lista e zezë. Angazhimi që ka treguar Shqipëria me perfundimin e marrëveshjes së ripranimit me BE dhe në luftën ndaj migracionit të parregullt është një argument i fortë për lehtësimin e regjimit të vizave.

Mundësia për të përfunduar një marrëveshje për lehtësimin e vizave me Shqipërinë duhet të vlerësohet nga BE-ja bazuar në rregullat ndërkombëtare dhe sipas marrëdhënieve të saj me vendet e tjera të botës së tretë. Marrëveshjet e dyanshme ndërmjet Shqipërisë dhe një ose më shumë shteti anëtar të BE-së mund të jenë të thjeshta për t'u realizuar, edhe nëse kufizimet ligjore që rrjedhin nga "kërkesat Shengen" vendosin kufij gjatë bisedimeve me shtetet anëtare të BE.

Shqipëria synon në hapjen e negociatave me BE-në dhe shtetet anëtare në lidhje me masat e mëposhtme:

- Informacion i qartë në lidhje me kushtet dhe dokumentacionin e kërkuar për të shmangur faktin që aplikantët të kthehen në ambasada dhe të plotësojnë aplikimet e tyre;
- Identifikimi i personave të besuar për të cilët është e mundur të marrin viza me shumë hyrje -dalje të vlefshme për një periudhë të gjatë;
- Vendosja e një afati kohor për dhënien e vendimeve (pozitive apo negative);
- Përmirësimi i logjistikës së ambasadave ku shkojnë shumë qytetarë shqiptarë (p.sh., shtimi i personelit kur priten shumë kërkesa për reduktimin e radhëve të gjata);
- Lehtësimi i lëshimit të vizave të njëpasnjëshme;
- Vendimet e refuzimit të vizave duhet të përmbajnë motivet e refuzimit;
- Aplikantët duhet të kenë të drejtën të kundërshtojnë dhe vendimi duhet ta jap këtë mundësi;

Qeveria duhet t'i bëjë më të thjeshta procedurat administrative për shpërndarjen e dokumentave të nevojshme për të udhëtuar jashtë.

Vendet e Ballkanit si vendet Shengen

Në bazë të synimit të qeverisë për të lehtësuar lëvizjen e lirë të njerëzve, e ashtuquajtura "Shengeni Ballkanik" është një ide pozitive dhe në përputhje ë plotë me metodën e integritit rajonal të parashtruar nga BE-ja në kuadrin e procesit të Stabilizim Asociimit. Ideja së pari do të përpunohet në një plan konkret nga Shqipëria dhe pastaj të hidhet në

vendet e rajonit për diskutim, për shembull me anë të forumit rajonal të MARRI (Migracioni, Azili, Refugjatët, Inisiativa Rajonale) drejtuar nga Shqipëria deri në mars 2005. Plani gjithashtu do të dërgohet edhe në BE. Ajo mund të konsiderohet për mbështetje fondesh sipas Programit Rajonal të CARDS.

Lëvizja ndër-kufitare e banorëve të zonave kufitare

Duhet të vazhdohen përpjekjet e ndërmarra për përfundimin e marrëveshjeve të dyanshme. Duhet ti kushtohet vëmendje projektit të BE për një Rregullore të re për lëvizjen në kufi të banorëve ndërkufitarë²⁰ e cila do të lehtësonte lëvizjen ndërmjet Greqisë dhe Shqipërisë në zonën kufitare.

IV. Propozime për zbatim:

102. Qartësimi i konceptit “lëvizje e lirë e personave” në komunikimin midis qeverisë dhe publikut duke sqaruar dy kuptimet e që i jep e drejta evropiane kësaj shprehjeje.
103. Zhvillimi i negociatave me BE-në dhe me vendet anëtarë për të kërkuar lehtësimin e procedurave të lëshimit të vizave afatshkurtra dhe afatmesme.
104. Përpunimi dhe promovimi i idesë për “Shengenin Ballkanik”.
105. Shtimi i përpjekjeve për të lehtësuar lëvizjen ndërkufitare duke mbajtur parasysht rregullat e ardhshme të BE-së për lëvizjen e lirë të banorëve ndërkufitarë;
106. Lehtësimi i aplikimit të vizave duke përmirësuar procedurat administrative kombëtare që duhet të ndjekin qytetarët për të marrë dokumentacionin e nevojshëm.

B.2.2. Fenomeni i ikjes së trurit

I. Analiza e situatës aktuale

Të dhënat tregojnë një humbje të madhe të qytetarëve të kualifikuar me cilësi të veçanta. Në 1990, 40% e arsimtarëve dhe studiuesve u larguan nga vendi. Dhe ky fenomen vazhdon të ndodhë. Nga numri i studentëve jashtë vlerësohet se 5% e tyre do të kthehen.³⁴ Shumë të rinj mendojnë të largohen nga vendi për një kohë të gjatë, në mos përgjithmonë.³⁵

Në bazë të këtyre të dhënave konkluzioni del se fenomeni i largimit të trurit nga Shqipëria është i përmasave të mëdha. Largimi i trurit nuk përfshin vetëm akademikët, por nuk ka të dhëna të disponueshme të largimit të personave të kualifikuar të fushave të tjera. Në ndryshim të faktit që një numër i madh i studentëve shqiptarë shkojnë në Itali dhe Greqi, “truri” i vendit largohet në drejtim të Kanadasë, SHBA dhe Gjermanisë.

II. Prezantimi i politikave aktuale

²⁰ 2003/0193 (CNS) and 2003/0194 (CNS)

³⁴ Horvat, Vedran: *Brain Drain. Kercenimi per tranzicion te suksesshem ne Evropën juglindore? Politikat evropiane juglindore*, Qershor 2004

³⁵ Të dhënat bazohen në raportin e zhvillimit njerëzor të PNUD, 2000

Në lidhje me fenomenin e largimit të trurit nuk janë marrë shumë masa konkrete. Një masë është favorizimi i kthimit të të rinjve të cilët kanë kryer studimet jashtë shtetit. Në bazë të urdhërit të Kryeministrit nr. 37, datë 28 Janar 2004, këta studentë kanë preferencë për punë në ministri.

Shteti është angazhuar në inkurajimin e kthimit vullnetar të emigrantëve, ku përfshihen individët e kualifikuar dhe ata të arsimuar në nenin 13 të Ligjit për Emigrimin e shtetasve shqiptarë për qëllime punësimi. Mbi këtë bazë ligjore nuk është zhvilluar një politikë konkrete.

III. Vlerësimi dhe perspektiva e situatës aktuale

Edhe pse mund të gjenden anë pozitive të largimit të trurit- në periudhë afatgjatë kuptohet se humbja e personave të kualifikuar dhe të arsimuar është në dëm të zhvillimit socialo-ekonomik të një vendi, pasi ata janë forca drejtuese e çdo vendi.

Në ndryshim nga të ardhurat nga emigrantët, ku Shqipëria mund të përfitojë edhe gjatë mungesës së tyre, efektet pozitive të emigrantëve të kualifikuar për punë do të ndihen kur ata të kthehen në vend. Kthimi i tyre pasi ata të kenë përfituar dije dhe eksperiencë të mëtejshme jashtë ka ndikim të rëndësishëm për kapitalin njerëzor të vendit. Ata do të sjellin kapital financiar në formën e kursimeve dhe kapital social në formën e kontakteve personale dhe profesionale dhe një mënyrë të re sjelljeje.

Përsa u tha më sipër, në lidhje me largimin e trurit; për ta kthyer humbjen në efekte pozitive fokusi i politikës duhet të përqëndrohet në “qarkullimin e trurit”. Për ta thjeshtuar procesin nga largimi i trurit në lëvizjen e lirë të trurit, qeveria duhet të marrë masa për të shmangur largimin (e përhershëm) të individëve të kualifikuar dhe të arsimuar dhe të promovojë migracionin e përkohshëm dhe në veçanti migracionin qarkullues. Për ta bërë sa më tërheqëse kthimin e tyre duhen marrë masa të mëtejshme.

Masa për të shmangur largimin e trurit

Duhet bërë një vlerësim i përgjithshëm i nevojave të vendit – në kuadrin e zhvillimit, psh. tregu i punës dhe/ose nevojat mësimore- për t’iu përgjigjur pyetjes se cili grup emigrantësh duhet përfshirë në politikën që do të hartohet. Qeveria duhet të përqëndrohet tek individët e kualifikuar kontributi i të cilëve është shumë i dobishëm për zhvillimin e vendit.

Një grup përfshin profesorë universitetesh, shkencëtarë dhe studiues. Duhet marrë masa për të shmangur arsyet që ndikojnë për migracionin tek ky grup i veçantë i emigrantëve. Niveli cilësor i instituteve ku ata punojnë duhet përmirësuar, ç’ka kërkon investim të përshtatshëm nga qeveria.

Për të shmangur largimin e personave të kualifikuar që mund të punonin në Shqipëri apo të kontribuonin në zhvillimin e vendit, duhen marrë masa si përmirësimi i investimeve në Shqipëri për të ofruar mundësi karriere në punë.

Shqipëria duhet të përpiqet të arrijë marrëveshje me shtetet kryesore pritëse si psh: Kanadaja dhe SHBA, mbi masat që synojnë nxitjen e kthimit vullnetar të emigrantëve të kualifikuar, sidomos të profesionistëve për të cilët ka nevojë të madhe në vend që janë larguar në kuadrin e programeve për emigracionin e personave të kualifikuar që kanë këto shtete.

Inkurajimi i lëvizjes së emigrantëve të kualifikuar

Një mjet në procesin e ndryshimit të kursit nga “largimi i trurit” në “lëvizjen e lirë të trurit” është inkurajimi i lëvizjes së lirë të personave të kualifikuar. Për të arritur këtë qëllim duhen hartuar programe si:

- Programe për një lëvizje të lirë me ndërmarrje private apo autoritetet lokale apo rajonale jashtë dhe në vend (trajtime pune jashtë për një periudhë të caktuar me angazhimin për t’u kthyer të shoqëruar me një ofertë pune në Shqipëri)
- Të rinj të talentuar duhet të tërhiqen drejt një karriere shkencore në vend, duke iu ofruar atyre bursa për studime të mëtejshme jashtë ose duke iu ofruar mundësinë të marrin pjesë në programe me shkëmbim eksperiencash me vendet e treta, me detyrimin për t’u kthyer, si një investim për të ardhmen për të rritur nivelin e akademikëve të ri. Për të siguruar kthimin e tyre, institucionet (dërguese) duhet të mbajnë marrëdhënie të afërta me emigrantët jashtë dhe t’ju ofrojnë atyre mundësi punësimi pas kthimit të tyre. Institucionet përkatëse duhet të kenë kujdes që përzgjedhja e kandidatëve dhe dhënia e bursave të jetë e merituar.
- Emigrantëve të kualifikuar u duhet kërkuar të vijjnë vullnetarisht në Shqipëri gjatë qëndrimeve të shkurtra për qëllime konsultimi, mësimdhënie (për shembull në shkolla verore) apo trajtime. Duhet bërë një listë e personave të disponueshem dhe të gjithë intelektualëve që ndodhen jashtë vendit. Duhet të mbulohen shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit për t’i inkurajuar këta persona që të vijjnë dhe të marrin pjesë.
- I njëjti objektiv mund të realizohet me anë të mësimdhënies apo programeve të trajnimit në distancë. Për më tej, Shqipëria duhet të tërheqë talentet që jetojnë jashtë për të përfituar nga kontributet e tyre me anë të teknologjive të reja si në kontekstin kombëtar intelektual ashtu edhe në zhvillimin e mundësive të investimit.
- Emigrantëve të kualifikuar duhet t’u ofrohen mundësitë nga vendi pritës që të kthehen në Shqipëri për një periudhë dhe qëllim të caktuar pa humbur të drejtën e tyre të qëndrimit jashtë. Në këtë kuadër duhen rënshkruar marrëveshje dypalëshe me vendet e destinacionit.

Inkurajimi i kthimit të emigrantëve të kualifikuar

Një mënyrë për t’i përfshirë emigrantët që jetojnë jashtë në zhvillimin e vendit është inkurajimi i tyre për t’u kthyer në atdhe. Çdo veprim që synon të tërheqë profesionistët të kthehen në atdhe duhet të bazohet në kërkesën efektive të tregut të punës në vend dhe në një studim të kujdesshëm të mundësive të punësimit. Duhet hartuar politika nxitëse për të joshur kthimin e personave të kualifikuar. Kjo supozon se ata persona mund të mendojnë për mundësitë për një punë të paguar, interesante dhe të bëjnë karrierë në Shqipëri. Masat për të zbatuar një politikë të tillë sigurisht janë përtej qëllimit të kësaj strategjie, por duhet nënvizuar lidhja e strategjisë prezente me politikat ekonomike dhe ato të punësimit.

Duhet zhvilluar programe për të tërhequr emigrantët e kualifikuar që punojnë jashtë dhe në të njëjtën kohë duhet të diskutohet në lidhje me mundësinë e zëvendësimit të specialistëve të huaj me specialistët shqiptarë në vend.

Për emigrantët krijimi i mundësive të punësimit mund të jetë deciziv për kthimin e tyre. Duhet krijuar kontakte me emigrantët për t’i informuar për mundësitë e punësimit ashtu

siç është propozuar në një pjesë të kësaj strategjie e cila i kushtohet konsolidimit të komuniteteve shqiptare jashtë.

Qeveria mund të arrijë marrëveshje me organizatat ndërkombëtare për një program pilot ku të përfshijë të rinj të diplomuar jashtë në projektet e tyre.

IV. Propozime për zbatim:

107. Vlerësimi i kërkesë-ofertës për personat e kualifikuar në tregun e punës me qëllim hartimin e një politike mbi këtë fenomen;
108. Marrja e masave për të shmangur largimin e trurit duke rritur ofertën për punësim në vend dhe negociimi me vendet pritëse për të stimuluar kthimin e një kategorie profesionistësh të nevojshëm në Shqipëri;
109. Krijimi i mundësive për një lëvizje të lirë të emigrantëve të kualifikuar nëpërmjet nxitjes së shkëmbimeve të personelit (migracioni qarkullues) midis shoqërive private, shkëmbimeve midis autoriteteve lokale dhe rajonale në vend dhe jashtë, programeve të shkëmbimit për akademikët, programe për vullnetarët dhe programe të kthimit të përkohshëm të emigrantëve në Shqipëri në bazë të marrëveshjeve bilaterale që garantojnë të drejtën për t'u kthyer në vendin pritës;
110. Qeveria në bashkëpunim me institucionet ndërkombëtare të specializuara duhet të hartojnë programe për të tërhequr studentët në mënyrë që njohuritë e tyre të përdoren në vend.
111. Nxitja e i kthimit të emigrantëve të kualifikuar duke krijuar kontakte midis tyre dhe ndërmarrjeve të mëdha në vend.
112. Nxitja për t'u kthyer duke përdorur kontributet e migrantëve të kualifikuar në jetën sociale dhe civile nëpërmjet përdorimit të teknologjive të reja.

C. Përmirësimi i Kuadrit Ligjor për Migracionin në Shqipëri

I. Analiza e situatës aktuale

Shqipëria ka hartuar një kuadër të gjerë ligjor ku parashikohen çështjet e migracionit, ku një pjesë e mirë e saj është miratuar kohët e fundit.

Emigracioni

Akti ligjor që rregullon emigracionin është Ligji “Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi”³⁶. Subjekte të këtij ligji janë shqiptarët që emigrojnë për qëllime punësimi në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe atë të vendit pritës. Ky ligj siguron kuadrin për të drejtat e emigrantëve dhe detyrimet e shtetit ndaj shtetasve të tij jashtë vendit. Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale është autoriteti kompetent që merret me çështjet e emigracionit në Shqipëri. Gjithashtu, Ligji parashikon se agjencitë private të punësimit mund të funksionojnë si ndërmjetëse për punësimin e shtetasve shqiptarë jashtë vendit. Aktiviteti i këtyre agjencive është rregulluar në mënyrë më të detajuar në vendimin e Këshillit të Ministrave “Për mënyrën e licensimit dhe funksionimit të agjencive private të punësimit”³⁷. Ndërkohë, Ligji për Nxitjen e Punësimit³⁸ rregullon ndër të tjera edhe çështjet e punësimit të qytetarëve Shqiptarë jashtë territorit të Shqipërisë.

³⁶ Ligji Nr.9034 datë 20.03.2003

³⁷ VKM Nr.708 datë 16.10.2003.

³⁸ Ligji Nr. 7995/1995.

Disa akte të tjera ligjore si Ligji “Për ushtrimin e funksioneve konsullore nga përfaqësitë diplomatike dhe konsullore”³⁹; “Për Gjendjen Civile”⁴⁰ dhe “Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pashaportë për jashtë shtetit”⁴¹ parashikojnë një sërë të drejtash dhe shërbimesh të cilat gëzohen nga emigrantët shqiptarë.

Imigracioni

Bazat e kuadrit ligjor për imigracionin janë parashtruar në ligjin “Për të Huajt”⁴² i cili parashikon kushtet e hyrjes, qëndrimit, rastet e dëbimeve, të drejtat dhe detyrimet e të huajve si edhe autoritetet kompetente që merren me çështjet e imigracionit. Hyrja, qëndrimi dhe trajtimi i të huajve në Shqipëri, në veçanti çështjet që kanë të bëjnë me lejet e qëndrimit dhe vizat jepen në mënyrë më të detajuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.439/2000⁴³ dhe në udhëzimin e përbashkët të Ministrisë të Rendit Publik dhe të Ministrisë të Punëve të Jashtme⁴⁴. Çështjet që lidhen me lejen për punë të të huajve janë specifikuar edhe në vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 262 datë 25.05.2000 “Mbi dhënien e lejeve për punë të huajve” dhe në udhëzimin e MPCŞ Nr.786/2001 “Mbi dhënien e lejeve për punë të shtetasve të huaj”.

Shqipëria ka miratuar ligjin “Për ruajtjen e kufirit shtetëror të Republikës së Shqipërisë”⁴⁵ i cili specifikon procedurat që duhen ndjekur gjatë kalimit të kufirit, rregullat dhe detyrat e Policisë Kufitare në pikat e kalimit të kufirit dhe gjatë kontrollit të kufirit, procedurat që duhen ndjekur me emigrantët dhe imigrantët e paligjshëm. Gjithashtu, udhëzimi “Për procedurat që duhen ndjekur nga Policia e Shtetit për përzgjedhjen e të huajve të ndaluar”⁴⁶ përshkruan në detaje autoritetet kompetente që merren me këtë proces, procedurat që ata duhet të ndjekin si edhe të drejtat e të huajve që kanë hyrë në mënyrë të paligjshme në Shqipëri.

Shteti shqiptar së bashku me katër vendet e Evropës Juglindore ka nënshkruar Deklaratën e Tiranës në dhjetor 2002 në të cilën palët marrin përsipër të parashikojnë në legjisllacion lejen e qëndrimit të përkohshëm për qytetarët e vendeve të treta të identifikuar si viktimat e mundshme të trafikut.⁴⁷

II. Prezantimi i politikave aktuale

Qeveria Shqiptare ka shprehur qartë angazhimin e saj që të përmirësojë në mënyrë të vazhdueshme legjisllacionin për migracionin në përputhje me standartet e BE dhe ato ndërkombëtare⁴⁸ për të garantuar respektimin e të drejtave të emigrantëve shqiptarë jashtë si dhe krijimin e kushteve të duhura për të huajt për të gëzuar të drejtat e tyre në Shqipëri.

Emigracioni

³⁹ Ligji Nr. 8372 datë 09.07.1998

⁴⁰ Ligji Nr. 8950 datë 10.10.2002

⁴¹ Ligji Nr. 8668 datë 23.11.2000

⁴² Ligji Nr.8492/1999.

⁴³ VKM Nr. 439/2000 “Për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Shqipëri”.

⁴⁴ Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë të Punëve të Jashtme Nr. 2430 datë 14.05.2001 dhe Ministrisë të Rendit Publik Nr. 1460 datë 21.05.2001” Mbi procedurat e hyrjes, qëndrimit dhe trajtimit të të huajve në RSH”.

⁴⁵ Ligji Nr. 8772 datë 19.04.2001.

⁴⁶ Udhëzimi Nr.1382/2001.

⁴⁷ Mundësia për këtë leje qëndrimi është parashikuar në projektligjin për ndryshime dhe shtesa në Ligjin për të Huajt i planifikuar për miratim në Dhjetor 2004.

⁴⁸ Shih Planin e Veprimit për përmirësimin e lëvizjes së lirë të Njerëzve.

Qeveria ka marrë masa për të bërë ndryshime në Ligjin për Emigracionin⁴⁹ me qëllim përafrimin me standartet ndërkombëtare. Këto ndryshime do të miratohen në dhjetor 2005. Në përputhje me dispozitat e Ligjit për Emigracionin, është parashikuar hartimi i një akti ligjor për nxitjen e kthimit vullnetar të emigrantëve dhe ri-integrimin e tyre në Shqipëri⁵⁰.

Imigracioni

Në 2004, IOM në bashkëpunim të ngushtë me Qeverinë Shqiptare hartoi “Raportin për analizën e mangesive për legjislacionin dhe praktikën e imigracionit shqiptar krahasuar me standartet e BE-së dhe ato ndërkombëtare”. Studimi kishte si synim identifikimin e kuadrit ligjor dhe institucional në fushën e imigracionit dhe për të qartësuar se deri në çfarë mase përputhet me standartet evropiane. Në bazë të komenteve të përsëritura në analizen e mangësive dhe nga aktorë të tjerë në fushën e imigracionit, Këshilli i Ministrave ka miratuar një projektligj për ndryshime në Ligjin për të Huajt, i cili pritet të aprovohet nga Parlamenti në fund të vitit 2004. Shqipëria e konsideron hartimin e ndryshimeve përkatëse në aktet nëligjore p.sh. ë VKM 439/2000 dhe udhëzimit ë përbashkët të MPJ dhe MRP brenda shkurtit 2005 si prioritet⁵¹.

Po shqyrtohet mundësia e një ligji të ri mbi Policinë Kufitare që parashikon ndër të tjera attribute hetimore, të mbledhjes së informacioneve, të shërbimeve të inteligjencës. Aktualisht, Zyra e Pasaportave dhe të Huajve në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Rendit ka kaluar në Drejtorinë e Policisë Kufitare dhe Migracionit dhe quhet Sektori i Trajtimit të të Huajve dhe dhe Migracionit.

Në fushën e instrumentave ndërkombëtare, Qeveria Shqiptare ka theksuar nevojën për ratifikimin e disa konventave siç është Konventa ILO mbi migracionin për qëllime punësimi (C.97)⁵²; Konventa ILO e punëtorëve migrantë (C 143)⁵³; Konventa e KE mbi statusin ligjor të punëtorëve emigrantë⁵⁴ dhe Konventa e OKB-së mbi mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve migrantë dhe familjeve të tyre^{55, 56}.

III. Vlerësimi dhe perspektiva e situatës aktuale

Duke marrë në konsideratë situatën e Shqipërisë dhe faktin se fenomeni i emigracionit është shumë më i prekshëm sesa ai i imigracionit në vend, menaxhimi i emigracionit duhet të vlerësohet si një prioritet. Për pasojë, organet përkatëse duhet t’i japin prioritet plotësimit të kuadrit ligjor të emigracionit në krahasim me kuadrin ligjor të imigracionit. Ky prioritet, është në përputhje me interesat e vendit dhe nuk duhet të ndikohet nga fakti se nuk ekziston asnjë *acquis* evropian për emigracionin. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se nuk duhet t’i kushtohet vëmendje kuadrit ligjor për imigracionin, por zbatimi i *acquis* evropian në atë fushë mund të planifikohet në një periudhë më afatgjatë nga vetë natyra e

⁴⁹ Ky ligj është miratuar në 20.03.2003

⁵⁰ Shih Dokumentin e Matricës së Partneritetit Evropian.

⁵¹ Si më sipër.

⁵² Parashikuar në dokumentin për PE për ratifikim në Mars 2005.

⁵³ Parashikuar për ratifikim në tetor 2006.

⁵⁴ Parashikuar për ratifikim në prill 2006.

⁵⁵ Parashikuar për ratifikim në dhjetor 2006.

⁵⁶ Në kuadrin e këtyre konventave, Qeveria Shqiptare ka planifikuar miratimin e një Ligji për Asistencë dhe Ndihmë Sociale (dhjetor 2004); miratimin e ndryshimeve në Ligjin për nxitjen e punësimin (prill 2005) dhe një sërë ndryshimesh në ligjin për sigurimet shoqërore në Shqipëri (2005).

saj dhe në veçanti sepse afatet kohore për adaptimin e tyre nga shtetet anëtare nuk kanë skaduar për shumë direktiva.

Emigracioni

Ligji është i kufizuar vetëm tek emigrantët për qëllime punësimi, duke lënë kështu jashtë kategoritë e tjera të emigrantëve që largohen për bashkim familjar, studime, trajnime profesionale, etj. Nevojiten akte nënligjore për të specifikuar procedurat që duhen ndjekur dhe masat e Qeverisë Shqiptare për të mbështetur emigrantët në lidhje me integrimin e tyre në vendet pritëse⁵⁷. Në mënyrë të veçantë duhet të shpjegohet se si emigrantët do të gëzojnë të drejtat e tyre si psh. liria politike, të parashikuara në kushtetute. Në këtë drejtim, duhet të krijohen mundësi reale që shqiptarët të votojnë në zyrat konsullore dhe diplomatike në vendet ku ata banojnë, pas regjistrimit të tyre paraprak. Për pasojë, në Kodin Zgjedhor duhet të bëhen ndryshimet përkatëse.

MPCS duhet të bashkëpunojë me ministrinë e tjera për të hartuar ndryshimet përkatëse të akteve të tjera ligjore të parashikuara në ligjin “Për Emigrimin e shtetasve për motive punësimi”, siç është Kodi Penal⁵⁸ dhe ligji “Për ushtrimin e funksioneve konsullore nga përfaqësitë diplomatike dhe konsullore”⁵⁹. Siç është parashikuar në ligjin “Për Emigrimin e shtetasve për qëllime punësimi”, duhet të miratohet një ligj për tarifën e shërbimeve të ofruara nga zyrat konsullore ku të përcaktohen tarifa transparente për të gjitha shërbimet e ofruara, me qëllim shmangien e tejkalimit të kompetencave dhe rrezikun e korrupsionit nga ana e zyrtarëve përgjegjës. Ka kaluar një vit pas aprovimit të ligjit “Për Emigrimin e shtetasve për qëllime punësimi” në mars të vitit 2003, dhe shumë pak progres është bërë përsa i përket kuadrin ligjor të kërkuar për zbatimin e tij.

Immigracioni

Ndryshimet që parashikohen në Ligjin për të Huajt duhet të marrin në konsideratë të gjitha komentet dhe mangësitë e përmendura në “Raportin e mangësive” me qëllim që të përfshijnë përkufizimin e minorenëve të pashoqëruar, martesave me qëllime përfitimi, dokumentave të pranueshme të udhëtimit, bashkimit familjar të cilat nuk janë të shprehura qartë apo nuk janë përmendur fare në amendamentet e propozuara. Në legjislacionin e brendshëm ekzistojnë akoma kondradikta, veçanërisht midis ligjeve dhe akteve nënligjore, për pasojë duhet të merren masa për trajtimin e tyre.⁶⁰ Paqartësitë, mungesa e referencave në aktet e tjera ligjore apo autoriteti përkatës shpesh krijojnë konfuzion në çështjet proceduriale përsa i përket refuzimit të vizave, lejeve të punës, lejeve të qëndrimit dhe rasteve të largimit apo dëbimit.

Institucionet përkatëse aktualisht po punojnë për ndryshimet në VKM 439/2000 dhe udhëzimit të përbashkët të MRP/MPJ të cilat janë parashikuar për aprovim në shkurt 2005.⁶¹ Miratimi i ndryshimeve tek Ligji për të Huajt duhet të shoqërohet me miratimin e akteve nënligjore.⁶²

⁵⁷ Shih nenet 6, 7 të Ligjit për Emigracionin.

⁵⁸ Shih nenin 9 të Ligjit për Emigracionin.

⁵⁹ Ligji për Emigracionin i referohet shërbimeve të ofruara nga zyra konsullore për të cilat kërkohen amendamente shtesë të ligjit “Mbi ushtrimin e shërbimeve konsullore”.

⁶⁰ Për shembull në lidhje me moshën kur një person mund të quhet i mitur. Për më shumë detaje shih raportin e mungesave fq.86.

⁶¹ Shih dokumentin e Partneritetit Evropian.

⁶² Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur akti nënligjor siguron një përshkrim të detajuar të detyrave dhe procedurave që duhen ndjekur nga zyrtarët shqiptar.

Amendamentet e reja të Ligjit për të Huajt prekin një pjesë të konsiderueshme të ligjit, dhe për më tepër prezantojnë parime të reja. Aktet nënligjore të cilat rregullojnë imigracionin kanë ndryshuar shpesh dhe kanë krijuar vështirësi veçanërisht për zyrtarët që merren me zbatimin e legjislacionit. Për të siguruar qëndrueshmërinë e kuadrit ligjor, është më e përshtatshme të proedohet me hartimin e një ligji të ri dhe akteve përkatëse nënligjore të reja në vend të një procesi të gjatë ndryshimesh; kjo do të ishte në përputhje me udhëzimet e “Manualit për hartimin e ligjeve-udhëzime për procesin legjislativ në Shqipëri” i vitit 2003.⁶³

Instrumentat ndërkombëtare

Shqipëria ka parashikuar ratifikimin e disa konventave për mbrojtjen e migrantëve⁶⁴ brenda vitit 2006. Ratifikimi i standarteve ndërkombëtare duhet të shoqërohet me zbatimin dhe monitorimin e tyre. MPÇS duhet të bëjë një studim për të siguruar se deri në çfarë mase kuadri legjislativ dhe institucional shqiptar përshtatet me standartet e propozuara, studim i cili duhet shoqëruar me reformat përkatëse të legjislacionit.⁶⁵

IV. Propozime për zbatim:

113. Të bëhen ndryshimet e nevojshme në ligjin “Për shërbimet konsullore” duke shtuar shërbimet në favor të emigrantëve që parashikohen me Ligjin Për Emigrimin e Shtetasve Shqiptarë për Motive Punësimi; të bëhen ndryshime në Kodin Penal duke shtuar ndëshkimin ndaj personave apo agjencive që japin informacione të rreme në lidhje me emigrimin, në përputhje me kërkesat e Ligjit për Emigrimin; të bëhen ndryshimet përkatëse në Kodin Zgjedhor me qëllim që të parashikohet e drejta e votës për emigrantët në vendet ku ata jetojnë duke krijuar një mundësi të tillë në zyrat e përfaqësive konsullore dhe diplomatike; miratimi i të gjitha akteve nënligjore të nevojshme për të zbatuar Ligjin për Emigracionin.
114. Përfshirja në aktet ligjore që mbulojnë imigracionin e rekomandimeve të “Raportit të mangësive” në veçanti në lidhje me martesat për qëllime përfitimi dokumentat e udhëtimit, përkufizimit të “periudhës së pandërprerë”, çështjet e bashkimit familjar, minorenët e pashoqëruar, kërkesat e lejeve për punë për periudhe punësimi më pak se 3 mujore dhe më shumë të drejta për imigrantët afatgjatë.
115. Planifikimi i hartimit të një vendimi të ri në vend të VKM 439/2000 dhe i një udhëzimi të përbashkët “Mbi hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Shqipëri”.
116. Caktimi i MPÇS për të ndërmarrë një studim mbi ndikimet e tre konventave ndërkombëtare që lidhen me punëtorët migrantë të planifikuara për ratifikim nga Shqipëria gjatë viteve 2005 dhe 2006 duke plotësuar në këtë mënyrë Raportin e Mangësive në lidhje me Konventën e OKB- së për mbrojtjen e të drejtave të të gjithë punëtorëve migrantë dhe anëtarëve të familjeve të tyre.
117. Botimi i një teksti të plotë ligjor ku të përfshihen të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore mbi emigracionin dhe imigracionin, si edhe konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria.

⁶³ Shih kap. 1.3.4 te 2003 “Manuali për hartimin e ligjeve që përfshin një udhëzim të procesit legjislativ në Shqipëri”.

⁶⁴ Shih më sipër, Politikat Aktuale.

⁶⁵ Ketu përfshihen reforma në kuadrin e akteve ligjore në fushën e sigurimeve shoqërore, sigurimet shëndetësore, arsimimin, punësimin, akomodimin, ndihmën sociale, etj.

- | | |
|------|--|
| 118. | Hartimi i manualeve praktike mbi çështje të ndryshme që lidhen me migracionin dhe vënia e tyre në dispozicion të zyrtarëve që merren me aplikimin e rregullave sipas rasteve individuale. |
| 119. | Krijimi i një njësie të specializuar në legjislacionin për migracionit brenda MRP-së dhe MPCs-së për të ndërmarrë të gjitha reformat e nevojshme në legjislacionin shqiptar të migracionit dhe për koordinimin e punës së tyre në bazë të nevojës. |
| 120. | Përcaktimi i nevojave për trajnime ligjore për personelin e të gjithë institucioneve që merren me politikën e migracionit. |

D. Organizimi i një strukture të përshtatshme institucionale për të menaxhuar politikën e migracionit, në veçanti për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin

I. Analiza e situatës aktuale

Emigracioni

Autoriteti kompetent qeveritar për emigracionin është Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale (MPÇS). Kompetencat ushtrohen nga Sektori i Emigracionit i Drejtorisë së Migracionit bazuar në ligjin “Për Emigracionin e shtetasve shqiptarë për qëllime punësimi” të datës 20 mars 2003.

Bazuar në ligjin “Mbi nxitjen e Punësimit”⁶⁶, Shërbimi Kombëtar i Punësimit (SH.K.P) me anë të zyrave të tij rajonale dhe lokale, mund të ndërmjetësojë për punë jashtë vendit, bazuar në marrëveshjet ekzistuese për punë me vende të tjera. SH.K.P-ja është një shërbim publik autonom në nivel të administratës shtetërore qendrore dhe përgjigjet në MPÇS⁶⁷.

Gjithashtu ekziston një Institut Kombëtar për Diasporën Shqiptare i cili varet nga Ministria e Punëve të Jashtme. Instituti Kombëtar për Diasporën Shqiptare është pjesë e Ministrisë së Punëve të Jashtme (MPJ). Detyrat e tij janë: të mbledhë informacion të plotë dhe të detajuar mbi diasporën shqiptare e cila shërben për përgatitjen e atlasit gjeografik dhe demografik; të shtojë kontaktet e çdo niveli të mundshëm midis diasporës dhe Shqipërisë; të përmirësojë dhe garantojë të drejtat e shtetasve shqiptarë që jetojnë dhe punojnë jashtë vendit; të identifikojë studentët me diplomë universitare dhe pasuniversitare të cilët aktualisht studiojnë jashtë vendit.

Imigracioni

Në ndryshim me emigracionin, kompetencat në lidhje me imigracionin janë më të ndara pasi janë tre ministri që merren me këtë fushë.

Së pari, Ministria e Rendit Publik (MRP) është ministria kryesore që merret me imigracionin. Ajo trajton problemet me të huajt që nga momenti i hyrjes në vend deri në largimin e tyre. Sektori i të Huajve në Zyrën për Pashaportat dhe të Huajt është përgjegjës për lëshimin, rinovimin dhe anulimin e lejeve të qëndrimit. Ai gjithashtu përgatit dhe dërgon propozimet për dhënien dhe heqjen e shtetësisë te Presidenti i Republikës. Policia kufitare merret me kontrollin kufitar, në veçanti në lidhje me kontrollin e hyrjes së

⁶⁶ Ligji nr. 7995, datë 20.09.1995, neni 7

⁶⁷ Neni 17

ligjshme të personave në Shqipëri. Në vijim, Policia e Rendit Publik dhe Policia Kriminale kontrollojnë dhe hetojnë rastet e imigracionit të paligjshëm. Zyra për Refugjatët, përgjegjëse për trajtimin e kërkesave për azil është në MRP.

Së dyti, Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ) nëpërmjet shërbimeve diplomatike është përgjegjëse për lëshimin e vizave afatshkurtra të qytetarëve të huaj. MRP gjithashtu luan një rol të caktuar në këtë procedurë pasi inspekton aplikimet për vizë për arsye sigurie.

Së treti, Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale (MPCŞ) përpunon politikat e punësimit për të huajt nëpërmjet Sektorit të Imigracionit të Drejtorisë për Migracionin. Ajo gjithashtu ka kompetencat për të dhënë leje për punë⁶⁸. Inspektoriat Shtetëror i Punës inspekton punën e imigrantëve dhe është përgjegjës për problemet e diskriminimit.

Shërbimi Kombëtar i Punësimit gjithashtu ka kompetenca të rëndësishme në fushën e migracionit. Zyrat e punësimit, sipas territorit që mbulojnë, lëshojnë lejet për punë. Shërbimi Kombëtar i Punësimit gjithashtu përfshin një Sektor për Çështjet e Migracionit dhe të Punës; roli kryesor i të cilit është të mbështesë punën e zyrave rajonale të punësimit dhe të bashkëpunojë me Drejtorinë e Migracionit në MPCŞ.

II. Prezantimi i politikave aktuale

MRP-ja është në një reformë të vazhdueshme. Po shqyrtohet një propozim për një ligj të ri për Policinë Kufitare. Qëllimi është të rrisë rolin e Policisë Kufitare në nivelet e një institucioni qendror të zbatimit të ligjit si Policia e Rendit Publik. Ajo do të kishte një buxhet të veçantë si të gjitha degët qendrore të zbatimit të ligjit në MRP. Sipas ligjit të ri të propozuar, policia kufitare do të ishte përgjegjëse për çështjet e imigracionit, të cilat aktualisht varen nga Sektori për të Huajt në Sektorin për Pashaportat dhe të Huajt.

III. Vlerësimi dhe perspektiva e situatës aktuale

Ndarja e kompetencave midis ministrive të përfshira në politikat e migracionit është përgjithësisht e qartë. Fakti që tre ministri si MRP, MPJ dhe MPCŞ janë të përfshira është shumë normale nëpër botë. Mbetet të kontrollohet nëse bashkëpunimi midis ministrive është i mjaftueshëm për të përmbushur detyrat e tyre. Ky është një problem që lidhet me MRP dhe MPJ përse i përket lëshimit të vizave afatshkurtra si edhe me MRP për lëshimin e lejeve të qëndrimit dhe shërbimeve kompetente që varen nga MPCŞ për lëshimin e lejeve të punës.

Ideja për të krijuar një Ministri Emigracioni është hedhur nga Presidenti i Republikës gjatë një takimi me trupin diplomatik në Ministrinë e Punëve të Jashtme në 27 gusht 2003, si edhe nga Kryeministri gjatë takimit vjetor me diplomatët shqiptare jashtë vendit në 31 gusht 2004 në Ministrinë e Punëve të Jashtme. Është e qartë se politikat në lidhje me emigracionin duhet të përmirësohen nga vetë rëndësia që ka emigracioni për shoqërinë. Nevoja për të mbrojtur të drejtat e emigrantëve dhe në veçanti mundësia e mobilizimit të diasporës, ashtu siç është propozuar edhe në strategji, justifikon një vëmendje më të madhe si në nivel politik ashtu edhe atë administrativ. Një tjetër arsye mund të gjendet në qëllimin për të menaxhuar migracionin në përgjithësi: arritja e marrëveshjeve dypalëshe për motive punësimi dhe përpjekjet për të kontrolluar efektet negative të migracionit, siç është “largimi i trurit”. Megjithatë krijimi i një ministrie të

⁶⁸ Shih Ligjin për të Huajt

vecantë ka një kosto shumë të lartë dhe përfaqëson një përpjekje të gjatë dhe të vështirë administrative derisa strukturat e saj të bëhen funksionale.

Për këto arsye, duhen parashikuar rrugë të tjera për të arritur qëllimet që konsistojnë në dhënien me shumë rëndësi menaxhimit të diasporës dhe migracionit në përgjithësi. Kjo mund të realizohet nëpërmjet caktimit të një Ministri për Emigracionin pa portofol. Ai do të mbështetet në strukturat ekzistuese për ndihmë administrative. Si pasojë e lidhjes që ekziston midis çështjeve të emigracionit dhe imigracionit si për shembull lufta kundër migracionit të paligjshëm, rezulton se, personi duhet të jetë kompetent për të dyja fushat dhe duhet të quhet “Ministër për Migracionin”.

Ministrit të koordinimit pranë zyrës së Kryeministrit mund t’i jepen kompetenca në fushën e migracionit. Edhe pse kjo zgjidhje është më e lehtë për t’u zbatuar pasi është pjesë e strukturës qeveritare, ajo nuk i jep vendin e rëndësishëm që ka migracioni në kuadrin politik dhe theksi vihet më pak në administrimin e emigracionit.

Fakti që Instituti Kombëtar i Diasporës aktualisht varet nga MPJ ndërkohë që MPÇS ka kompetencë të plotë në lidhje me politikën e emigracionit, përbën një problem. Duhet të ekzistojë një bashkëpunim i afërt midis këtyre shërbimeve të përfshira në të njëjtën politikë. Në të njëjtën kohë, duhen përdorur burimet njerëzore dhe buxheti i disponueshëm për këto shërbime për të siguruar se menaxhimi i diasporës do të bëhet më efektiv.

Padyshim që duhet të kontrollohet nëse të gjitha strukturat administrative që merren me politikën e migracionit janë të mjaftueshme dhe kanë mjetet e nevojshme për të ushtruar detyrat e tyre. Kjo duhet të realizohet nëpërmjet një kontrolli të brendshëm në lidhje me numrin e nëpunësve civilë të disponueshëm, kompetencave të tyre sipas gradave, eksperiencës së punës si edhe buxheti në dispozicion të tyre. Në këtë rast duhet bërë një ndarje midis shërbimeve që merren me hartimin e politikave dhe shërbimeve që merren me zbatimin praktik të ligjeve.

Politika mbi emigracionin do të kërkojë një mbështetje të fortë nga administrata për t’u zbatuar në mënyrë efektive. Kjo nuk mund të realizohet vetëm me miratimin e rregullave të reja ligjore. Për këtë do të duhen shumë kontakte me jashtë, në veçanti në lidhje me politikën e diasporës. Për vetë faktin se kjo politikë është e re dhe për vetë rëndësinë e punës administrative që duhet bërë është me vend të parashikohet krijimi i një grupi të veçantë pune (Task Force) për të inicuar këtë politikë. Duhet të merret në konsideratë mundësia e krijimit të një drejtorie të veçantë për çështjet e migracionit brenda Ministrisë së Punëve të Jashtme. Përsa i perket faktit se Instituti Kombëtar i Diasporës dhe përpjekjet diplomatike të nevojshme janë të vendosura në MPJ, kjo ministri duket zgjedhja më e mirë, por duhet të krijohen mundësi koordinimi me shërbimet që merren me emigracionin në MPÇS.

Zbatimi i disa propozimeve në këtë strategji kërkon ngritjen e disa sporteleve për emigrantët. Këto sportele duhet të merren me regjistrimin e emigrantëve, dhe dhënies së informacionit. Sportelet duhet të funksionojnë nëpërmjet strukturave aktuale administrative. Nën përgjegjësinë e sektorit të emigracionit të MPÇS –së dhe të drejtuara nga grupet e punës të lartpërmendura, sportelet e emigracionit duhet të funksionojnë brenda zyrave lokale dhe rajonale të punësimit. Fakti që mungesa e punësimit është faktori kryesor për emigracionin, vendosja në ambjentet e SH.K.P duket shumë e

përshtatshme. Struktura të tjera si psh, zyrat pranë bashkive apo komunave mund të konsiderohen gjithashtu të përshtatshme për të vendosur sportelet për emigrantët.

Së fundmi, një politikë publike për migracionin duhet të bazohet në informacion të saktë. Në Shqipëri janë bërë shumë pak kërkime, por ka shumë akademikë të huaj që merren me çështjen e emigracionit shqiptar, si psh grupi i udhëhequr nga Profesor Russel King nga Universiteti Sussex në Britarinë e Madhe. Duhet bërë më shumë kërkime, në veçanti nëpërmjet krijimit të kapaciteteve kërkuese në universitetet shqiptare. Një mënyrë efiçente për të shtuar kërkimet immediate konsiston në krijimin e një rrjeti të të gjithë kërkuesve të huaj dhe shqiptarë që merren me migracionin. Nje hap i parë në këtë drejtim mund të jetë krijimi i një baze të thjeshte të dhënash i të gjithë personave të interesuar. Duhet zhvilluar kurse të avancuara që merren me migracionin apo një program i vecante që i kushtohet migracionit, i cili përveç të tjerash do të ofrojë mundësinë për trainimin e ekspertëve që punojnë në këtë fushë për të cilët administrata shtetërore do të ketë gjithmonë e më shumë nevojë.

IV. Propozime për zbatim:

- | | |
|------|--|
| 121. | Të vlerësohet nëse koordinimi midis MPJ dhe MRP është i mjaftueshëm për realizimin e një e procedure efiçente për dhënien e vizave afatshkurtra; |
| 122. | Të shqyrtohet nëse koordinimi midis MRP përgjegjëse për dhënien e lejeve të qëndrimit dhe MPCS përgjegjëse për lejen e punës është i mjaftueshëm për të shmangur problemet që mund të lindin si rezultat i kërkesës për dy lloj lejesh për qëndrim për qëllime punësimi në Shqipëri; |
| 123. | Krijimi në nivel politik i postit të Ministrit për Migracion dhe vendosjen në dispozicion të tij të administratës që merret me këtë çështje; |
| 124. | Krijimi i një drejtorie të veçante për emigracionin në MPJ. |
| 125. | Organizimi i bashkëpunimit të nevojshëm midis Institutit Kombëtar të Diasporës Shqiptare që varet nga MPJ-ja dhe shërbimeve të MPÇS-së që merren me emigracionin; |
| 126. | Organizimi i një kontrolli të brendshëm të të gjithë shërbimeve në ngarkim të politikave të migrimit për të përcaktuar nëse ata kanë mjetet e nevojshme për të menaxhuar politikën e migracionit, në veçanti për problemet në fushën e emigracionit të cilat duhet të jenë prioritare; |
| 127. | Krijimi i një grupi pune për të inicuar politikat e reja të emigracionit; |
| 128. | Krijimi i kapaciteteve për të zbatuar propozimet e kësaj strategjie në lidhje me regjistrimin e emigrantëve dhe dhënia e informacionit, duke ngritur sportelet e emigrantëve; |
| 129. | Ndjekja e të gjitha procedurave të nevojshme për të parashikuar në buxhetin e vitit 2005 fondet e nevojshme për të filluar strategjinë kombëtare të migracionit dhe planifikimi deri në vitin 2010 i mjeteve financiare të nevojshme për zbatimin e saj. |
| 130. | Zhvillimi i nje kursi të avancuar apo të një program studimi të veçantë për migrimin në universitetet shqiptare |
| 131. | Krijimi i kapaciteteve studimore për çështjet e migracionit në universitetet shqiptare |
| 132. | Ngritja e nje rrjeti elektronik midis kërkuesve të huaj dhe shqiptarë të specializuar për migracionin, në veçanti studimi i emigracionit shqiptar. |

